

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



# Mbrojtja

Viti i 86-të i botimit  
Qershor 2018/ Nr. 7



*Bruksel 7 dhe 8 qershor 2018*

**Zv/ministri Koçi në  
takimin e ministrave  
të mbrojtjes të NATO-s**

*Ministrja Xhaçka në Francë*

**Ekspozita  
"Eurosatory" dhe  
modernizimi i FA**

**MINISTRJA XHAÇKA NË MBRETËRINË E BASHKUAR**

**Trajnim dhe edukim i lidershit  
ushtarak shqiptar në Angli**

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

# Mbrojtja



## REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror  
i Ministrisë së Mbrojtjes  
Viti i 86-të i botimit  
Nr. 7/2018

### © Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë  
revistë nuk mund të riprodhohen  
elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfuturi, pa  
marrë autorizim nga botuesit e saj.

### Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,  
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe  
Botimeve të Mbrojtjes

### Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/  
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



# Përmbajtja

Numri 7

## **KAPITEN FLORAN DELIA "QYTETAR NDERI"**

**7** Xhaçka: Mirënjohje për efektivët në uniformë

## **SIGURIA**

**19** Përfundon stërvitja rajonale "ADRION CAX-LIVEX 2018"

## **MUNICIONET E PAPLASURA**

**27** Brenda 2019 asnjë zonë e rrezikshme në Shqipëri

## **SEMINAR ME SPECIALISTËT E BCU**

**30** BCU-të të ndjekin ritmin e zhvillimeve në FA

## **NATO**

**48** Stoltenberg: Mali i Zi, një aleat i vlefshëm në NATO

## **STAFI**

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

### **Gazetarë:**

Mimoza GOLIKJA  
Albert ZHOLI  
Saimir ALIJA

### **Redaktore korrektore:**

Anila DODA

### **Graphic Designer:**

Afërdita HYSAJ

## **4 MINISTRJA XHAÇKA**

**Trajnim dhe arsim i lidershipit ushtarak shqiptar në Angli**

Sekretari Williamson e vlerësoi të shkëlqyer dhe me pritshmëri shumë të mira për të ardhmen, bashkëpunimin me Shqipërinë në fushën e...



## **6 FRANCË**

**Ekspozita "Eurosatory" dhe modernizimi i FA**

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka mori pjesë në ekspozitën ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurimit të tokës dhe ajrit në Francë...



## **8 BRUKSEL**

**Zv/ministri Koçi në takim të ministrave të mbrojtjes të NATO-s**

Gjatë dy ditëve, në datat 7 dhe 8 qershor 2018 u zhvillua në Bruksel, në Selinë e re të NATO-s, takimi i ministrave të Mbrojtjes të vendeve antarë...



## **32 KONFERENCË SHKENCORE**

**"60 Vjet Akademi e Forcave të Armatosura" 10 maj 1958-10 maj 2018**

Arsimimi ushtarak ka historinë e vet të krijimit, zhvillimit dhe konsolidimit. Por për të qenë konkretë e të saktë me të...



# Ministrja Xhaçka në Mbretërinë e Bashkuar Trajnim dhe edukim i leadershipit ushtarak shqiptar në Angli

Sekretari  
Williamson  
e vlerësoi të  
shkëlqyer dhe  
me pritshmëri  
shumë të mira  
për të ardhmen,  
bashkëpunimin  
me Shqipërinë  
në fushën e  
Mbrojtjes.

**M**inistrja e Mbrojtjes  
Olta Xhaçka zhvilloi  
një vizitë dyditore,  
19 dhe 20 qershor,  
në Mbretërinë e  
Bashkuar me ftesë  
të homologut të saj britanik Gavin  
Williamson. Gjatë qëndrimit të saj  
në Londër, ministrja Xhaçka u takua  
edhe me ministrin për Evropën  
dhe Amerikat, Duncan, drejtorin e  
Përgjithshëm të Politikës së Jashtme,  
Moore si dhe ministrin e Shtetit  
për Mbrojtjen, lordin Howe, i cili  
është njëherësh zëvendëskryetar i  
Dhomës së Lordëve.

Në takimet me zyrtarët britanikë, ministrja Xhaçka vlerësoi kontributin dhe mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar për refor-

mat kyçe në Shqipëri për forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, të cilat ajo i konsideroi si vendimtare në rrugën drejt procesit të integritetit euroatlantik. Gjithashtu, ministrja Xhaçka konsideroi se hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, rrit përgjegjësinë e institucioneve tona për transformimin e mëtejshëm të vendit.

Zonja Xhaçka u shpreh se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave për anëtarësimin, çka, sipas saj, do të ishte një hap pozitiv dhe stabilizues për politikën e brendshme, atë rajonale si dhe perspektivën e sigurisë. Nga ana e tij sekretari për Mbrojtjen i Mbretërisë së Bashkuar Gavin Wil-





Ministrja Xhaçka çmoi mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar në drejtim të edukimit dhe trajnimit të efektivëve të FA në akademitë mbretërore të mbrojtjes në Forcën Tokësore, Detare dhe Ajrore. Nëpërmjet mbështetjes së qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, po punojmë për të ndërtuar lidershipin ushtarak të së ardhmes në Forcat e Armatosura të Shqipërisë



Williamson u shpreh se Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e institucioneve demokratike dhe e konsideroi vendin tonë si një faktor shumë të rëndësishëm në Ballkan.

Sekretari Williamson e vlerësoi si të shkëlqyer dhe me pritshmëri shumë të mira për të ardhmen, bashkëpunimin me Shqipërinë në fushën e Mbrojtjes.

Ministrja Xhaçka çmoi mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar në drejtim të edukimit dhe trajnimit të efektivëve të FA në akademitë mbretërore të mbrojtjes në Forcën Tokësore, Detare dhe Ajrore. “Nëpërmjet mbështetjes së qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, po punojmë për të ndërtuar lidershipin ushtarak të së ardhmes në Forcat e Armatosura të Shqipërisë”, - tha ministrja Xhaçka gjatë takimit me homologun britanik.

Ajo gjithashtu përmendi trajnimin e pilotëve, komunikimi strategjik dhe strukturat për emergjencat civile, si fusha bashkëpunimi në të ardhmen. Në muajin shtator do të zhvillohet në Shqipëri, stërvitja e përbashkët “Albanian Lion 2018”, me pjesëmarrjen edhe të qindra efektivëve ushtarakë të Mbretërisë së Bashkuar.



Ministrja Xhaçka në Francë

# Ekspozita “Eurosatory” dhe modernizimi i FA

**M**inistrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka mori pjesë në ekspozitën ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurimit të tokës dhe ajrit në Francë, “Eurosatory”, me ftesë të ministres së Forcës së Armatosur të Francës, Florence Parly me të cilën pati edhe një takim të veçantë.

Në ekspozitën e cila u hap më 11 qershor dhe vazhdojë e hapur deri 15 qershor, që zhvillohet çdo dy vjet, marrin pjesë përfaqësues të industrive ushtarake të rreth 140 vendeve të botës, të cilët paraqesin oferta dhe mbledhin kërkesa për shërbimet e ofruara në fushën e mbrojtjes. Ndërkohë, gjatë takimit mes tyre, Xhaçka dhe homologia franceze, Parly rikonfirmuan marrëdhënien shumë të mirë mes Shqipërisë dhe Francës, veçanërisht në fushën e mbrojtjes, në të cilën dy vendet bashkëpunojnë prej vitesh.

Kompania franceze “Nexter” ka pajisur me top 20 mm anijen shqiptare Butrinti, e cila merr pjesë në operacionin e NATO-s në detin



“Ministrja Xhaçka zhvilloi takime me përfaqësuesit e kompanive të industrisë ushtarake si Lockheed Martin, Nexter dhe Thales.

Egje dhe aktualisht po punon për pajisjen me këtë lloj armatimi edhe të anijeve të tjera të Forcës Detare shqiptare. Ministrja Xhaçka shprehu interesin e Forcave të Armatosura shqiptare për të bashkëpunuar me Forcat e Armatosura franceze edhe

në fushën e emergjencave civile. Në ekspozitën “Eurosatory”, ministrja Xhaçka vizitoi stendat dhe zhvilloi takime me përfaqësuesit e kompanive prestigjioze në fushën e industrisë ushtarake si Lockheed Martin, Nexter dhe Thales.

# Xhaçka: Mirënjohje për efektivët në uniformë

**D**ibra do të kujtojë përherë kapiten Floran Delia, pilotin e Forcës Ajrore, i cili humbi jetën në një aksident ajror 2 vjet më parë. Në një ceremoni të zhvilluar më 28 qershor, në mjediset e Pallatit të Kulturës në Peshkopi, me vendim të Këshillit Bashkiak, ku merrnin pjesë familjarë, kolegë dhe qytetarë të Peshkopisë, kapiteni Floran Delia u nderua me titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes). Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, në fjalën e rastit u shpreh se kujtimi i heronjve të FA të rënë në krye të detyrës është njëherësh angazhim për vëmendjen që meritojnë ushtarakët shqiptarë.

"Ky angazhim solemn që në fakt më takon ta marr edhe personalisht në cilësisë e ministres së Mbrojtjes, na detyron të gjithëve të kujtojmë me shumë respekt sakrificën e të gjithë atyre që nuk jetojnë më. Njëherësh është edhe angazhim për të nderuar të gjithë ushtarakët që i shërbejnë atdheut, që kanë marr përsipër të rrezikojnë edhe jetën e tyre për të bërë profesionin shumë të nderuar të ushtarakut, por edhe profesionin e rrezikshëm të pilotit", tha ministrja në fjalën e saj.

Ministrja e Mbrojtjes falënderoi qytetarët e Dibrës për këtë gjest bujar: "Shumë faleminderit qytetarëve të Dibrës për këtë gjest bujar por shumë të merituar për heroin tonë. Dhe duke nderuar Floranin njëherësh keni nderuar e vlerësuar kontributin e secilit prej 8 mijë efektivëve të FA për të kontribuar për sigurinë e



"Ky angazhim solemn që në fakt më takon ta marr edhe personalisht në cilësisë e ministres së Mbrojtjes, na detyron të gjithëve të kujtojmë me shumë respekt sakrificën e të gjithë atyre që nuk jetojnë më. Njëherësh është edhe angazhim për të nderuar të gjithë ushtarakët që i shërbejnë atdheut, që kanë marr përsipër të rrezikojnë edhe jetën e tyre për të bërë profesionin shumë të nderuar të ushtarakut, por edhe profesionin e rrezikshëm të pilotit".



vendit dhe për jetën e çdo qytetari të Republikës të Shqipërisë". Me vendim të Këshillit Bashkiak, edhe rruga Ceren – Radomirë do të mbajë emrin e kapitenit të lindur e rritur në Dibër. Kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha,

ranë në krye të detyrës në mesditën e 6 prillit të vitit 2016 gjatë një fluturimi stërvitor në Grizhë të Malësisë së Madhe. Të dy ushtarakët janë shpallur "Dëshmorët e Atdheut" nga Komisioni Shtetëror për Dëshmorët.

BRUKSEL 7 DHE 8 QERSHOR 2018

# Zv/ministri Koçi në takimin e ministrave të mbrojtjes të NATO-s

*Ministrat e Mbrojtjes diskutuan për forcimin e kapacitetit të mbrojtjes, lëvizjet ushtarake, mbrojtjen kibernetike, luftën kundër terrorizmit, shpenzimet buxhetore, etj.*

**G**jatë dy ditëve, në datat 7 dhe 8 qershor 2018 u zhvillua në Bruksel, në Selinë e re të NATO-s, takimi i ministrave të Mbrojtjes të vendeve antarë të NATO-s, ku morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, Sekretari amerikan i Mbrojtjes Jim Mattis, Ministria gjermane e Mbrojtjes Ursula von der Leyen, Elisabetta Trenta-Ministrja e Mbrojtjes e Italisë, Tibor Benkoministri i Mbrojtjes i Hungarisë, Singh Sajjan-Ministër i Mbrojtjes i Kanadasë. etj. Në takimin e Brukselit, vendi ynë u përfaqësua nga zv/Ministri i Mbrojtjes Petro Koçi. Ishin të pranishëm funksionarë të lartë ushtarakë të Aleancës.

Takimi kishte për qëllim përgatitjen për Samitin e NATO-s në Bruksel, i cili do të mbahet muajin e ardhshëm. Stoltenberg tha se ministrat e Mbrojtjes diskutuan për çështje të ndryshme si forcimi i kapacitetit të mbrojtjes, lëvizja ushtarake, mbrojtja kibernetike, lufta kundër terrorizmit dhe bashkëpunimi në relacionin BE-NATO shpenzimet buxhetore, etj. Në takimet që pati zv.ministri Petro Koçi shrehu vullnenin e qeverisë shqiptare për rritjen e shpenzimeve për forcat e armatosura, modernizimin e tyre, rritjen e prezencës ushtarake në misionet ndërkombëtare si në Afganistan, detin Egje, Letoni, etj. apo ngritjen në Shqipëri të Qendrës së Ekselencës së NATO-s për studimin e fenomenit të Luftëtarëve të Huaj Terroristë.

Në takimin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, ministrat e mbrojtjes të Belgjikës, Danimarkës dhe Holandës nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MOU) për krijimin e Komandës së Komponentës së Përbashkët Operacionale Speciale (C-SOCC). Pasi të funksionojë, kjo Komandë e Forcës Speciale Tri-kombëtare do të marrë pjesë në Forcën e Reagimit të NATO-s dhe mund të mbështesë operacionet e NATO-s, si dhe misionet e tjera shumëkombëshe.

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s mbështetën me 7 qershor, ditën e

enjte, iniciativën për Gatishmërinë e NATO-s: "Katër Tridhjetë" për të siguruar që deri në vitin 2020: 30 batalione të mekanizuara, 30 skuadra ajrore dhe 30 anije luftarake gati brenda 30 ditëve ose më pak. "Sepse në një botë më të paparashikueshme, ne duhet të jemi të sigurtë se kemi forcat e duhura në vendet e duhura në kohën e duhur", tha Stolteberg.

Ne takim u konkludua se janë rritur kontributet e në misionet dhe operacionet e NATO-s. NATO përshëndeti si një hap në drejtimin e duhur planet e paraqitura nga ana e Gjermanisë për rritjen deri në 80% të shpenzimeve të saj për Mbrojtjen, me shpresën që ky veprim të ulë tensionet brenda Aleancës për ndarjen e kuotave financiare. Kancelarja Angela Merkel njoftoi një ditë para se te zhvillohej takimi i ministrave në

Bruksel, të mërkurën, në Bundestag arritjen e një marrëveshjeje brenda koalicionit qeveritar për t'i rritur këto shpenzimeve deri në 1,5% të PBB-së deri në vitin 2025. "Ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula von der Leyen konfirmoi sot këtë objektiv në Bruksel. Vitin e ardhshëm, ne do të jemi tashmë në 1,3% të PBB-së", theksoi ajo gjatë një konferencë shtypi para takimit me homologët e saj në selinë e NATO-s. Ministri gjerman i Mbrojtjes Ursula von der Leyen tha se kishte "çështje të diskutueshme" por se "atmosfera dhe bashkëpunimi ynë këtu në aleancë janë plot besim".

"Jam i kënaqur nga fakti që Gjermania ka ndërprerë shkurtimet dhe ka filluar të rrisë shpenzimet ushtarake, duke njoftuar planet për t'i rritur ato deri në 80% gjatë një dekade", u shpreh Sekretari



i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Ky është një hap në drejtimin e duhur", përfundoi ai.

Lidhur me Afganistanin, Stoltenberg tha se: "në samitin e muajit të ardhshëm, pres që aleatët të bien dakord të zgjerojnë fondet për forcat afgane deri në vitin 2024. Prania jonë në Afganistan ndihmon afganët të stabilizojnë vendin e tyre, të luftojnë terrorizmin ndërkombëtar dhe të krijojnë kushtet për një zgjidhje paqësore. Ky është një hap pozitiv përpara në rrugën drejt paqes. NATO mbështet plotësisht procesin e paqes dhe pajtimit të udhëhequr nga Afganët".

Kreu i Aleancës Stoltenberg, tha se "pas samitit në Bruksel në Irak zyrtarisht do të nis misioni i NATO-s. "Qëllimi kryesor i këtij misioni është ofrimi i stabilitetit në vend dhe vazhdimi i përfitimeve të arritura kundër organizatës terroriste DEASH", thekson Stoltenberg. Sipas tij, NATO ka marrë misionin e trajnimit pas thirrjes së qeverisë së Irakut. "NATO do të vazhdojë të qendrojë në këtë shtet për aq kohë sa qeveria e Irakut dëshiron", tha ai.

Ndërsa në lidhje me dëshirën e Katarit për t'u bërë anëtar i plotë i NATO-s, Stoltenberg tha në konferencën për shtyp se: "Katarit është një aleat i rëndësishëm i NATO-s". "Sipas nenit 10 të Traktatit të Washingtonit, traktat themelues i NATO-s, në aleancë mund të anëtarësohen vetëm shtetet që janë në Evropë dhe Amerikën Veriore", tha Stoltenberg.



ATHINË, GREQI, NGA DATA 12-13 QERSHOR 2018

## Projekte të përbashkëta në kuadër të SEDM-it

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade Manushaqe Shehu mori pjesë në takimin e zv/shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore, në kuadër të iniciativës së SEDM-it, (South-Eastern Europe Defence Ministerial) që u zhvillua në Athinë, Greqi, nga data 12-13 qershor 2018.

Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e gjenerallejtnant. Kostantinos Floros, zv/shefi i Shtabit të Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë si vendës pritës i këtij aktiviteti dhe u moderua nga drejtuesi aktual i SEDM-Ç/PMSC, ambasador Eleftherios Angeloupolos, i cili ndër të tjera theksoi se kjo iniciativë vazhdon të luaj një rol shumë të rëndësishëm për forcimin e paqes dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit. Më tej takimi vazhdoi me përditësimin e aktiviteteve të kryera nga SEDM-i nga takimi i fundit i Podgoricës, ku ndër çështjet që u trajtuan ishin ecuria e projekteve të marra përsipër nga SEDM-i, ndërtimi i besimit ndërmjet vendeve të rajonit, rritja e rolit të femrave në institucionet e sigurisë e të mbrojtjes, roli i spitaleve ushtarake të rajonit, stërvitja "SEESIM 18", etj. Gjithashtu në këtë takim komandanti i SEEBRIG-ut, gjeneral brigade Tudorica Petrache, bëri një paraqitje të punës së kryer nga kjo komandë gjatë periudhës ndërmjet dy takimeve.

Pas diskutimeve dhe plotësimeve nga pjesëmarrësit në takim në mënyrë unanime u nënshkrua një Deklaratë e Përbashkët e zv/shefave të Shtabeve të Përgjithshëm, e cila konfirmoi besimin reciprok të vendeve pjesëmarrëse për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në rajon në kuadër të iniciativës së SEDM-it. Takimi i radhës u vendos të mbahet në muajin qershor 2019, në Shkup të Maqedonisë.

Gjenerale Shehu në takimin e zv/shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore.

# Enea Hilaj në West Point

## Kadeti shqiptar pranohet në Akademinë Ushtarake të SHBA

**K**adeti shqiptar Enea Hilaj është pranuar në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara West Point. Gjatë një ceremonie të mbajtur, javën që kaloi, ditën e enjte, më 21 qershor 2018, në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, i Ngarkuari me Punë Ryan Roberts dhe Atasheu Amerikan i Mbrojtjes James Hilton i dorëzuan kadetit shqiptar Enea Hilaj, i shoqërohej nga familja e tij, certifikatën e pranimit në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara.

Hilaj është kadeti i katërt shqiptar që do të ndjekë Akademinë, por i pari në më shumë se shtatë vjet. Shqipëria u përzgjedh si një vend i autorizuar për aplikime në një numër shumë të kufizuar vendesh të lira për kandidatë ndërkombëtarë gjatë këtij viti në Akademi.

Hilaj u pranua nëpërmjet një konkursi të hapur dhe të barabartë, koordinuar nga Qendra Shqiptare për Rekrutim. Hilaj pritet të diplomohet në West Point në vitin 2022, vit në të cilin ai do të kthehet në Shqipëri për të kryer angazhimin e tij kontraktual me Forcat e Armatosura Shqiptare si Toger i Dytë.

Pranimet në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara janë të hapura për të gjithë personat civilë dhe ushtarakë të moshës 17 deri 22 vjeç. Përzgjedhja bëhet një herë në vit dhe bazohet në rezultatet akademike, gjendjen fizike dhe shfaqjen e aftësive udhëheqëse. Pritet që më shumë shqiptarë të konkurojnë për këtë bursë në vitet e ardhshme. Zyra e Marrëdhënies me Publikun e Ambasadës së



“Ambasada Amerikane: Hilaj është kadeti i katërt shqiptar që do të ndjekë Akademinë, por i pari në më shumë se shtatë vjet.

Shteteve të Bashkuara do të ketë së shpejti informacion në dispozicion të kandidatëve të mundshëm, të cilët

janë të interesuar të studiojnë në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara në vitet e ardhshme



Misioni "Resolute Support Mission"

# Kontigjenti i VIII-të Paqëruajtës, 30 efektive drejt Afganistanit

*"Nuk jemi në NATO për numër apo për prezencë flamuri, por për të shprehur kontribut konkret"*

**N**ë ambjentet e Batalionit të Parë të Këmbësorisë në Vaun e Dejës u zhvilluan më 1 qershor 2018, ceremonia e përcjelljes së Kontigjentit të VIII-të Paqëruajtës drejt Afganistanit, çka përkoi me festën e fëmijëve, prania e të cilëve e bëri të veçantë këtë aktivitet. Fëmijët e efektivëve të Batalionit të Parë të Këmbësorisë në Vaun e Dejës kanë qenë vizitorët e veçantë, të cilët kanë festuar 1 Qershorin me efektivët dhe kanë falur shumë emocione në ceremoninë e nisjes së Kontigjentit të VIII-të Paqëruajtës prej 30 ushtarakëve në mision në Kabul, Afganistan në kuadër të misionit "Resolute Support Mission" (RSM).

Zëvendësministri Koçi, duke përshëndetur efektivët e b1k, u shpreh se Shqipëria modeste në burimet e veta material e financiare vazhdon të kontribuojë dhe të zgjerojë misionet e veta ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, por pa prekur nivelin e trajtimit të ushtarakëve në këto misione.

"Ne sot nisim 30 djem të tjerë në Afganistan dhe po ashtu dhe brenda pak ditësh dhe bashkë me këta madje do të nisim një kontingjent shtesë. Së fundmi qeveria mori një vendim për të shtuar efektivin tonë pjesëmarrës në misionin në Afganistan. Sepse ne duam ti dëshmojmë botës se nuk jemi në NATO për numër, ne nuk jemi në NATO thjeshtë për një prezencë flamuri, ne jemi në NATO për të shprehur me kontribut konkret, madje duke rrezikuar efektivët tanë në misione delikate", përfundoi fjalën e tij Petro Koçi.

Shefi i Shtabi të Përgjithshëm



të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçakuu bëri edhe njëherë thirrje të gjithë të rinjë të komunitetit të bashkohen në FA, sepse aty do të gjejnë vendin e

duhur për t'i shërbyer atdheut, për të treguar se kush janë, por edhe për të aftësuar veten, qoftë nga ana fizike e intelektuale por edhe mundësi për edukim kualifikim.

## CEREMONIA

### Kontigjenti i VII-të Paqëruajtës kthehet nga Afganistani

Më datë 21.06.2018 u zhvillua ceremonia e pritjes së kontigjentit të shtatë RSM, të cilët shërbyen në Kabul Afganistan, për një periudhë kohe 6 mujore. Në ceremoninë e pritjes moren pjesë komandanti i FT Gjeneral Brigade Nazmi Cahani dhe komandanti i b2k Kolonel Arjan Hilaj. Gjatë fjalës së mbajtur, komandanti i FT shprehu vleresimet më të larta për kontigjentin, duke cituar se ndjehem krenar për punën tuaj që keni bërë në mision. Kam qenë në mënyrë të vazhdueshme së bashku me komandantin e b2k në kontakt mbi ecurinë e misionit, ndaj ju falenderoj për punën e bërë dhe ju uroj suksese të mëtejshme.



**N**ë mjesdit e Batalionit të Xhenios (bXh) të Komandës Mbështetëse u zhvillua më 14 qershor, ceremonia e nisjes së kontingjentit III EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence-eFP) të NATO, si pjesë e grup – batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze në Letoni. Për të nderuar përcjelljen e këtij kontingjenti morën pjesë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Gaspër Lala, drejtorë të drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm, komandantët e reparteve të vartësisë të kësaj komande si dhe familjarët e pjesëtarëve të këtij kontingjenti.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i bXh, nënkolonel Hajdar Gurra, i cili pasi falënderoi të pranishmit për prezencën e tyre, në fjalën e tij theksoi rëndësinë dhe veçantinë e këtij misioni për kontingjentin e III të togës EOD pasi në radhët e këtij kontingjenti marin pjesë si operatorë EOD dy efektive femra. Nënkolonel Gurra u shpreh: "Ndjehemi të nderuar dhe të vlerësuar që në këtë ceremoni është bashkuar shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku dhe komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Gaspër Lala, prania e të cilëve dëshmon qartazi vlerësim, mbështetjen dhe inkurajim ndaj misionarëve dhe për këtë na bën të ndjehemi krenar." Ky është kontingjenti i tretë që shkon në mision në Letoni nën drejtimin e Komandës së Grup Batalionit kanadez. Eksperiencat dhe vlera, të cilat janë fituar në dy misionet e kaluara dhe në eksperiencat e mëparshme në misionet në Mali dhe Bosnje - Hercegovinë tregojnë se efektivat EOD janë të aftë të kryejnë detyra në kushte shumë të vështira. Në emër të kontingjentit të III EOD përshëndeti komandanti i këtij kontingjenti, major Markelian Kodra, i cili premtoi se ky kontingjent do të përfaqësojë denjësisht Forcat e Armatosura me përkushtim dhe profesionalizëm në realizimin e detyrave që do të ngarkohen në fushën EOD. Fjalën përshëndetëse e mbajti shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili u ndje i privilegjuar me

## Misioni i Tretë

# Toga EOD e Batalionit të xhenios drejt Letonisë

*Gjeneral Kollçaku: U ndjeva i emocionuar dhe tepër krenar për punën dhe përkushtimin që po tregojnë forcat tona EOD përkrah vendeve aleate të NATO-s*



pjesëmarrjen e tij në këtë ceremoni kaq të rëndësishme për Komandën Mbështetëse dhe Batalionin e Xhenios. Në fjalën e tij gjeneral Kollçaku u shpreh: "Bashkë me kolonel Lalën patëm rastin të vizitojmë bazën ku kontingjenti i II EOD është i dislokuar dhe u ndjeva i emocionuar dhe tepër krenar për punën dhe përkushtimin që po tregojnë forcat tona EOD përkrah vendeve aleate të NATO-s." Në përfundim të fjalës së tij, gjeneral Kollçaku, duke u uruar tru-

pave rrugë të mbarë dhe të kthehen shëndoshë e mirë në atdhe u kërkoi atyre të qëndrojnë në lartësinë e detyrës dhe të mbajnë gjithmonë lartë dhe me krenari flamurin shqiptar. Në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO në Letoni do të marin pjesë 21 efektive EOD. Ceremonia vazhdoi me dorëzimin e flamurit për kontingjentin e III EOD që nisën në Letoni dhe u mbyll me një foto të përbashkët.





## Kursi i Lartë i Oficerit dhe kursi i Komandës së SHPFA

**N**ë auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua paraditen e datës 29 qershor, ceremonia e diplomimit të kursantëve të Kursit të Lartë të Oficerit dhe kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, të Akademisë së Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2017-2018. Të pranishëm në ceremoni ishin: Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Dr. Bardhyl Kollçaku, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc.Dr. Bajram Begaj, Komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale në FSK Gjeneral Brigade Naim Haziri, Komandanti i AFA Kolonel Dr. Eduart Bala, Komandantët e Forcave në FA, atasheu ushtarak i Kosovës Kolonel Bashkim Shillova, drejtorë drejtorish në Ministrinë e Mbrojtjes e Shtabin e Përgjithshëm, komandantë të institucioneve, familjarë të akademistëve, si dhe të ftuar të tjerë.

Komandanti/rektori i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), Kolonel Dr. Eduard Bala, në fjalën e hapjes së kësaj ceremonie, falënderoi të ftuarit për pjesëmarrjen e tyre në këtë eveniment të rëndësishëm, Ministren e Mbrojtjes, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandantin e KDS, për mbështetjen

# Diplomohen 16 nënkolonelë dhe 31 majorë

maksimale dhe frytdhënëse të dhënë gjatë këtij viti akademik; stafin e AFA, si dhe kursantët për punën e bërë gjatë gjithë vitit akademik në arritjen e rezultateve në procesin mësimor. Kolonel Bala, duke ju drejtuar kursantëve vuri në dukje se përfundimi me sukses i studimeve në Akademi ka rritur kulturën profesionale të kursantëve, me ndikim në përmirësimin e punës kudo ku kursantët e sapodiplomuar do të shërbeni në Forcat tona të Armatosura.

Më tej, ceremoninë e përshëndeti dhe Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Dr.BajramBegaj.

Gjeneral Begaj, pasi vlerësoi institucionin e AFA si një institucion i cili, ka luajtur dhe luan një rol parësor në përgatitjen dhe kualifikimin e ushtarakëve dhe civilëve të të gjitha niveleve të komandimit e të drejtimit në strukturat e Forcave tona të Armatosura, e vuri theksin në rëndësinë e procesit të arsimit ushtarak dhe përgatitjes profesionale të oficerëveqë shërbejnë në radhët e FARSH.Duke ju uruar suksese kursantëve që përfunduan vitin akademik 2017-2018, gjeneral Begaj theksoi se: "Jam i sigurt se ju keni fituar kapacitetet e mjaftueshme të profesionistit të vërtetë

ushtarak, aq të nevojshëm dhe të domosdoshëm për Forcat tona të Armatosura. programet mësimore të AFA janë programe gjithëpërfshirëse, të cilat synojnë përgatitjen e profesionistëve ushtarakë, duke ndërthurur dijet shkencore me praktikën, sipas kushteve konkrete dhe misioneve të njëjste të Forcave tona të Armatosura, duke ndërthurur traditën tonë të vyer ushtarake me informacionin e ri bashkëkohor, si dhe duke i paraprirë perspektivës së zhvillimit dhe transformimit të Forcave të Armatosura. Ju, keni tani mundësinë të dërgoni në strukturat nga vini eksperiencën unike të fituar në akademi, formimin e ri dhe idetë e reja për të reflektuar ndryshimet e nevojshme në përgatitjen e strukturave të FA në përputhje me ndryshimet që koha kërkon. Me të diplomuarit në ditën e sotme, numri i përgjithshëm i ushtarakëve që kanë kryer studime

dhe kualifikime institucionale shkon gjithnjë e në rritje. Ky fakt pasqyron dinamikën dhe kapacitetet me të cilat institucioni ynë arsimor ushtarak synon ti përgjigjet kërkesave aktuale dhe perspektivës në FA".

Gjeneral Begaj, vlerësoi përpjekjet për përmirësimin e programeve dhe kurrikulave arsimore, për të gjitha fushat që zhvillohen në AFA, me synim konsolidimin e një AFA moderne dhe e aftë për t'iu përgjigjur zhvillimit perspektiv të Forcave të Armatosura; realizimin me sukses të stërvitjeve të asistuara me kompjuter në Qendrën e Simulimit, stërvitjen dyshkallëshe komando-shtabi, të cilat ndikuan në përmirësimin e standardeve të stërvitjeve dhe unifikimin e procedurave të zhvillimit të saj, jo vetëm në programet e akademisë, por edhe në të gjitha strukturat e FA; kryerjen në gjuhën angleze të mbrojtjes së temave, sinjë hap i madh cilësor, i cili duhet të konsoli-

dohet më tej.

Gjithashtu, Komandanti i KDS, Gjeneral Begaj, vlerësoi dhe angazhimin e përkushtimin e oficerëve kursantë të FS të Kosovës. "Të gjithë ushtarakët nga Kosova, që diplomohen në institucionet tona arsimore – ka nënvizuar Gjeneral Brigade Bajram Begaj, kanë treguar



nivel të lartë angazhimi profesional, duke pasuruar në këtë mënyrë edhe jetën akademike e ushtarake të këtyre institucioneve. Dyert e institucioneve tona arsimore ushtarake do të jenë gjithmonë të hapura për FSK, ashtu si dyert e shtëpive tona, si një nga traditat më të vjera të shqiptarit, si vazhdimësi e ndihmës dhe bashkëpunimit tonë për ngritjen, ndërtimin dhe zhvillimin e FSK. Bashkëpunimi nuk është vetëm në shërbim të zhvillimit të ndërtimit të FSK, por edhe në shërbim të paqes, stabilitetit të qëndrueshëm në rajonin tonë, në shërbim të axhendës së përbashkët euro-atlantike të Shqipërisë dhe të Kosovës".

Në emër të të diplomuarve të kursit të Lartë të Oficerit përshëndeti nënkolonel Aleksandër Xhafa, e cila pasi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre në këtë ceremoni të veçantë të diplomimit, nënvizoi programet bashkëkohore të

ofruara nga Akademia e Forcave të Armatosura, leksionet t'rreheq'se, diskutimet nxit'se dhe zgjidhjet praktike, si një pasuri të mendimit dhe veprimit.

Ceremonia e diplomimit të kursantëve të KLO dhe KKSHP të Akademisë së Forcave të Armatosura, për vitin 2017-2018, u përshëndet dhe nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku. Ndër të tjerash në fjalën e tij, gjeneral Kollçaku, ritheksoi edhe njëherë faktin që AFA është një institucion tashmë i konsoliduar jo vetëm për KDS por për gjithë FA, e që ka kontribuar në nxjerrjen e resurseve njerëzore ushtarake, të cilët kanë shërbyer me profesionalizëm jo vetëm brenda radhëve të FA, por kanë shfaqur ndjenjë të lartë profesionalizmi dhe përfaqësie dhe në misionet paqeruajtëse jashtë vendit. Sistemi arsimor ushtarak bazohet në një sistem vlerash e meri-

tokracie- ka vijuar Gjeneral Kollçaku. Profesionin e ushtarakut kërkon një zhvillim të vazhdueshëm që konkretizohet më së miri me dijet e përfituara në kursin e KLO e KKSHP. Vizioni ynë është qëllimi i përbashkët, që është transformimi i FA. Kontributet tona kërkojnë nivel tepër të lartë cilësor, prandaj cilësia të jetë në epiqendër të arsimimit ushtarak- ka nënvizuar SHSHPFA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku. Në përfundim të fjalës përshëndetëse të tij, ai falënderoi për seriozitetin e treguar në të gjithë ecurinë e zhvillimit të mësimdhënies si dhe të arsimimit në përgjithësi.

Në KLO u diplomuan 16 nënkolonelë, nga të cilët 15 nënkolonelë, pjesëtarë të Forcave të Armatosura të RSH dhe një n/kolonel i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në KKSHP u diplomuan 31 majorë, nga të cilët 25 majorë, pjesëtarë të Forcave të Armatosura të RSH dhe 6 majorë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

## Qeveria: Grup trajnues special për forcat afgane në Kabul

**P**o më datë 21.5.2018, Qeveria ka miratuar Vendimin Nr.284 “Për pjesëmarrjen e një grupi trajnues special të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s “Resolute Support Mission” (RSM), në Afganistan”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave është bazuar në kërkesën e Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës, të nenëve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Mbi këtë bazë ligjore Qeveria vendosi dërgimin me mision të një grupi trajnues special, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë të Batalionit të Forcave Speciale, të Forcës Tokësore, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të operacionit ushtarak të NATO-s “Resolute Support Mission” (RSM), në Afganistan.

Përpara dërgimit me mision të grupit trajnues special, në operacionin ushtarak “RSM” dhe gjatë tij të zhvillohet në rajonet dhe zonat e operacionit misioni i rikonicionit/përnjohjes për njohjen e terrenit

“ Grupi trajnues special përbëhet nga 12 ushtarakë të Batalionit të Forcave Speciale, të Forcës Tokësore, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

të veprimit të palëve. Kohëzgjatja e këtij misioni të jetë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe ekipi i rikonicionit/përnjohjes të përbëhet nga 3 (tre) ushtarakë të fushave: komandim/kontroll, operacion/logjistikë dhe zbulim/siguri.

Misioni i grupit trajnues special është trajnimi, këshillimi dhe dhënia e ndihmës një batalioni sulmues të motorizuar të Forcave të Sigurisë Afgane për plotësimin me personel, stërvitjen dhe pajisjen për kalimin në batalion plotësisht të motorizuar, me qëllim partnerizimin e tij me Komandën e Operacioneve Speciale në mbështetje të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës Islamike të Afganistanit.

Venddislokimi i grupit trajnues special të jetë në Kabul, Afgani-

stan.

Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të grupit të parë në Afganistan, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit për çdo grup të jetë 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me grupin e radhës.

Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet, për: dietat, për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore; sigurimin e jetës; sigurimin shëndetësor jashtë zonës së operacionit; mbështetjen shëndetësore; ushqimin; akomodimin; ujën; energjinë elektrike; lavanderinë; shërbimin



telefonik, postar dhe internetin; transportin; transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline; aktivitete social-kulturale, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit; çdo shpenzim tjetër për mbarrëvajtjen e kryerjes së operacionit.

Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në ekipin e rikonicionit/përnjohjes, të përballojë shpenzimet për: shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore; sigurimin e jetës; sigurimin shëndetësor jashtë zonës së operacionit; mbështetjen shëndetësore; ushqimin; akomodimin; ujin; energjinë elektrike; lavanderinë; shërbimin telefonik, postar dhe internetin; transportin; transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline; çdo shpenzim tjetër për mbarrëvajtjen e kryerjes së misionit të rikonicionit/përnjohjes.

Transporti i personelit që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, energjia elektrike, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi i cili ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare Nr.76, datë 28 maj 2018.

## VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

# Forcat e Armatosura rrisin kontigjentin në Afganistan

**Q**everia ka miratuar Vendimin Nr.283, datë 21.5.2018 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.912, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin "RSM" të NATO-s, pranë Komandës së Batalionit Shumëkombësh në Afganistan". Kështu në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shq-



përisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi si më poshtë.

Në vendimin Nr. 912, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime: a) Në titull fjalët "... një toge ..." zëvendësohen me fjalën "... personelit ..."; b) Në pikën 1, fjalët "... një toge ..." zëvendësohen me fjalën "... personelit ..." dhe numri "... 30 (tridhjetë)... ndryshohet dhe bëhet "... 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) ..."; c) Në pikën 2, fjala "... togës ..." zëvendësohet me fjalët "... personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ..."; ç) Në pikën 3, fjala "... përfaqësuesit ..." zëvendësohet me fjalën "... kontingjentit ..." dhe fjala "... përfaqësues ..." zëvendësohet me fjalën "... kontingjent ..."; d) Në pikën 4, fjalët "... kësaj toge ..." zëvendësohen me fjalët "... personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Po kështu Vendimi i Këshillit të Ministrave ngarkon ministrinë e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, Nr.76, date 28 maj 2018.

## Fregata gjermane F - 261 në portin e Durrësit

**N**ë zbatim të planit të bashkëpunimit midis Ministrisë sonë të Mbrojtjes dhe Bundeswehrit, nga data 1 deri më 3 qershor 2018, ka zhvilluar një vizitë në portin e Durrësit, Fregata F-261, Magdenburg, pjesë e Flotës Gjermane.

Anijen gjermane F- 261, u prit në molin nr. 5 të portit Durrës, nga Atasheu ushtarak gjerman, N/ Kolonel Hans Peter Wasmsler, përfaqësues të Autotitetit Portual Durrës, të Policisë së Sigurisë Portuale, Kuadro të Shtabit të Forcës Detare dhe Komandanti i Grupit të II-të Patrullues të anijeve me vendbazim në Kepin e Palit.

Mesditën e datës 1 qershor 2018, Komandanti i Fregatës Gjermane F 261, Kapiten i Rangut të II-të, Fitz Rudiger, i shoqëruar nga kuadro të anijes dhe Atasheu ushtarak Gjerman në vendin tonë zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, ku u pritën nga Komandanti i kësaj Force, Gjeneral Major Ylber Dogjani, Shefi i Shtabit, Kapiten i Rangut të II-të Arsen Mullaj dhe kuadro të shtabit të FD.

Fillimisht Gjeneral Dogjani, i uroi mirëseardhjen Komandantit të anijes dhe qëndrim të këndshëm në Shqipëri. Në vijim ushtarakët e dy vendeve diskutuan për bashkëpunimin midis dy flotave tona, kryesisht në fushën e arësimitit e kualifikimit të detarëve tanë në shkollat gjermane, vizitave të ndërsjellta, bashkëpunimin në operacionin "Sea Guardian", ku flota gjermane shpesh

herë merr drejtimin e operacionit, etj.

Në fund të takimit Kapiten Fitz Rudiger, e falenderoi Gjeneral Dogjanin për pritjen e afruar nga autoritetet shqiptare dhe mikpritjen e treguar ndaj ekuipazhit të anijes. Gjatë ditëve të qëndrimit në vendin tonë, në fregatën gjermane ka patur vizita nga zv/ministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi, Shefi i Shtabit të

Përgjithshëm te FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, Ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë, znj.zonja Susanne Schütz, autoritete lokale, ish-ushtarakë të liruar e në pension, etj. Ndërkohë personeli i anijes ka zhvilluar vizita në objekte muzeale, kulturore e vende turistike të zonës Durrës-Tiranë. Anija gjermane u largua nga vendi ynë më datën 3 qershor 2018.



# Stërvitja shumëkombëshe e koduar "ADRIATIC STRIKE18"

Në periudhën 2-9 qershor 2018, në Slloveni u zhvillua stërvitja shumëkombëshe e koduar "Adriatic Strike 18". Forca Ajrore ishte pjesë e stërvitjes së përbashkët me vendet aleate të NATO-s, me një personel prej 15 vetash dhe e mbështeti stërvitjen me një helikopter Cougar. Gjatë stërvitjes shumëkombëshe të koduar "Adriatic Strike 18", u trajnuan Forcat Aleate dhe të koalicionit për operacione taktike të fuqisë ajrore në mbështetje të operacioneve CAS Mbështetje e afërt nga ajri) në qendrat urbane, malore dhe fushore.

Gjatë stërvitjes ekuipazhet fluturuese dhe helikopteri Cougar kryen transportin e trupave alpine, Sllovene, Austriake, Spanjolle, Gjermane dhe Zvicerane në rajonin e alpeve midis Sllovenisë dhe Austrisë.



Gjithashtu ekipi i JTAC (Joint Terminal Attack Control) mori pjesë në mbështetje të togave të dislokuara në qendrat urbane, në sigurimin e autokolonave, si dhe në mbështetjen me zjarr nga ajri dhe toka.

Nëpërmjet këtyre stërvitjeve synohet rritja e aftësive taktike-operacionale dhe ndërvepruese të ekuipazheve fluturuese dhe elementëve

të komandim-kontrollit, duke zbatuar procedurat standarde të operimit, koordinimit, komunikimit, bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë, për të përmbytur objektivin për të marrë pjesë me ekuipazhe fluturuese dhe helikopter pas vitit 2019, në operacionet e drejtuara nga NATO. Ambasadori Pëllumb Qazimi, i shoqëruar nga atasheu i mbrojtjes të Shqipërisë në Slloveni, kolonel Ylli Pulaj, u takuan me trupat ushtarake shqiptare pjesëmarrëse në stërvitje dhe i përgëzuan për arritjet e tyre operacionale në një mjedis ndërkombëtar, sidomos për treguesit e ndërveprueshmërisë e të veprimit së bashku me struktura ushtarake të vendeve të tjera të Aleancës së NATO-s dhe të vendeve partnere.

## Forca Ajrore në stërvitjen "ADRION CAX-LIVEX 2018"

Forca Ajrore mori pjesë në stërvitjen ADRION CAX-LIVEX 2018 e cila u zhvillua në kuadër të Iniciativës ADRION, në periudhën 9-12 qershor nga Kepi i Rodonit në veri deri te Kepi i Kavadonit në jug. Kjo stërvitje kishte për qëllim nxitjen e bashkëpunimit, mirëkuptimit të ndërsjellë si dhe rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcave Detare të Iniciativës ADRION.

Sipas skenarit të stërvitjes, Forca Ajrore mori pjesë në stërvitje me helikopterin EC-145 për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det, përkatësisht në rajonin ndërmjet Gjirit të Vlorës dhe Kepit të Palit. Pilotët që kryen detyra në Qendrën e Simulimit të Forcave të Armatosura treguan profesionalizëm dhe përkushtim në realizimin e skenarëve të improvizuar. Qendra e Kontroll-Raportimit e Forcës Ajrore koordinoi me ANTA-n për ditët, llojet e fluturimit dhe zonën e zhvillimit të fluturimeve në interes të stërvitjes, ndërsa Shërbimi Meteorologjik Ushtarak



informoi QKR, QBO për kushtet meteorologjike në rajonet e stërvitjes. Kjo stërvitje ishte një hap i rëndësishëm për rritjen e ndërveprueshmërisë dhe shkëmbimit të eksperiencës midis pjesëmarrësve, si dhe rritjes së frymës së bashkëpunimit dhe shkallës së ndërveprimit dhe standartizimit të procedurave sipas NATO.

# Siguria në detin Adriatik dhe Jon

## Përfundon stërvitja rajonale “ADRION CAX-LIVEX 2018”

**N**ë hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, nga Kepi i Rodonit dhe deri në Kepin e Kavadonit, duke filluar nga dita e hënë, datë 4 qershor deri më 13 qershor, u zhvillua stërvitja rajonale “Adrion Livex 2018”. Në këtë stërvitje rajonale morën pjesë Greqia, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Shqipëria. Në këtë kuadër, në Portin e Durrësit, mbërritën dhe zhvilluan stërvitjen e programuar, efektivat dhe anijet e vendeve pjesëmarrëse në këtë stërvitje rajonale, e cila për një periudhë 10 ditore u zhvillua nën drejtimin e Forcës tonë Detare. “Adrion Cax-Livex 2018” zhvillohet në kuadër të Iniciativës ADRION dhe çdo vit një nga vendet e kësaj iniciative sipas rotacionit organizohet në rolin e vendit pritës duke planizuar dhe drejtuar zhvillimin e saj. Kjo stërvitje kishte për qëllim nxitjen e bashkëpunimit, mirëkuptimit të ndërsjellë si dhe rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcave Detare të Iniciativës ADRION dhe u realizua në dy faza kryesore, e para “CAX” e cila u zhvillua në mënyrë kompjuterike në Qendrën e Simulimit si dhe pjesa e dytë dhe më kryesore “LIVEX”, e cila u zhvillua në det. Në këtë kuadër, grupet e bordingut të anijeve të ndryshme prej dy ditësh u trajnuan nga instruktorë amerikanë dhe grekë mbi mënyrën e bordimit dhe ndërhyrjes me forcë në një mjet detar që mund të konstatohet



Në stërvitje morën pjesë Forca Detare nga Shqipëria, Italia, Greqia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Flota e 6-të amerikane

se kryen shkelje të ligjshmërisë në det. Edhe në Qendrën e Simulimit të Forcave të Armatosura, efektivat u trajnuan sipas skenarëve të ndryshme të realizuara nëpërmjet programeve kompjuterike, me qëllim kuptimin e efekteve që ka mënyra e

planëzimit por edhe organizimit të forcave në rezultatin përfundimtar të një operacioni.

Me rastin e përfundimit të stërvitjes rajonale “ADRION CAX-LIVEX2018” (Live Exercise-Computer Assisted Exercise 2018), u



zhvillua më 12 qershor, në Portin e Vlorës, ceremonia e "Ditës së Vizitorëve të Shquar". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, përfaqësues të forcave detare të vendeve pjesëmarrëse, autoritete të pushtetit vendor Vlorë, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, komandantë forcash dhe drejtorë drejtorish në SHP si dhe efektiva të cilët ndoqën nga afër zhvillimin dhe manovrat praktike të stërvitjes në det.

Në përshëndetjen e tij drejtuar trupave pjesëmarrëse në këtë stërvitje të përbashkët, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FAR-SH-së, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, pasi falënderoi të gjitha forcat detare pjesëmarrëse në stërvitje vlerësoi bashkëpunimin dhe miqësinë e fortë midis vendeve të rajonit, u shpreh ndër të tjera: "Vendimi për të pritur edhe njëherë këtë stërvitje nga ana jonë ishte vendim shumë i mirë pasi patëm rastin të tregonim sërish nivelin profesional të Forcës Detare por edhe mikpritjen e vendit tonë. Forca jonë Detare kontribuon që prej dy vitesh jo vetëm në shërbim të sigurisë së rajonit por edhe sigurisë së Aleancës".

Nga ana e tij, Komandanti i Forcës Detare, gjeneral major Ylber Dogjani, në përshëndetjen e tij falënderoi trupat pjesëmarrëse për përkushtimin e treguar gjatë zhvillimit të kësaj stërvitje të përbashkët



rajonale si dhe arritjen me sukses të objektivave të saj.

Në emër të Forcave Detare të ADRION-it përshëndeti përfaqësuesi i Forcës Detare Italiane kundëradmiral Flavio Biaggi. Pasi falënderoi për organizimin e mrekullueshëm të kësaj stërvitje, ai solli në vëmendje të të pranishmëve se dy vite më parë në 2016 ishte Italia vendi pritës. "Shtabi im e organizoi këtë stërvitje në 2016. E shoh, që tani qasja ndaj objektivave është realitet. "Grupi i anijeve të gatshme" është realitet dhe partneriteti mes nesh tani është më i fortë, u shpreh ndër të tjera kundëradmiral Biaggi.

Stërvitja "ADRION CAX-LIVEX" e cila zhvillohet çdo vit, ka për objektiv nxitjen e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë si dhe rritjen e ndërveprueshmërisë midis forcave detare të ADRIONIT,

nëpërmjet zhvillimit të skenarëve që kanë të bëjnë me sigurinë detare në detin Adriatik dhe detin Jon.

Në të morën pjesë rreth 300 efektiva, 6 anije nga të cilat, dy të Forcës Detare Shqiptare dhe 1 helikopter i Forcës Ajrore. Në stërvitje morën pjesë gjithashtu Italia, Greqia, Kroacia dhe Mali i Zi me nga një anije. Sllovenia dhe Flota e 6-të amerikane morën pjesë me oficerë shtabi.

Kjo stërvitje u planëzua dhe zhvillua nën drejtimin e Forcës Detare Shqiptare, dhe vendi ynë është për të tretën herë. Për herë të parë kjo stërvitje u zhvillua në vendin tonë në vitin 2009 më pas në 2015 dhe së treti në 2018. Gjithashtu Forca Detare merr pjesë çdo vit në këtë stërvitje e cila zhvillohet në vendet e rajonit sipas rotacionit.



# Janë realizuar gjithsej 600 misione fluturimi

**M**ë datë 28 qershor 2018, në Komandën e Forcës Ajrore u zhvillua analiza për realizimin e objektivave dhe detyrave kryesore të planëzuara për 6 mujorin e parë për vitin 2018. Në analizë morën pjesë komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, komandantët e reparteve dhe shefat e degëve në shtabin e Forcës Ajrore. Materiali i analizës i mbajtur nga kolonel Emëror Hajdarasi, evidentoi punën e bërë për realizimin e detyrave të vëna, treguesit kryesorë që janë arritur gjatë këtij 6 mujori, si dhe u përcaktuan synimet dhe objektivat kryesore për të ardhmen.

Gjatë këtij 6 mujori, krahas realizimit të detyrave sipas misionit dhe fushave të përgjegjësisë, siç janë angazhimi për përballimin e emergjencave civile, operacionet e kërkim - shpëtimit pa marr parasysh kushtet e vështira të motit dhe terrenit, stërvitjet e përbashkëta në të cilat Forca Ajrore ka marrë pjesë dhe ka mbështetur me helikopter Forcën Tokësore, Detare dhe njësisë të tjera të Forcave të Armatosura, një vend të rëndësishëm kanë zënë edhe stërvitjet e përbashkëta me NATO, pjesëmarrja e personelit dhe helikopterit Cougar në stërvitjen shumëkombëshe të koduar "Adriatic Strike 18", në Slloveni.

Në fjalën e tij komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj vlerësoi punën e personelit të Forcës Ajrore në realizimin e



detyrave, duke u shprehur se në themel qendron modernizimi afatmesëm i Forcës Ajrore. Gjatë këtij 6 mujori kjo Forcë ka përballuar dhe kryer me sukses çdo operacion dhe stërvitje, si dhe janë realizuar gjithsej 600 misione fluturimi ku kontribues është i gjithë personeli i Forcës Ajrore duke realizuar kështu një mozaik strukturash për realizimin e misionit.

Në përfundim komandanti i

Forcës Ajrore theksoi se pavarësisht arritjeve të deritanishme dhe profesionalizmit të treguar në mbështetje të realizimit të misionit dhe detyrave të Forcës Ajrore, mbetet si prioritet dhe domosdoshmëri realizimi i detyrimeve dhe objektivave për 6 mujorin e dytë të vitit 2018. Prioritet mbetet modernizimi i Forcës Ajrore me radarë, të cilët janë aset i dobishëm për operacionet me NATO.

## FORCA AJRORE: QËNDRA STËRVITORE-KUÇOVË

### Kursi bazë i n/oficerit, specialiteti Seksioni Ajror

Në datën 22 Qershor 2018, në ambientet e Garnizonit të Kuçovës (Repartit Usharak Nr. 3004 dhe Nr. 3005), u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të cilët përfunduan Kursi Bazë i N/Oficerit, Specialiteti-Seksion Ajror, në Qendrën Stërvitore të Forcës Ajrore. Në këtë ceremoni nga Komanda e Forcës Ajrore mori pjesë Shefi i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes Kolonel Emëror Hajdarasi, përfaqësues nga Baza Ajrore Kuçovë si dhe personeli instruktor dhe kursant i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore.

Shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore n/kolonel Kuli, falënderoi në mënyrë të veçantë Komandantin e Forcës Ajrore për interesin dhe kujdesin e vazhdueshëm të treguar për këtë qendër si dhe për bashkëpunimin me Bazat Ajrore Kuçovë dhe Farkë, të cilat bënë të mundur sigurimin e gjithë infrastrukturës së duhur për krijimin e kushteve normale për jetesë, trajnim dhe stërvitje të personelit kursant të ardhur nga repartet e ndryshme të Forcës Ajrore si dhe në të njëjtën kohë zhvillimin dhe përfundimin me sukses të këtij kursi si për pjesën teorike ashtu edhe për atë praktikë të realizuar pranë këtyre reparteve.



Kolonel Hajdarasi, falenderoi në emër të Komandantit të Forcës Ajrore, personelin e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore si dhe kursantët, për angazhimin e përbashkët me qëllim, realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij kursi në të gjitha etapat e zhvillimit të tij. Në fjalën e tij, theksoi rëndësinë e procesit të arsimimit dhe kualifikimit të personelit ushtarak në Forcat e Armatosura të RSH, në përputhje të plotë me Konceptin e ri të Arsimimit dhe Trajnimit Individual të Personelit, si me kërkesat aktuale që shtrën koha dhe teknologjia ashtu edhe me proceset e standardizimit të cilat

janë tashmë pjesë përbërëse reale e aktivitetit arsimor/stërvitor dhe operacional të Forcës Ajrore dhe të FARSH.

Kursin Bazë të N/Oficerit të Forcës Ajrore zhvillohet për herë të parë pas miratimit të Konceptit të ri të Arsimimit dhe Trajnimit Individual në FARSH, në total 24 javë arsimim/stërvitje dhe trajnim dhe 12 javë nga këto, janë zhvilluar vetëm në Qendrën Stërvitore dhe në repartet e Forcës Ajrore". Ceremonia vazhdoi me shpërndarjen e certifikatave për kursantët pjesëmarrës si dhe u mbyll me një foto të përbashkët në ambientet e Garnizonit Kuçovë.

#### FA: DY VAJZA, PJESË E KËRKIM-SHPËTIMIT

### Egzime Muça, Margarita Gjerko pjesë e togës ujore

Dy vajza, ushtarë të reja të Forcave të Armatosura po stërviten për t'u bërë pjesë e togës së ujit. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka shprehet se "nuk mendoj se e ekzagjeroj nëse i quaj ëngjëj mbrojtës, pasi detyra e tyre është kërkim-shpëtimi në raste të fatkeqësive. Por, për herë të parë 2 vajza, ushtarë të reja të FA po stërviten për t'u bërë



pjesë e togës ujore". Ushtarja e parë Egzime Muça, tregon se në janar të 2017 ka bërë kursin bazë dhe më pas atë të avancuar. "Kur kam ardhur në fillim pashë djemtë që po bënë stërvitje ujore dhe thashë pse mos ta provoj dhe unë, e ndieja të aftë veten që unë mund

të bëja stërvitje ujore", tregon Muça. Djemtë janë pak më të stërvitur dhe më të aftë, por shton ajo, me kalimin e kohës mund t'i arrijmë edhe ne. Edhe ushtarja tjetër e parë Margarita Gjerko, shprehet se "mora vesh për punën e Forcave të Armatosura, bëra stërvitjen që duhej për të bërë provimet dhe u futa në kurs. Në shtator 2017 bëra kursin bazë e të avancuar.

Pas 6 muaj kurs në shkurt 2018 fillova punë". Gjerko thekson se "kur më njoftuan që jam në kompaninë e kërkim shpëtitimit, nuk e dija se çfarë bëhej në fillim. Më pas isha tek përmbytjet dhe zjarret, por dhe stërvitja që bëhet në ujë mendoj se nuk është e vështirë".



**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, ka inspektuar më datë 29qershor paradite rreshtimin e grup - batalionit të Këmbëorisë së Lehtë.

Gjeneral brigade Kollçaku shprehu vlerësimet e tij për përgatitjen e deritanishme për të gjithë personelin e grup - batalionit të Këmbëorisë së Lehtë, të këtij reparti objektiv kombëtar: "Jam i bindur se puna, mundi, dhe sakrificat juaj do të shpërblehen ashtu siç duhet në muajin shtator me marrjen e certifikimit, i cili do të vijë si rrjedhojë e përpjekjeve të përbashkëta në kuadrin e realizimit të detyrave. Ju siguroj se qeveria

## FORCA TOKËSORE

# Gjeneral Kollçaku inspekton stërvitjen "Albanian Lion-Biza 18"

shqiptare, ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, do të jenë gjithmonë përkrah jush në realizimin e këtij objekti madhor", - u shpreh ndër të tjera në përshëndetjen e tij gjeneral brigade Kollçaku.

Gjatë inspektimit, komandanti i grup - batalionit të Këmbëorisë së Lehtë, kolonel Arjan Hilaj, e njohu gjeneral brigade Kollçakun me punën e bërë si dhe me problematikat e hasura deri tani gjatë përgatitjes për

stërvitjen "Albanian Lion-Biza 18".

Në përfundim të inspektimit, gjeneral brigade Kollçaku falenderoi komandantin e Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani si dhe komandantin e GBKL kolonel Arjan Hilaj, për punën shumë të mirë të bërë deri tani dhe për masat organizative sipas standardeve të NATO-s, në drejtim të pajisjeve dhe trajnimit të grup - batalionit të Këmbëorisë së Lehtë.

## BATALIONI I KËMBËSORISË

# Zhvillohet stërvitja "Ndërveprimi 2018"

**P**ër katër ditë me radhë, në Rajonin e Bizës toga e ndërlidhjes së grup batalionit të këmbëorisë së lehtë, zhvilloi stërvitjen "Ndërveprimi 2018". Stërvitja "Ndërveprimi 2018", u organizua, planëzua dhe konceptua si një stërvitje tre shkallësh, me qëllim trajnimin, aftësimin dhe testimin e personelit ndërlidhës që shërben në Forcat e Armatosura.

Në ceremoninë e "Ditës së Vizitorëve të Shquar", të stërvitjes "Ndërveprimi 2018" ishte i pranishëm Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, kolonel Petrit Çuni i shoqëruar dhe nga drejtorë drejtorish në Shtabin e Përgjithshëm

Stërvitja "Ndërveprimi 2018", si një nga stërvitjet më të rëndësishme të shërbimit të ndërlidhjes për vitin 2018, , fokus të saj pati edhe testimin e gjendjes reale të gatishmërisë teknike dhe operacionale të sistemeve

të ndërlidhjes dhe informacionit të Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, të komandave të forcave si dhe atyre mbështetëse e reparteve autonome në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



## Batalioni i Parë i Këmbësorisë

# Realizohet me sukses stërvitja “Mnela 2018”

“Mnela 2018” ishte kodi i stërvitjes së radhës së zhvilluar për rreth dy javë nga efektivat e batalionit të Parë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore. Kjo stërvitje ishte e llojit “stërvitje fushore” dhe u zhvillua në rajonin e Vaut të Dejës. “Mnela 2018” kishte si qëllim të saj rritjen e nivelit të përgatitjes luftarake të personelit të b1kFT për të reaguar nën efektin e kushteve specifike të terrenit dhe të motit si dhe kompaktësimi i veprimeve në nivel kompani/batalion të operacioneve në kuadër të Emergjencave Civile.

Stërvitja dy javore kishte si objektiva të saj rritjen e nivelit të planizimit organizimit dhe zhvillimit të stërvitjes në kushte fushore; përfeksionimi i teknikave të luftimit në kërkim-shpëtim; zbatimi i procedurave standarte për planizim organizim dhe drejtim të operacioneve të Emergjencave Civile etj.

Nga i gjithë efektivi i batalionit të Parë të Këmbësorisë pati angazhim dhe përkushtim maksimal për realizimin e cdo detyre të ngarkuar. Një punë mjaft e mirë u bë edhe nga ana e Shtabit të këtij batalioni në drejtim të planizimit dhe organizimit të stërvitjes.

Kjo stërvitje u ndoq kontrollua dhe këshillua në cdo hap të saj nga komandanti i b1kFT n/ kolonel Ali Mali, i cili nga ana e tij në përfundim të

stërvitjes falenderoi të gjithë efektivat e angazhuar në “Mnela 2018” për përkushtimin disiplinën dhe profesionalizmin e treguar. N/ Kolonel Mali i inkurajoi trupat që ai drejton që të njëjtin përkushtim dhe disiplinë të tregojnë edhe në stërvitjet e tjera të kësaj natyre.

Stërvitja “Mnela 2018” kishte në fokus të saj reagimin ndaj Emergjencave Civile, situata këto që janë tepër reale dhe të freskëta për efektivat e b1kFT gjatë vitit të kaluar si në stinën e nxehtë të verës ashtu edhe gjatë situatës së përmbytjeve ku ky batalion mbajti peshën kryesore të operacioneve të Forcës Tokësore. “Tokësorët” e b1kFT me këtë nivel profesionalizmi premtajnë



se do të jenë gjithmonë në ballë të punës sa herë që të kërkohet nevoja e tyre.

**Toger Gerta Elezi**  
**Batalioni i I-rë i**  
**Këmbësorisë FT**



## Policia Ushtarake zhvillon stërvitjen “Biza 18”

Policia Ushtarake ka zhvilluar stërvitjen kompaktësuese “Biza 18”, me dalje në fushim në rajonin e Bizës. Qëllimi i kësaj stërvitje ishte aftësimi i strukturave të planëzimit në Shtab, rritja e njohurive për planëzimin e operacioneve, aftësimi i elementeve të Komandim Kontrollit të n/reparteve operacionale të Policisë Ushtarake, zhvillimi i kapaciteteve reaguese për mbështetjen e Forcave të Armatosura të angazhuara në emergjencat civile si dhe testimi i kapaciteteve operacionale të kësaj strukture në operacione OMP (brenda dhe jashtë vendit). Në ceremoninë e “Ditës së Vizitorëve të Shquar” të stërvitjes “Biza 18”, ishin të pranishëm drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, kolonel Petrit Çuni, si dhe drejtorë drejtorish në Shtabin e Përgjithshëm, të cilët ndoqën nga afër një demonstrim të trupave, ku improvizuan incidente (ushtrime), me tematikë nga skenari i stërvitjes, për testimin dhe kompaktësimin e n/reparteve të Policisë Ushtarake.

# Bashkëpunimi ynë do të shënojë rritje të mëtejshme

*Komandanti i Gardës Kombëtare të New Jersey vizitë në Forcat Tokësore*

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, priti paraditen e datës 14 qershor komandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey, gjeneral brigade Jemal J. Beale dhe stafin që e shoqëronte atë. Gjeneral Cahani, pasi i uroi mirëseardhjen komandantit të Gardës Kombëtare të New Jersey, në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore (KFT), e vlerësoi vizitën e gjeneral Beale, si shenjë të marrëdhënies të shkëlqyera që ekzistojnë midis vendeve tona dhe në veçanti midis Forcave të Armatosura. Komandanti i Forcës Tokësore, përfitoi nga rasti t'i shprehte gjeneral Beale mirënjohjen e tij personale, por edhe në emër të trupave që ai drejton, për mbështetjen e jashtëzakonshme që Garda e New Jersey, ka dhënë dhe vazhdon të jap për Forcën Tokësore, nëpërmjet planeve të bashkëpunimit dhe të trajnimit si dhe nëpërmjet mbështetjes logjistike.

Bashkëpunimi i frytshëm në luftën kundër terrorizmit dhe angazhimi në misionet në kuadër të NATO-s i trupave "tokësore" me ushtarakët e shkëlqyer të Gardës së New Jersey, ishte një tjetër pikë në të cilën u ndal gjeneral Cahani, në takimin me gjeneral Beale. Nga ana e tij komandanti i Gardës Kombëtare të New Jersey, gjeneral brigade Jemal J. Beale, falenderoi gjeneral Cahanin për pritjen e ngrohtë dhe miqësore në ambientet e KFT. Ai, shprehu kënaqësinë e vizitës së tij në Komandën e Forcës Tokësore si Forca kryesore e Forcave të Armatosura Shqiptare. Gjeneral Beale, vlerësoi me nota pozitive bashkëpunimin e



shkëlqyer me ushtarakët shqiptarë, duke theksuar njëkohësisht përgatitjen e tyre të lartë profesionale. Komandanti i Gardës së New Jersey, shprehu besimin e tij të plotë, se niveli i bashkëpunimit të deritanishëm në të ardhmen do të shënojë rritje të mëtejshme. Temë e bisedimeve midis dy ushtarakëve të lartë, ishte edhe lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ku nga ana e gjeneral Beale u vlerësua roli, kontributi dhe angazhimi i Shqiperisë

dhe ushtarakëve shqiptarë, në këtë drejtim. Takimi vijoi me një briefing njohës me historikun, misionin detyrat dhe angazhimet e Forcës Tokësore, në operacionet si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në këtë briefing, morën pjesë gjithashtu edhe komandanti i batalionit të Dytë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore, repart ky prioritet dhe bërthamë e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL), si dhe komandanti i Akademisë së Nënoficerave "Thomson."

Komandanti i Gardës së New Jersey, dhe stafi që e shoqëronte, vazhduan vizitën e tyre tek batalioni i Forcave Speciale ku u pritën nga komandanti i këtij batalioni elitë të FT, kolonel Ilirjan Dauti i cili i njohu ushtarakët amerikanë, me misionin, detyrat dhe angazhimet e repartit që ai drejton, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese.

## GJENERAL BRIGADE NAZMI CAHANI, PRITI EKIPIN AMERIKAN

# Vlerësime pozitive nga Qendra e Gjuhës Angleze-Teksas

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, priti një ekip nga Qendra e Gjuhës Angleze (Defense Language Institute English Language Center DLIELC), Teksas SHBA, të përbërë nga kapiten Sarah Flournoy, Z. David Gilson. Në takimin e zhvilluar në mjediset e Komandës së Forcës Tokësore, gjeneral brigade Cahani pasi i uroi mirëseardhjen ekipit amerikan, vlerësoi kontributin e jashtëzakonshëm që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për rritjen profesionale të ushtarakëve shqiptarë.

Duke e vlerësuar njohjen e anglishtes, si një domosdoshmëri për të gjithë ushtarakët shqiptarë, komandanti i Forcës Tokësore, gjeti rastin të falënderojë dhe shprehë mirënjohjen e tij personale, për mbështetjen që efektivat që ai drejton, kanë gjetur tek miqtë amerikanë, nëpërmjet suportit logjistik për ngritjen e laboratorëve dhe paisjen me literaturën në bashkëkohore në këtë drejtim, por edhe në lidhje me trajnimin e personelit të Qendrës së Gjuhës së Huaj të Forcës Tokësore, në Shtetet e Bashkuara.

Nga ana e tyre, pjesëtarët e ekipit amerikan, duke shprehur kënaqësinë e vizitës në KFT, falënderuan gjeneral Cahanin për pritjen e ngrohtë dhe miqësore. Ata, vlerë-



suan me nota pozitive bashkëpunimin e deri tanishëm midis dy vendeve dhe Forcave të Armatosura respektive, duke vlerësuar njëkohësisht edhe përkushtimin e ushtarakëve shqiptarë, në lidhje me përvetësimin sa më të mirë të anglishtes si gjuhë zyrtare e NATO. Delegacioni amerikan, vazhdoi më tej vizitën në ambientet e Qendrës së Gjuhës së Huaj të Forcës Tokësore, ku u njoh nga afër me ambientet e punës dhe procesin mësimor që zhvillohet në këtë qendër. Nderkohë ekipi amerikan ka zhvilluar vizita edhe në komanen e Forcës Detare Komandës Mbështetëse dhe Qendrën e Gjuhëve të Huaja.

# Përfundon me sukses “Kursi bazë i nënoficerit”

MAJOR ERVIN HODO

**D**itën e premte datë 22 Qershor, Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore, organizoi ceremoninë e përfundimit të “Kursit bazë të nënoficerit” specialitetet “këmbësori” dhe “kimi”. Në aktivitetin e zhvilluar në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, përveç kursantëve që përfunduan kursin, stafit drejtues dhe atij mësimdhënës të QSFT merrnin pjesë gjithashtu edhe përfaqësues nga shtabi i Forcës Tokësore. Ceremoninë e hapi komandanti QSFT kolonel Dritan Stroni, i cili fillimisht përgëzoi të gjithë kursantët për mbylljen me sukses të trajnimit gati tre mujor, në Qendrën që ai drejton. Më tej, ai i falënderoi ata për seriozitetin, disiplinën dhe përkushtimin e treguar gjatë gjithë periudhës së programit arsimor.

Një falënderim të veçantë, komandanti i QSFT adresoi edhe për Komandën e Forcës Tokësore, për mbështetjen e pakursyer që gjeti gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të kursit. Duke u shprehur i bindur, se të gjithë objektivat e kursit u realizuan në mënyrë të shkëlqyer nga të gjithë pjesëmarrësit, kolonel Stroni iu uroi kursantëve suksese në karrierë.

Në emër të kursantëve, ceremoninë e përshëndeti n/tetar Irida Hyka, e cila falënderoi stafin akademik të Qendrës Stërvitore, për përkushtimin gjatë mësimdhënies si dhe premtoi në emër të kolegëve të saj, se dijet e fituara në këtë kurs do t'i venë në praktikë në repartet ku shërbejnë.

Kjo ceremoni, në emër të Ko-



mandës së Forcës Tokësore, u përshëndet gjithashtu edhe nga shefi i G-5/8 në FT kolonel Bilbil Bitri. Duke i përgëzuar kursantët, për përfundimin me sukses të njërit prej kurseve të më rëndësishme në karrierën e tyre, kolonel Bitri përcolli tek ata njëkohësisht edhe përgëzimet dhe urimet e komandantit të Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani.

“...kursi që ju përfunduat sot, nuk është thjesht plotësimi i një programi akademik, por përkundrazi ky kurs është shumë më të tepër, ai është një mundësi më shumë në rrugën e karrierës tuaj ushtarake. Njohuritë e marra këtu, do t’iu ndihmojnë jashtë mase në repartet ku ju shërbeni nëse do të dini t’i vendosni në punë. Ky kurs, është një tullë e shtuar në murin e karrierës së vështirë ushtarake. Unë shpresoj shumë, që ju nuk do e ndaloni

arsimimin tuaj me përfundimin e këtij kursit. Jeni kërkues ndaj vetes, punoni shumë dhe me këmbëngulje dhe do të shikoni që rezultatet nuk do mungojnë...” - tha ndër të tjera kolonel Bitri.

Ceremonia, vazhdoi me ndarjen e certifikatave për kursantët dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Kursi bazë i nënoficerit për specialitetin “këmbësori” dhe “kimi”, u zhvillua në periudhën 3 prill deri 22 qershor 2018. Ky kurs u ndoq nga 32 kursantë të gradës nëntetar. Ndër temat kryesore që u zhvilluan gjatë tre muajve të trajnimit nga kursantët ishin: taktikë, përgatitje zjarri, njohuri mbi armët e Demtimit në Masë dhe mbrojtja nga to. Temat e përgatitjes së mbrotjes kundër kimike, u zhvilluan në bashkëpunimin të ngushtë me kompaninë e MADM të Forcës Tokësore.



## Municionet e paplasura, Xhaçka:

# Brenda 2019 asnjë zonë e rrezikshme në Shqipëri

**P**ër më shumë se 20 vite, hotspoti i Suçit në Burrel ka qenë një prej pikave më të rrezikshme për shkak të municioneve të paplasura. Efektivët e Kompanisë së Asgjësimit të Municioneve (EOD- Explosive Ordnance Disposal) të Komandës Mbështetëse në Forcat e Armatosura, për më shumë se 1 muaj bënë të mundur pastrimin e plotë të zonës. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka gjatë takimit me efektivët e EOD në terren, deklaroi se tashmë i kthehen komunitetit 84 mijë metra katrorë të çertifikuar, të pastër dhe të sigurt.

“Janë rreth 84 mijë metra katrorë që i kthehen komunitetit që tanimë janë të çertifikuara, të pastra dhe të sigurt. Efektivët tanë kanë rreth 1 muaj që punojnë këtu. Ka qenë një zonë goxha e pasigurt dhe paraqiste rrezikshmëri të lartë për shkak të municioneve të paplasura qysh prej vitit 97. Bashkë me hot spotin e Selicës që gjykojmë që ndoshta pas 5 muajve do ta mbarojmë edhe atë, i kemi kthyer komunitetit gjatë gjithë kësaj periudhe 17 hot spote, mijëra metra katrorë të pastruar dhe të sigurt për përdorim civil. Dhe për vitin 2019, ambicia jonë është që të

“Janë rreth 84 mijë metra katrorë që i kthehen komunitetit që tanimë janë të çertifikuara, të pastra dhe të sigurt.

përfundojmë edhe 2 hot spotet e fundit për t'i kthyer edhe ato komunitetit, duke i çertifikuar të pastra dhe të sigurt”, u shpreh ministria. Ministria e Mbrojtjes vlerësoi efektivët e FA, për punën e jashtëzakonshme në këtë mision kaq të rëndësishëm dhe për ndihmën që po i japin komunitetit në këto zona.

Zyra e Koordinimit të Minave

dhe Municioneve (AMMCO), si një strukturë e specializuar e

Ministrit të Mbrojtjes, një ekip profesionistësh, i ndërtuar gjatë dekadës së fundit me mbështetjen e PNUD-it dhe donatorëve të ndryshëm, koordinon dhe monitoron operacionet e pastrimit të municioneve të paplasura në hotspote dhe njëherësh bën certifikimin e zonave pas pastrimit të plotë të tyre.

## Uzina e Baterive Gramsh, pastrohet nga Kimikatet

*Nga Uzina e Baterive, Gramsh u zhvendosën në depot e Forcave të Armatosura rreth: 27 850 kg blözë; 4400 kg grafit i shndritshëm; 3300 kg arka me rrëshirë; 300 kg arka me material të ndryshme për bateritë; 500 kg shishe me reagent kimik; 100 kg vaj lungar, etj.*

**P**araditen e datës 5 qershor 2018 është zhvilluar një ceremoni e veçantë me rastin e përfundimit të operacionit për riambalazhimin dhe zhvendosjen e kimikateve nga ish Uzina e Baterive, Gramsh për në depot e Komandës së Mbështetjes, duke e bërë zonën për rreth uzinës më të sigurtë dhe të mbrojtur për jetën e banorëve.

Në ceremoni ishin të pranishëm zëvendëseshif i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade, Manushaqe Shehu, Prefekti i Elbasanit z. Maksim Malaj, Kryetari i Bashkisë së Gramshit, znj. Luljeta Dollani, Komandanti i Komandës së Mbështetjes, kolonel Gaspër Lala, komandanti batalionit të Mbështetjes me Luftim në FT, Nënkolonel Lavdërim OSHAFI, banorë të zonës, ushtarakë etj.

Gjeneral brigade Shehu, në fjalën e saj në ceremoni, pasi falënderoi personelin ushtarak të Forcës Tokësore dhe të Komandës së Mbështetjes për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar për realizimin e këtij operacioni të vështirë dhe delikat për jetën e njeriut-, u shpreh ndër të



tjera: "Forcat e Armatosura nën drejtimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe në kryerje të misionit të tyre kushtetues kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë pranë njerëzve, pranë pushtetit lokal për të dhënë ndihmën komunitetit në çdo rast që përballeni me emergjencë civile, për të shpëtuar jetë njerëzish, objekte, për të ndikuar në përmirësimin e ambientit, për ta bërë jetën e njerëzve më të sigurt, siç është edhe rasti konkret me largimin e mbetjeve kimike në ish Uzinën e Baterive këtu në Gramsh. Falë këtyre masave dhe këtij bashkëpunimi të shkëlqyer me Pushtetin Lokal, sot banorët e kësaj zone e ndjejnë veten më të sigurt. Edhe në të ardhmen Forcat e Armatosura do të jenë pranë jush në përballimin e çdo nevojë emergjente që mund të paraqitet, jo vetëm në këtë prefekturë, por në të gjithë Shqipërinë".

Nga ana e tyre, prefekti i Elbasanit, z. Malaj dhe Kryetari i Bashkisë së Gramshit znj. Dollani vlerësuan kontributin e Forcave të Armatosura dhe sidomos të personelit ushtarak të angazhuar në këtë operacion, i cili bëri të mundur largimin e mbetjeve nga ish uzina, por edhe për angazhimin dhe kontributin e dhënë në tërësi për përballimin e emergjencave civile në këtë prefekturë. Në operacionin e riambalazhimit dhe zhvendosjes së kimikateve nga ish Uzina e Baterive, Gramsh për në depot e Komandës së Mbështetjes, i cili filloi më 23 prill dhe përfundoi 5 qershor 2018, u angazhuan efektive nga Forca Tokësore dhe Komanda Mbështetëse. Gjatë këtij operacioni u riambalazhuan dhe u zhvendosën në depot e Forcave të Armatosura rreth: 27 850 kg blözë; 4400 kg grafit i shndritshëm; 3300 kg arka me rrëshirë; 300 kg arka me material të ndryshme për bateritë; 500 kg shishe me reagent kimik; 100 kg vaj lungar, etj.

**K**ëshilli i Ministrave ka miratuar më 9 maj 2018, vendimin Nr.246, "Për miratimin e planit kombëtar për integrimin Evropian 2018-2020". Në kemi shkëputur nga ky plan voluminoz, pjesën që ka të bëjë me Ministrinë e Mbrojtjes, "Shkatërrimi i municioneve të tepërta". Vendimi i qeverisë ka hyrë në fuqi, sepse ai është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.69, date 16 maj 2018.

\*\*\*

Bazuar në direktivën e ministrit të Mbrojtjes për vitin 2016 dhe 2017, si dhe në urdhrat e ministrit të Mbrojtjes nr:1508, datë 28.7.2016, "Për shkatërrimin dhe asgjësimin e municioneve të tepërta, jashtë nevojave të tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe pa vlera shitje, gjatë vitit 2016" dhe urdhrat nr: 1311, datë 4.7.2017, "Për miratimin e listës së municioneve tepër dhe jashtë nevojave të tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, pa vlera shitje dhe për çmilitarizimin industrial të tyre, brenda vitit 2017", Ministria e Mbrojtjes ka çmilitarizuar municione tepër të dala nga tabela e organizimit dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura pas vitit 2015, si rrjedhojë e modernizimit të Forcave të Armatosura dhe municioneve të mbledhura nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjatë periudhës 2016-2017, 290 ton municione të tepërta janë shkatërruar.

Si pjesë e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe PNUD-it, "Për mbështetjen e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta dhe sigurisë fizike, si dhe të aktiviteteve të menaxhimit të stokeve në Shqipëri", miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr: 257, datë 6.4.2016, Ministria e Mbrojtjes në vitin 2016 ka shkatërruar 1,987 armë të vogla dhe të lehta të kategorizuara si tepëricë nga Forcat e Armatosura Shqiptare. Ky aktivitet financohet nga EUSAC (përmes vendimit të Këshillit të BE-së 2013/730/CFSP).

### Programi i pastrimit të pikave hotspot të armëve të pashpërthyera (UXO)

Një sipërfaqe prej 178.002 m<sup>2</sup> është pastruar nga municionet në gjashtë zona të ndryshme si: Laç, Klos, Kordhok, Picar, Jub-Sukth dhe Selixe. Në total 417.814 mjete shpërthyese të rrezikshme që përfshijnë municione artilerie, diegore, granata dore, predha kundër tanke, municione të armëve të vogla janë gjetur dhe shkatërruar në këto hotspote. Toka

“Integrimi Evropian 2018-2020”

# Shkatërrimi i municioneve të tepërta

*Këshilli i Ministrave ka miratuar më 9 maj 2018, vendimin Nr.246, “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin Evropian 2018-2020”.*

e pastruar në katër hotspote me municione në Laç, Klos, Kordhoc dhe Picar është certifikuar si e pastër nga municionet dhe i është dorëzuar autoriteteve lokale për përdorim të mëtejshëm. Plani është për të pastruar katër hotspotet: Jubë-Sukth Durrës dhe Sinanaj Tepelenë nga organizata ndërkombëtare e pastrimit Norwegian People's Aid (NPA), si dhe dy hotspotet e tjera: Selixhe dhe Suç në Burrel nga Kompania EOD (Explosive Ordnance Disposal) e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

## **Mospërhapja e armëve të dëmtimit në masë (CWMD)**

Në përputhje me urdhrin e Kryeministrit nr.79, datë 12.5.2016, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe planin e veprimit për zbatimin e tij”, grupi ndërinstitucional i punës është ngritur.

Ai drejtohet nga zëvendësministri i Mbrojtjes. Grupi ka përgatitur draftin strategjik kombëtar. Për këtë dokument, të gjitha institucionet kanë dhënë miratimin e tyre. Gjithashtu, draft strategjia është publikuar në faqen elektronike të Ministrisë së Mbrojtjes. Aktualisht, grupi i punës po punon me Planin e Veprimit për zba-

timin e strategjisë. Drafti i Planit të Veprimit është përfunduar dhe është dërguar tek institucionet përkatëse për mendim. Gjithashtu, të gjitha institucionet e përfshira në proces janë ngarkuar me detyrën e përgatitjes së një parashikimi të përafërt të kostos, përpara dërgimit të dy dokumenteve për miratim në Këshillin e Ministrave. Në përputhje me vendimin e Këshillit të BE-së të datës 9 dhjetor 2013 dhe Strategjisë së BE-së për luftën kundër grumbullimit, magazinimit dhe trafikimit të jashtëligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta (SALW) dhe municioneve të paligjshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP-së dhe SEESAC kanë ngritur grupin e punës për Komitetin Ndërmintor për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) në Republikën e Shqipërisë.

Detyra kryesore është hartimi i dokumentit strategjik për AVL-të dhe Planit përkatës të Veprimit. Ky komitet do të shërbejë si organ koordinues midis agjencisë dhe institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e politikave, kërkimin, bashkërendimin, zbatimin dhe monitorimin e përpjekjeve për të parandaluar, luftuar dhe eliminuar tregtinë e paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta dhe

për të adresuar në nivel kombëtar problemet, pasojat dhe çështjet që lidhen me të gjitha aspektet e AVL-ve. Aktualisht po krijohet një grup pune në nivel kombëtar, i cili do të fillojë të zhvillojë draftin e parë të kësaj strategjie. Policia e Shtetit krijoi në vitin 2015 një regjistër elektronik kombëtar për të ruajtur të dhënat për të gjitha armët e vogla dhe të lehta në vend.

Përmes mbështetjes së UNDP-së dhe SEESAC-it, që rrjedh nga vendimi i Këshillit të BE-së 2013/730/CFSP, Policia e Shtetit ka instaluar këtë vit pajisje të TI-së, përfshirë 110 kompjuterë, 110 UPS, 60 printerë, 15 skanerë, një server dhe gjashtë pajisje switch në stacionet dhe drejtoritë e policisë në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, personeli i policisë është trajnuar në përputhje me përdorimin e bazës së të dhënave të regjistrit të armëve. Regjistri elektronik do të përmirësojë gjithnjë e më shumë kapacitetet kombëtare për të kontrolluar në mënyrë efektive dhe efikase posedimin dhe për të pasur shënime të sakta për armët e vogla dhe të lehta në Shqipëri. Përveç kësaj, krijimi i këtij regjistri elektronik do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe ekspertizës së rajonit të Evropës Juglindore, për të luftuar trafikimin dhe posedimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, duke zvogëluar në të njëjtën kohë kërcënimin për paqen, stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Përveç kësaj, Drejtoria e Policisë së Shtetit ka përgatitur një plan për dhënien e “autorizimit të posedimit të armëve” dhe po bën përpjekje për t'i lëshuar këtë dokument të gjithë qytetarëve që posedojnë armë. Prodhimi i këtyre kartave elektronike do të konsistojë në grumbullimin e të dhënave nga regjistri elektronik i regjistrimit të armatimit.

Nga ana tjetër, personalizimi i kartave të autorizimit të armëve do të përfshijë një sërë elementesh sigurie, si: me ose pa çip, hologramë, model guilloche, shkrim mikro-tekst, petëzim me fjalë dhe elemente sigurie, detaje të identifikimit të nxjerra nga regjistri elektronik i armatimit etj. Ky projekt do të mundësojë kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të brezit në të gjithë vendin. Sa u përket VKM-ve, në kuadër të ligjit për armët janë miratuar 6 VKM, të cilat në tërësi përbëjnë strukturën e plotë për administrimin e armëve të vogla dhe armë brezi në të gjithë Shqipërinë.

Në fushën e kontrollit të eksportit të produkteve dhe pajisjeve ushtarake, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, ka përditësuar listën ushtarake, në përputhje me listën ushtarake të Bashkimit Evropian CFSP 2015/C129/01.



# BCU-të të ndjekin ritmin e zhvillimeve në FA


NGA SHEFQET KËRCELLI

**G**jatë dy ditëve 30 dhe 31 maj 2018, në Komandën Mbështetëse të FA-së, nga Drejtoria e BCU (Bashkëpunim Civil-Ushtarak) në Shtabin e përgjithshëm të FA-së, u zhvillua seminaripër kualifikimin e specialistëve dhe personelit të BCU që shërben në Forcat tona të Armatosura.

Ështëfakt qëDrejtoria e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në Shtabin e Përgjithshëm të FA, gjatëkëtyre viteveka organizuar dhe zbatuar plane, projekte, seminare e aktivitete të shumta, për kualifikimin dhe trajnimin jo vetëm të personelit që shërben në këtë sektor në shtabe dhe reparte, por dhe drejtuesve të niveleve të ndryshme në FA. Veçori e këtyre seminareve të realizuara ka qenë larmia e çështjeve të ndryshme me të cilën përballen çdo ditë specialistët e këtij sektori gjatë realizimit të detyrave të përditëshme, por dhe prania e lektorëve nga institucione të ndryshme shtetërore të vendit dhe atyre të huaj, kryesisht amerikanë, të cilët kanë shkëmbyer përvojën e tyre në përballimin e situatave emergjente dhe operacioneve luftarake në terren, brenda e jashtë vendit, sidomos atyre paqeruajtëse. Seminari i zhvilluar në fund të muajit maj, kishte si qëllim kryesor detyrat që zgjidhin degët, qendrat dhe personeli i CIMIC në Forcat tona të Armatosura, bazuar në dokumentacionin, kërkesat dhe standartet e NATO-s.

Mbas njohjes me personelin që shërben në këtë sektor, Kolonel Zaho Golemi, i sapo emëruar në këtë detyrë shpjegoi momentet kryesore të karrierës së saj si ushtarak dhe më pas theksoi ambicjon për të ngritur në një nivel më të lartë efektivitetin e punës dhe performancën e sektorit të BCU, në kuadër të detyrave të shumta që ka ky personel brenda FA dhe aleancës

Prezantohet Drejtori i Drejtorisë së BCU në FA, Prof.as.Doktor. Kolonel Zaho Golemi



EuroAtlantike.

Në vijim të programit të ditës së parë, N/Kolonele Silvana Lahi, shpjegoi misionin, qëllimin dhe detyrat e sektorit si dhe njohuri të përgjithëshme për rolin e misionin CIMIC në çdo Forcë Ushtarake. Nëpërmjet ngjarjeve e dëshmime historike u përcoll evolimi i mendimit ushtarak dhe domosdoshmëria e krijimit të këtyra strukturave specifike në ushtritë e ndryshme të botës. Më parë koncepti për BCU shihet si fenomen logjistik, nënvizoi zonja Lahi. Mbas Luftës së II-të Botërore, organizatat ndërkombëtare OKB, NATO, BE, etj. konceptin mbi bashkëpunimin civilo-ushtarak e bënë pjesë të Strategjisë të Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë Ushtarake.

Kështu Doktrina e NATO-s për marrëdhëniet Civilo-Ushtarake në fillimet e saj theksonte se, përveç vazhdimit të mbrojtjes kolektive, Aleanca duhet të qëndrojë gati për të kontribuar në parandalimin efektiv

të konflikteve dhe për tu angazhuar në mënyrë aktive në menaxhimin e krizave, duke përfshirë operacionet e reagimit ndaj krizës. Ndërveprimi midis forcave të Aleancës dhe mjedisit civil është vendimtar për suksesin e operacioneve. Në këtë kuadër CIMIC mbështet komandat në arritjet e misionit dhe ka përgjegjësi komanduese.

Në vijim N/Kolonele Lahi, shpjegoi bazat e BCU, që mbështeten nëparimet e SSK, SU DPU dhe manualin e BCU. Sipas këtyre dokumentave BCU, shihet si instrumenti kryesor për bashkëpunimin e koordinimin me strukturat brenda FA dhe strukturave civile. Në këtë kuptim BCU në FARSH, është kordinimi dhe bashkëpunimi në mbështetje të misionit midis komandantëve dhe aktorëve civilë, duke përfshirë autoritetet kombëtare dhe lokale si dhe organizatat dhe agjencitë kombëtare dhe joqeveritare.

Gjithashtu në këtë temë u theksuan funksionet kryesore të BCU, si

mbështetja për mjedisin civil dhe për Forcën, ndërsa kordinimi dhe b/p në mbështetje të misionit realizohet nga FA në terren dhe në bashkëpunim me organizata të ndryshme. U trajtuan dhe çështje të tjera si qëllimi i BCU në nivel strategjik, në nivel operacional dhe taktik. Ndërkohë planëzimi i CIMIC duhet ti përmbahet misionit të përgjithshëm, të mbështesë mardhëniet me partnerët, të sigurohet a janë justifikuar aktivitetet ushtarake. Planëzimi përfshin 5 faza, inicimi, orientimi, koncepti i zhvillimit, plani i zhvillimit, rishikimi i planeve. Idea e CIMIC ka të bëjë me menaxhimin e krizave, stabilizimin, para operacionit, gjatë operacionit, pas operacionit, si psh. për pritjen e refugjatëve, etj. Nëpërmjet këtij leksioni auditori krijoi një mendim të përgjithshëm për misionin e CIMIC në NATO dhe në Forcat tona të Armatosura.

Në vijim të seminarit, znj. Alketa Pocari, trajtoi çështjen se si funksionon media në FA dhe disa mjete apo teknika që përdoren në komunikimin me median europiane dhe amerikane. Bazuar dhe në eksperiencën e saj, ajo për rëndësinë e lajmit, elementët e lajmit, teknika që përdorë media, pyetjet e reporterit, mesazhi që duhet të përcjellë, etj. Në lidhje me këtë çështje u theksua dhe angazhimi i mëtejshëm në median ushtarake të specialistëve dhe strukturave të BCU në Forcë dhe reparte. "Tashmë ne kemi në çdo strukturë specialistë të medias, të cilët duhet të pasqyrojnë qartë, saktë e brenda rregullave të sigurisë aktivitetin e repartit të tyre dhe FA në përgjithësi", tha ajo. Në lidhje me këtë çështje u shkëmbyen dhe mendime e eksperiencia nga pjesëmarrësit se, si ata kanë pasqyruar aktivitetin në repartin e tyre, nevojën e përshtimit të vështirësive të jetës ushtarake, faktin që çdo lajm duhet të fillojë nga ushtari, marinari, piloti, zbatimi i kuadrit ligjor dhe parapregatitja për çdo situatë mediaktike. U ngrit dhe një shqetësim për bazën materiale të medias në FA, konkretisht blerjen e aparateve fotografike të reja, pasi mjaft operatorë po punojnë me aparate të vjetra apo të blera vetë. Ndërkohëmajor Erion Shkëmbi, specialist në drejtorinë e J-9, shpjegoi objektivat e kapacitetit L3110, hapat dhe etapat e zhvillimit të OK L3110 CIMIC. 2006, 2008, 2010. Majori prezantoi historikun e zhvillimit të kapaciteteve të CIMIC dhe përgatitjen e një grupi operacional të CIMIC, të gatshëm për operacionet në kuadër të aleancës. Në vitin 2014, u implementua struktura e detashmentit CIMIC në Qendrën stërvitore të KM, theksoi major Shkëmbi. Në mars 2017, u

zhvillua takimi i parë kordinues me ekspertët e ardhur nga Ministritë e linjës. Është në proces krijimi i një database me specialistë ushtarakë aktivë ose rezervë për krijimin e Ekipit tëspecialistëve funksionalë të CIMIC-ut. Majori shpjegoi dokumentat që mbështesin implementimin e OK L3110. Objektivi final është që në fund të vitit 2018, të kemi një kapacitet CIMIC dhe një ekip specialistësh funksionalë të certifikuar në grup batalioni. Në fund të leksionit zoti Shkëmbi shpjegoi struktura e detashmentit CIMIC në nivel taktik, kërkesat dhe aftësitë që duhet të kenë specialistët funksionalë të CIMIC dhe kontaktet në nivel kombëtar. Po ditën e parë të seminarit, N/Kolonele Alda Sulaj, shpjegoi probleme të diversitetit kulturor gjatë zbatimit të misionit, koncepti i kulturës, si ai personal dhe i përgjithshëm, etj. "Gjatë punës si specialist CIMIC-u duhet të njohësh kulturën tënde, të ashtuquajturin, ajbsbergu kulturor, njohjen e kulturës së vendit pritës, ndërtimin e mardhënieve dhe ndryshimin e kulturave" m tha ajo.

Në ditën e dytë të seminarit, N/ Kolonel{R}, Arben Molla, foli gjerësisht për mbështetjen ushtarake ndaj Autoriteteve civile. Zoti Molla nënvizoi se, kontributi i FA në emergjencat civile është shumë i pasur, për këtë solli dhjetra shembuj. Gjithashtu në këtë referim u trajtuan çështje të edukimit, trajnimit, stërvitjes, çështje të sigurisë, roli i FA në përgjigje të fatkeqësive apo katastrofave natyrore, rolet dhe përgjegjësitë e BCU, autoritetet dhe strukturat, komandim kontrolli në rastet EC, kordinimi dhe mbështetja, operacionet e kryera në situatë emergjente, trajnimi dhe edukimi, etj. "Në këtë kuadër ka rëndësi rritja e kapaciteteve kombëtare për përballimin e situatave të ndryshme duke bashkëpunuar dhe me partnerët tanë si SHBA, etj".

Ndërkohë major Olti Agolli nëpërmjet leksioneve të tij evidentoi mjaft probleme të rëndësishme të punës sëCIMIC, duke e gërshtuar atë me eksperiencën e këtyre strukturave në NATO. Sipas tij, roli i CIMIC në NATO, ka të bëjë me "kordinimin dhe bashkëpunimin në mbështetje të misionit, ndërmjet strukturave ushtarake të NATO-s dhe aktorëve civilë, duke përfshirë popullatën kombëtare dhe autoritetet lokale, si dhe organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare, kombëtare dhe joqeveritare". Gjithashtu majori foli për nivelet e CIMIC në NATO, organizimin eshtabit të CIMIC, shtrirjen e CIMIC në LANDCOM. Ndërkohë në mënyrë krejt origjinale, zoti Agolli shpjegoi mënyrën e bashkëpunimit të një

specialisti të CIMIC me Shoqatat e tjera bashkëpunuese në terren. Në një temë tjetër major Agolli shpjegoi planëzimin e CIMIC, planëzimin operacional, nivelet e planëzimit në NATO, etj. Zoti Agolli foli për rëndësinë e planëzimit të një operacioni civil-ushtarak në nivelin strategjik, operativ e taktik, ku trajtoi hollësisht planëzimin me detaje të një operacioni CIMIC në nivelin taktik, pjesë e detyrave të përditëshme që kryen dhe detashmenti. "Një plan i studjuar mirë në përmbajtje, aktorët pjesëmarrës, nevojat, afati kohor, synimi kryesor, që parashikon mënyrat dhe mjetet e bashkërendimit jep garanci për sukses", nënvizoi major Agolli.

Në fund të këtij seminarit, zoti Fatos Xhengo, kordinator i programit për katastrofa dhe ndihmën e parë, tek Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH), prezantoi rolin dhe detyrat e KKSH për menaxhimin e katastrofave dhe krizave, fushat ku vepron, përgatitjen dhe ndërhyrjen në raste fatkeqësish, etj. Ai foli për Strategjinë e KKSH si pjesë e lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe për Rezolutën e Sydney-Australi, 17-18 nëntor 2013.

Duhet të theksojmë se përgatitja e lektorëve, niveli i temave dhe çështjeve të caktuara, pyetje-përgjigjet, fryma e debatit, shembujt dhe eksperiencia teoriko-pedagogjike, ishin tregues i seriozitetit të këtij seminarit. Në një farë kuptimi atë që kërkojnë partnerët tanë, që shqiptarët të trajnojnë shqiptarët, drejtorja e BCU e realizoi në këtë seminar. Në fund të seminarit, nisur nga problematika e çështjeve të trajtuara, Drejtori i ri i J-9 në Shtabin e Përgjithshëm, Kolonel Zaho Golemi theksoi se "veprimtaria e sektorit BCU ka rëndësi jetike për misionin e Forcave tona të Armatosura në situatat e sotme dhe duhet marrë në konsideratë nga çdo drejtues apo sektor në FA dhe institucionet civile. Është e nevojshme që specialistët dhe strukturat e BCU të ndjekin rritimin e zhvillimeve në Forcave tona të Armatosura dhe ta pasqyrojnë atë gjerësisht në media. Po që ta bësh këtë dhe të plotësosh aneksin W tek OPLAN, duhet të vraposh mbas ushtarit në tokë, mbas marinarit në det e pilotit nëhelikopter. Ndërsa ne do ndjekim në çdo hap modelin e standardet e NATO-s për CIMIC, ku është nevojshëm përmirësimi i Doktrinës dhe Manualeve të CIMIC". Kolonel Golemi u uroi pjesëmarrësve suksese në detyrat e përditëshme, gjithashtu falenderoi Komandën e Mbështetjes Logjistike për kushtet e krijuara në zhvillimin normal të këtij seminarit. Në fund pjesëmarrësve të seminarit ju dhanë certifikata.

# KONFERENCË SHKENCORE

“60 VJET AKADEMI E FORCAVE TË ARMATOSURA” 10 MAJ 1958-10 MAJ 2018

## Cilësia akademike kusht i vazhdueshëm për arsimimin ushtarak

KOLONEL PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Drejtor i Drejtorisë së BCU-së në Shtabin e Përgjithshëm  
ROVENA ALIRAJ, Doktorantë në proces në AFA  
ERGYS LLANAJ, Doktorantë në proces në AFA

**A**rsimimi ushtarak ka historinë e vet të krijimit, zhvillimit dhe konsolidimit. Por për të qenë konkretë e të saktë me të dhënat që ofron dokumentacioni jemi referuar në shifra.

Akademia jonë 60 vjeçare, me 8200 studentë në auditoret e saj, 4000 studentë në një çerekshkulli në akademitë simotra të vendeve të NATO-s, 480 pedagogë, 18% profesorë të huaj në KLSM, 230 vetë staf mbështetës. Në Akademi kanë studiuar më shumë se 100 gjeneralë (ose në funksione të barasvlefshme me to), 700 komandantë e komisarë në rangje gjeneralësh në 6 dekadat e fundit; me staf ekselence në hartimin e metodikave dhe drejtimin e stërvitjeve të mëdha operative-strategjike, të organizuara e zhvilluara në hapësirën shqiptare me pjesëmarrje 100 mijë deri 120 mijë trupave. Akademia mbushte radhët

e drejtimit ushtarak në rangje operative dhe strategjike për komandimin dikur të 61000 forcave aktive ushtarake e 260.000 forcave rezerviste, që drejtonin me kompetencë njësi të mëdha ushtarake operativ-strategjike deri në 29 divizione në 3 fronte luftarake. Ishte një epokë e me qark të mbyllur e akademizmit ushtarak me problemet e veta. Cilësia akademike fitoi hapësirën e nevojshme pas viteve 90-të, që shënon një transformim dhe kapërcim epokash. Një pjesë fare e ngushtë e stafit pedagogjik, por edhe e studentëve nuk e “gjenin dot rrugën” dhe shkuan në drejtime të tjera të ekonomisë brenda dhe jashtë vendit, por shumica gjeti orientimin dhe vijoi përpjekjet sipas orientimit euroatlantik, që i dha Akademisë jo vetëm emërtim të ri por edhe dimension programor, programe të rinj, cilësi të re akademike. Ushtarakët shqiptarë që studiuar në akademitë më prestigjioze të botës sidomos në SHBA, Gjermani, Itali, Britani, Francë, Turqi etj sollën një frymë të re e një progres të dukshëm të Ushtrive të NATO-s dhe vendeve partnere. Ka më shumë se një çerek shekulli që Akademia flet me gjuhën euroatlantike të Perëndimit, me gjuhën që familjes i përket natyralisht. Vizioni i saj është i qartë dhe këtë e vërtetoi edhe kontrolli i cilësisë i kompanisë angleze për akreditim të AFA-së përgjatë vitit 2016 -2017 e që u konkretizua



me akreditimin e merituar në 20 tetorin e vitit 2017. Fokusi historik dhe bëmat e të parëve nuk janë kurrë të mjaftueshme. Maksima e mençur e shqiptarëve se “pa të shkuar nuk ka të ardhme”, shërben vetëm si një çelës lidhës midis epokave të arsimimit, si një çelës që lidh përvojat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Por kjo nuk mjafton dhe në këtë proces nuk ka e nuk mund të ketë një çelës magjik të zgjidhjes së lehtë të problemeve të arsimimit. Cilësia në dije ka qenë dhe është sasi. Cilësia është vetë drita e diturisë të së ardhmes. Në një kohë të bumit teknologjik, të shtimit me ritme shumë të shpejta të informacionit edhe Akademia e Forcave të Armatosura prej disa kohësh ka hedhur vështrimin tek e ardhmja ristrukturuese mbi bazën e legjislacionit të ri mbi arsimimin dhe kërkimin shkencor. Jemi të bindur se frytet e punës nuk do të vonojnë kursesi procesin e arsimimit më të mirë, e trainimit më kualitativ, e vlefshmërisë dhe dinjitetit të diplomave dhe certifikatave që lëshon institucioni më i lartë arsimor ushtarak i vendit. Referenca e parë në themelet e arsimimit ushtarak e civil nuk ka si mos të vendoset thënia profestike e Sami Frashërit, se “Mendja e një kombi është arsimiti”. Për arsimimin ushtarak, për të gjitha nivelet e Arsimimit cilësia është në rendin e parë, të prioritetëve. Kjo është e përligjur sepse si të jetë arsimimi sot është cilësia e oficerit dhe nënoficerit nesër. Prandaj nuk ka se të mos risjellim në vëmendjen e konferencës përsëri atë që thotë i madhi Shemsedin Sami: “Nëse do të mbjellësh për një vit mbjell misër e grurë, por nëse do të mbjellësh përgjithmonë mbill arsim e kulturë”.

### **Arsimimi ushtarak dhe cilësia e tij në fokus historik**

Në shqiptarët edhe pse kemi një shtet 106 vjeçar, në arsimimin ushtarak kemi një histori që vlen të studiohet në të gjitha ciklet e studimit akademik. Arsimimi ushtarak, udhëtoi bashkë me shtetin. Në fakt në historinë e shqiptarëve ka pasur një përvojë shkollë ushtarake. Në vitet 1796-1822, kur në shtetpashallëkun shqiptar të Janinës, në Bonilë u krijua shkolla e parë ushtarake e artilerisë, xhenios, kalorësisë e këmbësorisë me instruktorë francezë, anglezë, italianë e shqiptarë, shkollë që funksionoi për më shumë se një çerek shekulli. Ndërsa shumica e oficerëve dhe e nënoficerëve shqiptarë të periudhës deri më 1912, kur u shpall Pavarësia, kishin studiuar në shkollat osmane të perandorisë, që ishin hapur që më 1834. 70 oficerat e parë dhe 155 nënoficerat e parë ishin jo vetëm ushtarakë të njohur dhe atdhetarë, si Mehmet Pashë Dëralla, ministër i parë i Luftës, Ali Shefqeti –Shkupi, e të tjerë, që justifikuan postet e rëndësishme në qeverinë e parë të përkohshme të Ismail Qemal Vlorës. Që me Pavarësinë u mendua për kurset e trainimit; ndërkohë që shkollat e përgatitjes së oficerëve ngelën në planet e shtatmadhorëve të parë shqiptarë. Periudha prej vitit 1914, kur erdhi në fuqi Princ Vidi (7 mars deri më 3 shtator 1914), e deri në 1919-tën, pati disa ngjarje ushtarake nga komandat e forcave ushtarake austro-hungareze, italiane e franceze që u instaluan në Shqipëri në kuadrin e LIB. Vetëm madhorët austro-hungarezë në Shqipëri përzgjedhën rreth dyzet djem shqiptarë për t'i dërguar në shkollat e Akademisë ushtarake të Austrisë. Ky ishte kontigjent që erdhi në Shqipëri pas LIB. Në Shkodër më 1917,

filloi kursi i përgatitjes së aspirantëve nën drejtimin e instruktorëve austriakë. Më 1919, ende pa u bërë Tirana kryeqendër e Shqipërisë Qeveria e Përkohshme e Durrësit, për drejtimin e xhandarmërisë hapi në Tiranë një shkollë 6-mujore që të përgatiste oficerë, aspirantë dhe xhandarë. Por qarqet atdhetare këtë tip shkollë italo-shqiptare me kritere të dyshimta të përzgjedhjes, me betimin para italianëve, me veshje të xhandarmërisë shqiptare me uniformë italiane, me praninë në drejtim edhe të një oficeri italian. Ky tip arsimimi u hodh poshtë sepse nuk kishte pavarësi dhe nuk ofronte asnjë vlerë kombëtare. Kuvendi i shpëtimit kombëtar, në Lushnjë në janar 1920, ishte në fakt platform e pavarësisë së dytë të Shqipërisë duke hedhur bazat e konsolidimit të shtetit të vërtetë ligjor shqiptar. Platforma e mbrojtjes së Shqipërisë nga agresioni i huaj, ruajtja e rendit e të qetësisë e çoi Parlamentin Shqiptar tek mendimi për një ushtrie kombëtare për mbrojtjen e nderit të kombit. Në vitet 1921-1925, arsimimi ushtarak ju drejtua kryesisht shtetit të Ismail Qemal Atatürkut në Turqi, në Itali e gjatë për të përgatitur oficerë. Megjithatë strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes së shtetit shqiptar në këtë periudhë nuk patën qëndrueshmëri, duke bërë që qeveritë të binin dhe ngriheshin edhe brenda ditës dhe ngjarjet politike të viteve 1924-1925 e më pas, u pasqyruan edhe në fushën e organizimit të Forcave të Armatosura, ku përfshiheshin ushtria, xhandarmëria dhe policia. Shkolla që prisnin shqiptarët edhe në fushën ushtarake nuk ishte në prioritetet e politikës së kohës. Dy pakte të Republikës së Shqipërisë (kuqtojmë këtu se republika u shpall më 1925), pakti italo-shqiptar i “miqësisë e sigurimit”, i jepte Italisë të drejtë të ndërhynte në Shqipëri në rast se çenohej “statusquo-ja politike e juridike dhe tokësore e Shqipërisë”, i nënshkruar më 27 nëntor 1926 dhe pas një viti më 22 nëntor 1927 u nënshkrua Pakti i Dytë i Tiranës, ose “Aleanca Mbrojtëse e Pandryshueshme”, ku Italia vendosi kontrollin ushtarak mbi Shqipërinë. Paktet dhe marrëveshjet sollën misionet ushtarake me rreth 280 oficerë italianë pranë Komandës së Fuqive Armate ose të Ushtrisë Shqiptare. Që tek presidenti dhe në çdo strukturë të ushtrisë kishte këshilltar të çështjeve ushtarake, këshillat e të cilëve ishin jetike për ushtrinë. Ushtria shqiptare kishte në drejtim edhe një oficer madhor austriak Gustav Myrdach, i cili i mëshonte anës stërvitore si dhe zhvillimit të arsimit ushtarak. Organizimi dhe ringritja e ushtrisë u bë sipas konceptit për zëvendësimin me ushtri të rregullt të sistemit të mëparshëm me malice, concept i “vjetër” i vitit 1920. Shkollimi i oficerëve të rinj ngeli gjithmonë një objeksion i rëndësishëm me kritere rigorozë të moshës dhe arsimimit si dhe përkushtimit. Kurset e aspirantëve me disa dhjetra kursantë nuk i plotësonin nevojat e ushtrisë shqiptare. Kurset vijuan edhe në Shkodër për përgatitjen e nënoficerëve të ushtrisë dhe të xhandarmërisë. Kapacitetet dhe kohëzgjatja deri në një vit për aspirantët rriti cilësinë dhe intesitetin e stërvitjes por nuk mundi të përmbushte nevojat për këmbësorë, artiljerë, xhandarë etj. Programet e përgatitjes me lëndë si: Taktikë Fushore, Fortifikatë, Gjeografi ushtarake, Rregullore e Brendshme dhe e Trupave, Histori, Topografi, Logjikë Nënshkrimore, Organikë e të tjera, ishte një domosdoshmëri për formimin ushtarak. Në këtë kohë oficerët e lartë përgatiteshin në Itali, Austri, Francë, Greqi, për



këmbësori, artileri, xhenio, detari...etj. Më 1 nëntor 1928, u përrua Shkolla Mbretërore Ushtarake; ndërsa më 15 tetor 1928 u themelua Shkolla e Artilerisë. Në fakt shkollat ishin kurse një vjeçarë, por pavarësisht kufizimeve të kohës kontribuoi në plotësimin e ushtrisë shqiptare me oficerë e nënoficerë. Në vitin 1930 oficerët zinin rreth 4% të të gjithë efektivit të ushtrisë shqiptare; ndërsa më vonë kjo shifër ishte e ndryshueshme si paasojë e rritjes së numrit të reparteve. Shkolla Mbretërore Ushtarake megjithë efektivitetin e që vijoi rregullisht mësimin për 5 vjet, nga viti 1928 deri në vitin 1933, dhe pas 5 vjetësh u mbyll për arsye financiare. Një tjetër shkollë që kreu aktivitetin e saj ishte: "Shkolla e Nxënësve Oficerë të Plotësimit", që shqiptarët e quanin thjesht: "Shkolla e Plotësimit" në Tiranë, që merrte maturan të shkollave të mesme, por dhe student të diplomuar. Krahas shkollave shqiptare pas viteve '30-të rëndësi ju kushtua dërgimit të nxënësve e studentëve në kolegjet ushtarake italiane si në Kolegjin Ushtarak në Romë, Kolegjin Ushtarak në Napoli, Akademinë e Këmbërorisë e të Kalorësisë në Modena, Akademinë e Artilerisë e të Xhenios në Torino, Akademinë e Detarisë në Livorno, etj. në vitin 1932, doli "Rregullorja për dërgimin e oficerëve përjashta". Në përbërje të Fuqive të Armatosura Ushtarake të Shqipërisë ishte dhe Xhandarmëria. Për kushtet e Shqipërisë, duke iu referuar edhe historisë së Forcave të Armatosura të saj dhe sidomos të misionit të tyre, xhandarmëria, krahas detyrave për sigurimin publik, me përparësi kishte kryer detyra luftarake për ruajtjen e kufijve. Standardet e përgatitjes së xhandarmërisë erdhën gjithnjë duke u përmirësuar, ndërsa kanë funksionuar edhe shkolla të xhandarmërisë në Durrës, Tiranë, Vlorë, Burrel, që ishin një përvojë për kohën. Në pikëpajë kohore, matësi kohor shënon më 10 maj, 60 vjetorin e krijimit të institucionit dhe po t'i bëjmë një retrospektivë kohore duhet që vështrimi ynë të jetë nën fokusin kohor të dy epokave.

### **Periudha e "Shkollës së Naltë Ushtarake", e cila "shkroi" epokë**

Dita e 10 Majit të vitit 1958 ka hyrë në historinë e arsimit tonë ushtarak si dita e krijimit të të parit Institucion të Lartë Arsimit të Forcave tona të Armatosura. U takon themeluesve të kësaj Akademie fati dhe

nderi i merituar për t'u kujtuar e respektuar në çaste të tilla jubilarë dhe historike. Emrat e pionierëve të parë të këtij institucioni të nderuar arsimor, të gjeneralëve Thoma Xhixho, Vehbi Hoxha, Vaskë Gjino, Ernest Jakova, Spiro Shalësi, Ziqiri Mero, Spiro Adhami, të kolonelëve Koli Mborja, Mendu Tetova, Xhemal Punavia, Vangjel Lulo, Dilaver Radëshi, etj, obligojnë brezat e rinj, që duke shprehur mirënjohjen për veprimtarinë e tyre, përkujtojmë e nderojmë me respekt të gjithë komandantët, Shifat e katedrave, Departamentëve, Fakulteteve, pedagogët, punonjësit shkencorë, personelin ndihmues civil, që, me angazhimin dhe përkushtimin e tyre i dhanë jetë e gjallëri këtij Institucioni të respektuar Arsimit të ushtrisë dhe të mbarë shoqërisë shqiptare. Ideja për krijimin e një Akademie Ushtarake në dokumentet tona shkollorë ndeshet në vitet '30-të, edhe pse vetë Shkolla mbretërore shqiptare pati jetë vetëm 5 vjet (1928-1933), por që u bë realitet vetëm në majin e vitit 1958, vendim i udhëheqjes politike të kohës, që urdhëronte fillimin e punës për ngritjen e një "Shkolle të Naltë ushtarake", si kulmi i arsimit ushtarak shqiptar.

Përpjekjet e stafeve drejtues dhe arsimdashëse të ushtrisë për një shkollë të tillë ishte në fakt kurorëzimi i një rrugë të nisur që më parë dhe që do të pasonte në të pastajmen e vitit 1960, në "shkeljen në shtigje të pashkelura".

Ishin krijuar të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e mendimit ushtarak të përparuar e cilësor. Por mendimi i përparuar ushtarak nuk lind dhe as zhvillohet vetiu. Ai kërkon njerëz kompetentë, të aftë dhe largpamës në ecurinë perspektive të arsimit ushtarak, duke u shoqëruar me kurrikula mësimore e shkencore në funksion të organizimit dhe ndryshimit të strukturave organike të FA. Kanë qënë pikërisht evoluimi i strukturës së FA dhe i përsosjes së sistemit arsimor ushtarak akademik, ato që kanë diktuar rishikimin e domosdoshëm të strukturës kurrikulare për të zgjidhur gjithë kërkesat që ka shtruar koha, si dhe për të afruar kurrikulat mësimore në vite me shkollat ushtarake të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Brenda strukturës së propozuar ka lindur nevoja për një integrim vertikal të koncepteve, ku inicimi i praktikës së lëndëve dhe fushave me zgjedhje dhe zgjidhje bashkëkohore ka kërkuar e kërkon planifikim të kujdesshëm, për të garantuar zhvillimin gradual e cilësor të kualifikimit dhe artikullimit

në kurikulat pasuniversitare.

Hartimi dhe "përgatitja e kurrikulave mësimore" është për specialistët e mësimdhënies dhe të planizimit e kurrikulave, një aspekt i rëndësishëm i objektivave mësimore.

Në kuptimin bazal kurrikula mësimore përbëhet nga tri elementë; objektivat, mësimdhënia dhe vlerësimi apo kontrolli i dijeve. Elementët e objektivave, mësimdhënies dhe vlerësimit kërkojnë kombinim, që çojnë në mësimdhënie e vlerësim që synojnë realizimin cilësor të objektivave. Këto çojnë në një rezultante të pranueshme që është një kurrikull mësimore të gjithëpranuar. Megjithëse dihet se kjo gjë duhet të ndodhë në të gjitha kurrikullat mësimore, është e vështirë të arrihet sepse, nga njera anë pedagogët përdorin metoda të ndryshme të mësuarit, të mbështetur në intelektin, aftësitë dhe interesat e tyre, dhe, nga ana tjetër kursantët, me prirje të ndryshme të mësuarit, kanë përvetësuar jo vetëm shprehje të ndryshme, por edhe në nivele të ndryshme. Pra, pedagogët kanë materiale të ndryshme për të përdorur në orën e mësimit, dhe nga ana tjetër, objektivat mësimore u japin çelësin për të përgatitur kurrikullën mësimore. Për këtë arsye objektivat mësimore janë thelbësorë për hartimin e kurrikulave në nivelin e kërkuar akademik.

Bazë për hartimin e një kurrikulle të suksesëshme është analiza e kujdesëshme e shprehive, koncepteve dhe parametrave të tjerë të objektivave që do të arrihen në orën e mësimit. Objektivat mësimore përcaktojnë qëllimet dhe piksynimet jo vetëm të pedagogut por edhe të kursantëve që duhet të arrihen në fund të kursit. Pa patur objektiva mësimore të qartë, mësimdhënies i mungon ajo që ndryshe mund të quhet "çelësi i artë i zgjedhjes". Me objektiva të përcaktuar me kujdes, zgjedhja e teknikave të mësimdhënies bëhet më e lehtë dhe më e drejtëpërdrejtë. Në të vërtetë zgjedhja e teknikave të mësimdhënies rrjedh nga lloji i objektivave mësimore të përzgjedhur. Përfundimisht mund të themi se objektivat mësimore kontrollojnë shumë saktë vlerësimin dhe përparimin e kursantëve.

Ecuria e hartimit dhe modernizimit të kurrikulave mësimore në AFA kanë qenë në përputhje me ndryshimet strukturore të Forcave të Armatosura, ndryshime që kanë ardhur çdo vit dhe duke shtuar përvojë nga vetja dhe nga miqtë euroatlantikë pas ndryshimeve demokratike në Shqipëri.

Nga të dhënat e shumta arkivore gjejmë një përgatitje intensive disa muajore, duke bërë një gërshetim të drejtë të përvojës ekzistuese të ushtrisë sonë të dalë nga lufta, me përvojën e marrë nga akademitë dhe shkollat ushtarake të vendeve të Lindjes, kryesisht atyre Sovjetike, e sidomos në ish Akademinë ruse "Frunxe". Vetëm shtatë muaj pas krijimit të shkollës së naltë ushtarake, më 3 Janar 1959 filloi kursi i parë mësimor me afat kohor 3 vjeçar me katër grupe mësimore, dy gjithëarmësh një AT dhe një AKA. Ky kurs u drejtua nga një grup i zgjedhur e pasionant ushtarakësh mësimdhënës, që u emërtuan fillimisht "instrukturë" si një trupë elitare mësimdhënëse. Urdhëri i Korrikut 1959 bëri bashkë nën një "kulm" në SHNU fillimisht 15 oficerë, më të mirët për atë kohë, të cilët natyrshëm u përballën me vështirësi jo të vogla. Në muajt gusht, shtator e tetor organika e SHNU filloi të plotësohej.

Me qëllim që të udhëhiqeshin dhe shoqëruar ecurinë normale të kurseve të krijuara në akademi, sektorit apo degës së planizimit i dërgohet detyra të mëdha e të përgjegjshme për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave mësimore në vite, çka bëri që të hidheshin hapa solidë dhe krejtësisht të menduar. Hartimi dhe përgatitja e kurrikulave mësimore, për t'ju përgjigjur me sa më efektivitet kurseve të hapura në akademi, ka kaluar nga njera periudhë në tjetrën duke shënuar stadi të larta zhvillimi.

Cilësia akademike është trashëguar nga njera periudhë në tjetrën, nga një emërtim "Shkollë", në një emërtim "Akademie". Edhe kur ndryshonte emërtimi institucioni ishte po ai me të njëjtën mision e mënyrë funksionimi. Emërtimet e Institucionit të Arsimit të Lartë ushtarak që nga viti i krijimit të Shkollës së Naltë Ushtarake më 1958 e deri më sot ka ndërruar nëntë herë emërtimin, por jo funksionin dhe misionin e saj të përgatitjes së oficerave për nivele të larta të drejtimit e të komandimit operativ dhe strategjik të vendit. Kështu në gjashtë dekada nëntë emërtimet e IAL ushtarak kanë qenë sikurse është detajuar: Shkolla e Naltë Ushtarake, RU. 2002, nga 10.5.1958 deri më 28 tetor 1961. Akademia Ushtarake e RPSH, RU. 2002, nga 28.10.1961, deri më 5.1.1963. Akademia Ushtarake "Mehmet Shehu", RU. 2002, nga 5.1.1963 deri 18.12.1981. Akademia Ushtarake e RPSSH, RU. 2002, nga 18.12.1981, deri më 24.12.1991. Akademia Ushtarake, RU. 2002, nga 24.12.1991 deri më 24.12.1992. Akademia e Shtabit të Përgjithshëm, RU. 2002, nga 24.12.1992 deri më 7.2.1994. Akademia e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, RU.2002 nga 7.2.1994 deri 10.4.2004. Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", RU.5561, nga 10.04.2004 deri më 1.10.2012. Akademia e Forcave të Armatosura, RU. 5008, nga data 1.10.2012, (e në vazhdim) morri emrin Akademia e Forcave të Armatosura dhe përbëhet nga 2 Fakultete Fakulteti i Arsimit të Përgjithshëm, (ish-Akademia Ushtarake "Skënderbej") dhe Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes, (ish-Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu"). "Akademia e Forcave të Armatosura", që është emërtimi aktual i Akademisë, RU. 5008, vijoi të mbajë këtë emërtim edhe në rristurimet e bëra në vitin 2014 dhe në 2016.

Në periudhën 10 Maj 1958-15 Shtator 1961 ku shkolla e lartë e vitit 1958 emërtohet "Akademia Ushtarake". Për atë kohë ky stad përbënte një hap të rëndësishëm që çonte në rrugën e ndryshimeve cilësore të jetës e të veprimitarisë mësimore të këtij institucioni Këto ndryshime u pasqyruan në planet dhe programet e kurrikulave mësimore, si dhe në kërkesat në rritje për vetë "dëgjuesit" dhe trupën pedagogjike në rritjen e formave e të metodave mësimdhënëse, të zbatimit të kriterëve të përparuar të atyre viteve, të pranimit të dëgjuesve që vinin për studime etj. Është fakt i pa mohueshëm që kontigjenti i oficerëve që vinin në Akademi në atë periudhë ishte në tërësi ajo e dalë nga lufta, e arsimuar në vendet e lindjes, kryesisht në Jugosllavi e BS në kurse të shkurtra kualifikimi, dhe me mungesa të theksuara të kulturës së përgjithëshme. Pikërisht për këtë arsye, Komanda dhe sektori i planizimit të Akademisë ishin të detyruar që kurrikulat mësimore ti ndërtonin në mënyrë të tillë që rreth një vit të plotësoheshin mangësitë që kuadrot kishin për arsye

objektive në formimin e përgjithshëm dhe, dy vjet me tema speciale ushtarake duke ju përgjigjur sa më mirë strukturës së organizimit të FA të cilat përbëheshin nga forcat e Ushtrisë që zinin 68.5 % dhe forcat e MPB që zinin 31.5 % të efektivitetit. Forcat e Ushtrisë kishin në përbërje të saj 3 Komanda: Komanda e Mbrojtjes Bregdetare (MBD), e Mbrojtjes Kundrajrore (MKA), e Flotës Luftarake Detare (FLD), si dhe Brigadat e Këmbësorisë (BrK), Rregjimenti i Këmbësorisë së Mekanizuar (RKMek), Rregjimenti i Artilerisë Malore (RAM), Rregjimenti i Xhenios (RXh), Rregjimenti i Ndërlidhjes (RNd) dhe Batalioni i Tankeve (bt.). Pikërisht edhe përmbajtja e kurrikulave mësimore ishte programuar e tillë që t'i përgjigjej llojeve të ndryshme të luftimit në rang batalioni, regjimenti e brigade. Vlen të theksohet se në këtë fazë formacioni më i lartë në këmbësori ishte brigada, së cilës në kohë luftime shtoheshin në organikë edhe 1 bam (batalion art-mitralier), ndërsa batalionet autonome të këmbësorisë rriteshin me përfundime në rang brigade, që e bënte më se eficientë në realizimin e misionit.

Kjo është edhe periudha në të cilën është realizuar modeli i parë i kurrikulave mësimore. Aktualisht në mjediset akademike kurrikulat mësimore sipas përvojës së vendeve perëndimore ndahen në tre modele. Prioriteti është njohja dhe zhvillimin e koncepteve, teorive, ligjeve apo parimeve kryesore, të cilat kursanti i studjon e përvetëson, dhe mandej, në bazë të tyre, shpjegon fakte e dukuri të veçanta, dhe kryen aplikime të ndryshme. Ky tip organizimi vlerëson mjaft strukturën logjike të disiplinës shkencore, që ka marrë përparësi në ditët tona.

Pas përfundimit të periudhës së parë rifillon një periudhë tjetër, që përfshin periudhën 16 shtator 1961-12 janar 1966 ku me vendimin Nr. 381, datë 28.10.1961 të Këshillit të Ministrave, Akademia Ushtarake kaloi në sistem të ri dy vjeçar, që duke u mbështetur në kohë të reja dhe në realitete të reja, i jepej më tepër rëndësi përgatitjes profesionale sipas armëve e shërbimeve. Përgatitja dhe realizimi i kurrikulave mësimore në këtë fazë shënonte një rritje cilësore, në të cilën Akademia ndërmerre dhe zgjidhte tema jo vetëm të nivelit taktikë, por edhe të niveleve më të larta të shkallës operative-strategjike.

Kjo periudhë përkon me riorganizimin e FA, ngritjen e presidiumeve të ngushta me karakter të theksuar ideologjik në qarqe e rrethe, ku problemi i mbrojtjes shtruhej si çështje e pushtetit civil në rrethe, duke u parë nga këndvështrimi i "shkeljes në rrugë të pashkelura", ose dhe si "zbatim me krijimtari i parimeve të Artit Ushtarak Popullor", në kushtet e "rrethimit" si dhe slogane të shumta që e kanë veshur dhe e kanë tretur pjesën kockore të mbrojtjes së vendit si mision kushtetues. Bashkë me "injektimin" e mbrojtjes kushtetuese nuk ka si të mos depërtonte edhe pjesa politike dhe ideologjike që e lodhte dhe stërmundonte bile e bënte edhe më komplekse problemin e mbrojtjes në Shqipëri. Fakt ishte që FA përbëheshin nga Ushtria Popullore, Shtabet e Mbrojtjes së rretheve dhe Forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ushtria Popullore në këtë periudhë u organizua me sisteme Korpusi Këmbësorie dhe Korpus të Mbrojtjes Bregdetare, me Komandë të Njërive Rezervë që kishin në përbërje njësi autonome të llojeve të armëve dhe shërbimeve për dhënie në përfundim ose mbështetje njësi

të shkallëve operative dhe strategjike. Edhe në këtë fazë është realizuar në përgjithësi modeli i parë i kurrikulave, dhe pjesërisht modeli i dytë, bazuar në organizimin e kurrikullës me informacione të vogla të njëpasnjëshme, të cilat nisen nga aftësitë paraprake të kursantëve dhe shtrihen deri në aftësitë intelektuale që priten të arrihen në fund të kurrikullës. Ky model kurrikulle ndryshe nga i pari, merr më shumë në konsideratë bazën psikologjike të dijes dhe krahas praktikizmit stërvitor merr rëndësi edhe përgatitja psikologjike në shkallën më të lartë duke rritur aftësitë psikologjike të ushtarakëve shqiptarë.

Periudha e tretë ka një kohëzgjatje gati një dekadë e gjysëm, që prej 13 janar 1966 deri në fund të viteve 80-të, periudhë e cila konsistonte në punën e Komandës dhe Sektorit të Planizimit të Akademisë duke u përqëndruar në zbatimin e detyrave që shtruheshin në atë kohë "Tezat e Këshillit të Mbrojtjes". "Tezat" ishin dhe mbeten në fokus të niveleve më të larta nga viti 1968 e deri në vitin 1974, që u shfrytëzuan edhe si pretekst për të ashtëquajtur "fshesë e hekurt" e vitit 1974, që fshiu elitën e intelektualizmit ushtarak shqiptar. Vit pas viti e dyshim pas dyshimi të lindjes dhe rilindjes së "armiqëve të klasës", cuan në dënimin e mëse 400 ushtarakëve nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe repartet e njësitë e ushtrisë. Në këtë periudhë u shfrytëzuan veçanërisht kërkesat e "Artit Ushtarak mbi Luftën Popullore" të viteve '70-të e '80-të, për të ecur "të sigurt" në rrugën e vetmisë së madhe sikurse në të gjitha fushat edhe në fushën ushtarake që rezultoi një rrugë jo e sukseshme. Në këtë periudhë u kalua nga sistemi i Korpuseve dhe Grupimeve Operative në Sistemin e Divizioneve, cka rriti shumë shtrirjen e njërive të mëdha në të gjithë hapësirën shqiptare, duke krijuar Divizione edhe aty ku nuk kishin ekzistuar kurrë, si në Delvinë, Përmet, Tropojë, Pukë, Shijak etj. Edhe kurrikulat mësimore në këtë periudhë në Akademi u përpiluan nga Sektori i Planizimit të AM në këtë periudhë duhej t'u përgjigjeshin kërkesave paradoksale që shtronte Arti Ushtarak mbi Luftën Popullore, që Forcat e Armatosura duhej të përgatiteshin që "...për të qenë gjithmonë në gatishmëri dhe të ishin në gjendje në çdo kohë e në çdo rrethanë, të ndeshen në fushën e luftës dhe të korrin fitoren përfundimtare mbi çdo agresor ose bashkim/kualicion agresorësh që do të guxonin të preknin kufijtë e Shqipërisë". Gjatë kësaj periudhe në veprimtarinë e Akademisë së Mbrojtjes, u bënë përpjekje që krahas kurrikulave të kurseve dyvjeçare që përbënin bazën e këtij institucioni arsimor ushtarak, të përpiloheshin kurrikula edhe për kurse të tjerë kualifikimi afatshkurtër, si Kursi i shtabmadhorëve, që ishte edhe kursi më i lartë teorik e praktik që zhvillohej në Akademi, Kursi i perfeksionimit të oficerëve artilerë, të prapavijës, kurset e korespondencës, kursi i komandantëve të grupeve vullnetarë, i funksionarëve pushtetarë e partiakë në funksion të ushtrisë etj.

Kurrikulat mësimore në këtë periudhë ishin përpiluar me zhvillim temash me luftime në kushte të veçanta, të tilla si; luftimi natën, luftimi në vende të banuara, luftimi në dimër, luftimi kundër mbrojtjes së fortifikuar të armikut, luftimi në pyll, kalimi në mësymje në ecje e sipër, luftimi me pengesa ujore, luftimi në tokë të hapur, luftimi në vende malore e alpine, luftimi në vende malore të xhveshura dhe gurore, luftimi në rrethim,

luftimi në ndjekje e deri në luftën e shkallës së dytë (ose lufta me front të dytë ose lufta partizane). Kjo lloj lufte konsistente në braktisje të qyteteve sipas teorive maqeduniane, në daljen në mal, në konsumin e forcave dhe të mjeteve të armikut, në përqëndrimin e forcave dhe mjeteve dhe në dhënien e kundërsulmeve e kundërgoditjeve të fuqishme, për ta kthyer zhvillimin e fateve të luftës në favorin tonë, "duke i marrë inisiativën armikut dhe duke u rikthyer përsëri në formën e luftës me front të rregullt. Por kjo ishte dhe mbeti një teori e dështuar dhe në fakt e pavërtetuar në praktikë. Asgjë të re pozitive dhe që mund t'u jepte rrugëzgjdhje probleme ushtarake të kohës. Kjo nuk ishte as më pak dhe as më shumë por vec një dështim i paralajmëruar dhe nën zë i elitës intelektuale të kohës. Askush nuk e besonte se do të lejohej teoria e "pushtimit të tokës shqiptare" dhe pastaj të rifillonte aktiviteti për ta "përzënë armikun nga vatrat shqiptare".

Periudha e katërt është periudha e erës së re të ndryshimeve, ku përfshin periudhën e post viteve 90-të, ndryshimet demokratike të cilave përfshin edhe Akademinë e Mbrojtjes, që në atë periudhë kishte emërtimin "Akademia e Shtabit të Përgjithshëm". Si gjithë shoqëria shqipëtare, edhe Akademia u përfshi në proceset e reja të ndryshimeve, të transformimeve e të orjentimit drejt vlerave të reja Euroatlantike. Në kuadrin e përpjekjeve të ndërmarra për t'a bërë ushtrinë shqiptare dhe Akademinë të denjë për bashkëpunim e integrim me institucionet ushtarake perëndimore, nga gjithë stafi pedagogjik dhe jo vetëm kapërceu shpejt barrierat e kohës.

Komanda e Akademisë si dhe stafi pedagogjik vendosi lidhjet dhe bashkëpunimin me shumë akademi homologe si ato amerikane, gjermane, turke, italiane, etj, dhe në këtë kuadër është marrë edhe përvoja e pasur e kurrikulave mësimore të këtyre akademive.

Ishte koha kur bashkëpunimi u finalizua me hapjen në vitin 1996 të disa kurseve të ndryshme, si KTHOSH, Kursi i Funksioneve në Shtab (KFSH), kursi i shtabit të përgjithshëm (KSHP) dhe kurse afatshkurtra didaktiko-mësimore 15 ditor deri në një mujor.

Hapja e këtyre kurseve detyrimisht u shoqërua me kurrikula mësimore të reja, të cilat u përpiluan kryesisht në bashkëpunim me Sektorin e Mësimin të Akademisë së Drejtimit të Hamburgut. Bashkëpunimi me akademinë gjermane ngelet një periudhë me gjurmë të thella të një përvoje shumë të cmuar për ushtarakët shqiptarë. Kjo edhe për faktin që një kontigjent i konsiderueshëm shkoi dhe i ndoqi dpd studimet në Gjermani.

Arritje e veçantë e periudhës së "erës së demokracisë", pas viteve 90-të është hapja për të parën herë në institucionin tonë e Kolegjit të Mbrojtjes, i cili siguroi një hapsirë të re për arsimimin jo vetëm të ushtarakëve madhorë, të qeveritarëve të niveleve të ndryshme, të deputetëve, diplomatëve, e të gazetarëve vendas, por edhe të ushtarakëve të huaj nga rajoni. Për këto kurse nga institucioni ynë dhe veçanërisht nga sektori i planifikimit u bë një punë tepër e përgjegjeshme dhe e lavdërueshme në hartimin e kurrikulave mësimore sipas standarteve të Kolegjeve homologë të vendeve Perëndimore. Në të gjitha kurset e këtij kolegji u ftuan dhe kanë ligjruar mjaftë pedagogë e personalitete të huaj e vendas, çka përbën edhe një dukuri të veçantë



për arsimimin ushtarak shqiptar, që u oasua edhe në 9 kurset e tjera që pasuan me emërtimin "Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes".

Hartimi i kurrikulave mësimore të Akademisë së Mbrojtjes shoqëroi hap pas hapi ndryshimet strukturore që ndodhnin në FA për shkurtrimin e tyre dhe kalimin në ushtri profesioniste. Reforma në kalimin plotësisht në ushtri profesioniste ishte ajo e vitit 2010 kur u hoq tërësisht shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Që nga viti 2005 e këtej programet janë përgatitur jo vetëm për kurset e shkurtëra dy e tre mujore por edhe për kurset një vjeçare si ai i Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursit të Lartë. Një arritje e mirë gjatë kësaj periudhe ka qënë edhe futja në kurrikulat mësimore të Kursit të Shtabit të përgjithshëm e temave të ndryshme për Operacionet e Mbështetjes së Paqes, pasi një kontigjen jo i vogël i ushtarakve tanë janë me mision në Bosnjë-Hercegovinë, Irak, Afganistan, Gjeorgji etj. Në këtë fazë gjatë planizimit, kurrikula mësimore është organizuar në modelin e tretë të saj, rreth aktivitetit të kursantëve, të cilat planifikohen nga Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes, Departamentet, pedagogët dhe kursantët e akademistët së bashku. Në këtë rast mjetet kryesore të organizimit të të gjitha kurrikulave janë projektet dhe jo konceptet ose aftësitë.

Por vitet kur vendi ynë ishte pjesë e Partneritetit për paqe (PPF), të marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO dhe sidomos viti i anëtarësimit me të drejta të plota në NATO shënon një epokë të re të rëndësishme si pjesë e mbrojtjes kolektive të saj. Këtij zhvillimi të rëndësishëm ju përgjigj pikërisht me evolucion cilësor edhe Akademia më e lartë e sistemit ushtarak shqiptar.

Në kushtet e reja u shtrua nevoja e përsosjes së sistemit arsimor ushtarak në mënyrë tërësore. Spektri dhe niveli i problemeve me të cilat ndeshet shkolla jonë sot e në të arthmen, shtrun edhe më tepër nevojën e thellimit të përmbajtjes cilësore të kurrikulave mësimore. Fushat në të cilat priten përgjigje pozitive për hartimin e kurrikulave, lidhen me formimin e brendisë akademike, me modernizimin e përmbajtjes së saj e të trupës pedagogjike mësimore-shkencore, me përsosjen e metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me rritjen e rendimentit të orës mësimore tashmë të miratuar me ligj 60 minutëshe si dhe me ndryshimet e detyrueshme strukturore në modernizimin e Forcave

tona të Armatosura.

Tashmë që përvoja akademike nuk mungon, në bashkëpunim dhe me vendet e Aleancës, projekti i hartimit të kurrikullave mësimore-shkencore, duhet intensifikim në konceptimin e objektivave të reja ushtarake, të përshtatura në mjedisin e ri të sigurisë të krijuar posaçërisht për Forcat tona të Armatosura pas samitit të Strasburg-Këlnit, me pjesëmarrje të vazhdueshme dhe kryerje detyrash luftarake në kuadrin e misioneve dhe operacioneve të përbashkëta paqeruajtëse dhe paqebërëse, me përmbushje të nevojave dhe interesave të kursantëve tanë, si dhe të ndryshimeve dhe zhvillimeve bashkëkohore të kurrikullave të shkollave ushtarake të vendeve Perëndimore të aleancës më të madhe të sigurisë në botë.

Në përcaktimin dhe konceptimin e përmbajtjes tematike të kurrikullave duke ruajtur module, fusha, nënfusha, tema, koncepte etj, nga kurrikulat ekzistuese, të cilat u përgjigjen kërkesave aktuale, dhe, duke zhvilluar fusha, nënfusha, tema, koncepte të reja për të pasqyruar kontekstin e ri të zhvillimit të mendimit ushtarak.

Udhëzimet metodike të FSM-së kanë bërë që të përzgjedhin pedagogët për procesin mësimor, duke dhënë parime të rëndësishme bashkëkohore didaktike e pedagogjike, duke theksuar ato aspekte që i kanë munguar realitetin tonë për dekada, me piksynime të qarta për t'i lënë më tepër liri veprimtarisë së bashkërendimit të punës midis stafit pedagogjik të pedagogëve me akademikët në gjithë procesin e mësimdhënies.

Kontrolli i dijeve për dekada ka qenë "thembra e Akilit" në mësimdhënien cilësore. Prandaj kontrolli i dijeve vlerësohet si element të rëndësishëm të realizimit të objektivave, që përfshin tërësinë e problematikës "diagnostikuese" si dhe gjetjen e metodave efikase të nxitjes së formimit të thellë të dijeve të qëndrueshme. Ky nuk është vetëm një problem shqiptar dhe aq më pak i arsimimit ushtarak shqiptar, por një fenomen mbarëglobal. Vlerësimi është një mjet matës konkret për nivelin e arritjeve të objektivave mësimore nga ana e stafit pedagogjik, për vetëvlerësimin e kursantëve dhe nxitës për progres me vështrim tek e ardhmja. Mjedisin gjeopolitik dhe Strategjia Ushtarake shqiptare është sintezë e zhvillimeve prandaj dhe përballjet me rreziqet e kërcënimit janë objekt e subjekt i studimit të kurrikullave mësimore, për t'ju përgjigjur kushteve konkrete dhe zhvillimeve rajonale, europiane e botërore.

Le të sjellim dy shembuj domethënës të programimit mësimor të dy epokave. Dëgjuesi dhe lexuesi i "Cilësia akademike kusht dhe nevojë e vazhdueshme e arsimimit ushtarak", do të dallojë lehtësisht evoluimin në gjashtë dekada.

Programet mësimore janë baza e punës mësimore të çdo institucioni mësimdhënës. Programi mësimor në Akademinë e Forcave të Armatosura është dokument bazal dhe mjaft i rëndësishëm mbi bazën e të cilit ngrihet gjithë veprimtaria mësimore akademike e kërkimore shkencore. Programi mësimor është konkretizim i veprimtarisë së përbashkët koordinuese ndërmjet departamenteve për hartimin e detajuar dhe të ndarë të planifikuar modulet dhe lëndët mësimore në interes të realizimit të misionit dhe të detyrave të ngarkuara nga Senati Akademik për çdo Kurs studimi/ Program studimi në AFA. Për realizimin e Programeve në AFA

zgjodhet metoda mësimore. Metoda mësimore është mënyrë, mjet dhe formë e veprimit në punën mësimore me anë të ligjërit dhe të përvetësimit të diturive, shprehive dhe shkathtësive, ku realizohet drejt dhe përpunohet materiali mësimor dhe në atë përpunim bëhet përshtatja psikologjike dhe ideologjike e materialit sipas mjedisit të caktuar akademik, që mundëson zhvillimin e personalitetit shoqëror të akademistit dhe të të gjitha ftësive të tij në funksion të karrierës ushtarake. Filozofia e të mësuarit akademik i ka rrënjët në lashtësi e që kanë vijuar me filozofët ballkanas si Sokrati, Platoni e Aristoteli, që aplikuan më herët metodat mësimore. Metodot evoluon në shekujt që pasuan e veçanërisht gjatë mesjetës e më vonë nga Jan Amos Komenski, Xhon Loku, Zhan Zhak Rusoi, Pestaloci, Herbarti etj. Akademikët e shekujve të mëvonshëm e veçanërisht në tre shekujt e fundit mësimdhënia dhe metodologjia e të mësuarit pësuan ndryshime e përsosje të vazhdueshme. Çështjet e organizimit të akademik të orës mësimore, kritereve në zgjedhjen e metodave mësimore kanë ardhur duke u përsosur për: modulet e lënda mësimore; përmbajtjes mësimore; tipi i orës mësimore; etapa e organizimit të orës mësimore; moshë dhe shkallë e zhvillimit psikofizik i akademikëve/studentëve; numri i kursantëve në grupe mësimore; forma didaktike e organizimit të orës mësimore; koha në dispozicion; baza materiale didaktike mbështetëse; aftësia profesionale e pedagogjike e lektorëve etj. Programet mësimor në AFA, për dekada të tëra kanë paraqitur brendinë e lëndëve mësimore, kanë qenë konkretizim i planeve mësimore e akademikë të trajtuar në funksion të misionit të Akademisë, gjithmonë e shkallëzuar sipas thellësisë, gjerësisë dhe nevojave të përgatitjes së shtabnikëve dhe komandave të të gjitha niveleve akademike. Programet mësimor të çdo moduli/lënde i bashkohen edhe detyrat e detyrimet e përgjithshme dhe të veçanta, që pas miratimit të tyre nga Senati Akademik si organi më i lartë kolegjial i fushës akademike merr karakter të detyrueshëm zbatues. Programet mësimore sikurse edhe planet mësimore, edhe për Akademinë e Forcave të Armatosura janë struktura didaktike akademike të cilat mund e duhet të pësojnë ndryshime si në përmbajtje ashtu edhe në formë në përputhje me zhvillimet e kohës, pas analizave të zhvillimit konkret të tyre.

### **Vitet '60-të të shekullit të kaluar (përvoja ruse)**

Programet mësimore në "Shkollën e Naltë Ushtarake" në janarin e vitit 1959 ishin efektive e matur kjo me "kutin e kohës". Kështu programet e para që me hapjen për herë të parë të Akademisë/Shkollës së Naltë Ushtarake janë ngritur mbi bazën e eksperiencës së Akademive të larta ushtarake të Ish-BRSS. Gjithashtu edhe kontigjenti i ushtarakëve drejtues e menaxhes, i pedagogëve, dhe stafit mbështetësi i përkasin shkollës ruse për kohën. Programet mësimore në ditën e parë të zhvillimit të "Shkollës së Naltë Ushtarake" ka pasur specifikat e veta. Në vitin e parë të zhvillohen lëndë të kulturës së përgjithëshme dhe më tej edhe program i detajuar taktiko-operativ..." Fillimi i mësimimit në Shkollën e Naltë Ushtarake është i dokumentuar në datën 2 janar 1959, sipas shkresës së dërguar për Ministrinë e Arsimit të datës 6.12.1958, ku shkolla e lartë planizoi

dhe zbatoi një program të miratuar me 600 orë mësimore për kulturë të përgjithëshme që do të zhvillohej për një periudhë gjashtë mujore: janar – qershor 1959, që përfshinte Matematikë 300 orë mësimore, Fizikë 80 orë, Kimi 70 orë, Gjeografi 50 orë, Gjuhë shqipe 100 orë. Sipas shkresës së firmosur nga Komandanti Thoma Xhixho, lëndët ishin ndarë dhe do zhvilloheshin në dy grupe mësimore. Mësimi do të vijonte më tej sipas programit të miratuar nga dy ministrat përkatësisht nga Ministri i Mbrojtjes Popullore (MMP) dhe nga Ministri i Arsimit dhe kulturës (MAK).

Viti akademik 2017-2018, pas gjashtë dekada aktiviteteve akademik (përvoja euroatlantike): Programet mësimore në Akademinë e Forcave të Armatosura në vitin 2017-2018:

Për vitin akademik 2017-2018 FSM-ja ka përgatitur gjithësej 5 programe për kurset institucionale si dhe tre programe për kurset master dhe më konkretisht:

- Programi mësimor për "Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri" (KPO) për vitin akademik 2017-2018. Program mësimor i KAP është miratuar me Vendimi nr.4, datë 12.07.2017 "Për miratimin e programit të Kursit të Arsimit të Përgjithshëm të Departamenti të Përgatitjes së Oficerit të Ri, si dhe me Vendim nr. 34 datë 14.7.2017, të Senatit Akademik të AFA-së. Kursi do të zgjasë 27 javë në AFA si dhe 9 javë në Bunavi. Kursi do të kishte këtë mision: "Arsimimi dhe përgatitja e oficerave të rinj të FA të aftë për të drejtuar nënrepartet në realizimin e misionit kushtetues. Në total ishin planifikuar 1532 orë, që ishin ndarë: etapa e parë në Bunavi me 330 orë; etapa e dytë në AFA me 807 orë, dhe etapa e tretë arsimimi special me 395 orë. 12 module në etapën e parë; 8 module në etapën e dytë dhe 4 module në etapën e tretë. Programit i Kursit të Arsimit të Përgjithshëm është me 234 faqe.

- Programi mësimor i Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH-it) për vitin akademik 2017-2018, (programi gjendet në sekretari me numër rregjistrimi 1950/3 datë 3.10.2016). Programi mësimor i Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit është miratuar me Vendim nr. 34 datë 14.7.2017, të Senatit Akademik të AFA-së. Misioni i KTHOSH-it edhe për këtë sezon ka qenë në vijimësi i pandryshuar, po kështu edhe detyrat. KTHOSH-i zhvillohet në 13 javë ose 66 ditë mësimore; 52 ditë me gjashtë orë; në total programi mësimor ka 475 orë, me 19 kredite, ku 84 orë janë leksione, 146 orë seminare, 119 orë aktivitete të tjera, 126 orë studim individual. Programi mësimor i KTHOSH-it ka pasur këtë ndarje orësh: Departamenti i Operacioneve me 250 orë; Departamenti i SSK me 75 orë; Departamenti i Lidershipit me 75 orë dhe Departamenti i SHSH me 75 orë dhe në total ishin 475 orë. Përgjatë vitit akademik 2017-2018 u zhvillua program mësimor me katër grupe mësimore; dy për rejsin e parë nga 3 tetori 2017 deri më 19 janar 2018 si dhe dy grupe të tjerë nga 5.2.2018 deri më 18 maj 2018.

- Programi mësimor i Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) për vitin akademik

2017-2018. (programi gjendet në sekretari me numër rregjistrimi 1950/4 datë 3.10.2016). Programi mësimor i Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm është miratuar me Vendim nr. 34 datë 14.7.2017 të Senatit Akademik të AFA-së. KKSHP zhvillohet në 10 muaj/43 javë/207 ditë mësimore. Kursi filloi më tetor 2017 dhe përfundon më 20.7.2018 me 1530 orë mësimore me 60 kredite. Ndarja e orëve sipas departamenteve mësimore është: Departamenti i operacioneve 625 orë; Departamenti i SSK dhe Historisë 300 orë; Departamenti i Lidershipit 250 orë; Departamenti i SHSH 250 orë; gjuhë e huaj anglisht 75 orë, që në total përbëjnë 1500 orë.

- Program mësimor i Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) për vitin akademik 2017-2018. (programi gjendet në sekretari me numër rregjistrimi 1950/5 datë 3.10.2016). Program mësimor i Kursit të Lartë të Oficerit është miratuar me Vendim nr. 34 datë 14.7.2017, të Senatit Akademik të AFA-së. Programi i KLO-së është hartuar me kohëzgjatje një vjeçare akademike me dy simestra dhe zhvillohet në 10 muaj/42 javë/195 ditë mësimore: 156 ditë me gjashtë orë, 39 ditë me pesë orë në ditë. Leksionet zhvilloheshin në auditor 6-8 orë në javë dhe në total programi mësimor ka patur 1536



orë, ku 12 orë janë organizim 86 orë në dispozicion të komandantit, 90 orë vizita të përbashkëta mësimore që përbëjnë 114 orë për arsimim plotësues dhe çështje organizative. Totali i krediteve 60. Ora mësimore 50 minuta. Programi mësimor i KLO-së i shtrin studimet në fushat e Strategjisë dhe të Udhëheqjes ushtarake, në shkencë shoqërore dhe Operacione.

- Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-9) për vitin akademik 2017-2018. Programi mësimor i Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes është miratuar me Vendim nr. 34 datë 14.7.2017. KLSM-9 u zhvillua në periudhën 11.9.2011 deri më 7.12.2011. KLSM-9 u zhvillua me 6 module: Strategjia e politikave dhe sigurisë kombëtare, Ballkani perëndimor dhe integrimi në NATO-BE; Konflikti i armatosur dhe terrorizmi; Ligjislacioni ndërkombëtar i luftës; Lidershipi modern dhe sfidat e së ardhmes; Demokracitë e reja regjionale (perspektiva dhe sfida). Në total me 46 ditë mësimore me 150 orë mësimore, si dhe dy udhëtime në Kruijë dhe Sarandë si dhe në Romë, Bruksel në NATO, SHAPE dhe SHP belg. Grupi mësimor i KLSM-9 përbëhej: nga 16 studentë, ushtarakë e civilë nga vendet e rajonit e më gjerë: Italia, Turqia, Greqia, Gjeorgjia, Maqedonia, Romania, FSK e Kosovës, Britania e Madhe dhe 6 studentë, ushtarakë

e civilë, përfaqësues nga institucione të mbrojtjes e sigurisë, Ministrisë së Drejtësisë e Presidencës. Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), është kursi më i lartë në piramidën e arsimit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kursi zhvillohet në gjuhën angleze, me pjesëmarrjen e ushtarakëve të gradës "Kolonel" nga FA dhe vendet e rajonit, si dhe pjesëmarrës nga institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes të RSH. KLSM ka një kohëzgjatje prej tre muajsh. Qëllimi i kursit është dhënia e njohurive në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe mundësimi i një mjedisi akademik, i cili shpjegon dhe prezanton sfidat me të cilat ndeshen vendet e rajonit dhe më gjerë. KLSM është kursi më i lartë institucional në hierarkinë e arsimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Është fakt se prej shtatorit 2007 e deri më 7.12.2017, për 10 vjet Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes (FSM) nga KLSM-ja ka certifikuar 157 vetë, nga këta: 109 ushtarakë dhe 48 civilë, 94 shqiptarë dhe 63 të huaj, nga 15 vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë. Drejtor i kursit ka qenë Nënkolonel Msc. Arian Osmani, ndërsa lektorë kanë qenë Docent Selim Shiroka, Arian Osmani, Louis Boros, Arnol Dupy, Tamir Sinai, Karlo Zhan, James Wither etj. Programet e ciklit të II-të, "Master" janë një përvojë disavjeçare në Akademi. Për vitin akademik 2017-2018, menjëherë pas akreditimit institucional u përgatitën dhe u dërguan pranë MASR tre programe master: "Master Profesional", "Master i Shkencave" dhe "Master Ekzekutiv", të cilat janë në rrugën e akreditimit. Në lidhje me zbatueshmërinë e tyre për arsye të plotësimit edhe të boshllëkut ligjor për zhvillimin konkret të tyre, pas daljes së akteve nënligjorë e administrativë, VKM-ve si dhe Urdhërave e Udhëzimeve të MASR-it, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë", AFA, sërish do të "ndeze motorrat", për një betejë të re edhe më të rëndësishme edhe më sfiduese për pasurimin e dijeve në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

### **Standarti dhe cilësia nuk janë fushatë, por vijimësi**

Rritja e standardeve dhe cilësisë është kusht për arrijtjen e atij nveli standardi e cilësie të cilat bëjnë të mundur akreditimin dhe konkurrimin mes institucioneve të arsimit të lartë në vend. Kjo mund të arrihet me programe dhe kurrikula bashkëkohore, me trupë mësimore të kualifikuar, me infrastrukturë moderne dhe me zhvillimin e lirisë akademike brenda kontekstit institucional, të materializuar në Statutin dhe rreguloreve të saj të funksionimit dhe vlerësimit.

Sfidë e veçantë për Akademinë, është kërkimi dhe zbatueshmëria e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke realizuar vënien e studentëve në qendër të diskutimeve dhe të pedagogëve të orientuesit e moderatorit. Metodot e reja të synojnë të zhvillojnë tek studentët mendimin kritik që duhet të karakterizojnë çdo oficer të shtabit për sa kohë që vendimi nuk është marrë. Nxitja e imagjinatës është e pamohueshme, këto diskutime ndonjëherë kanë nevojë për të shpalosur në realitet edhe kufizimet aktuale. Në parim, është roli i pedagogut të grupit ai që nxit lirinë e fjalës së gjithsecilit, për të favorizuar ballafaqimin e ideve, por edhe për t'i kthyer idetë në funksionalitet prak-

tik. Imagjinata dhe gjykimi i thellë janë gurët e themelit të të menduarit, të përshtatjes për sa kohë që njëra ose tjetra mund të mbështetet mbi një kulturë të gjerë të përditësuar në mënyrë të përhershme. Për këtë arsye stafi pedagogjik i Akademisë vijon të kontribuojë në arrijtjen e objektivave të pritsëm të programeve si dhe lidhjen e mësimit konkret me zhvillimin e doktrinës Ushtarake e punën kërkimore në fushat e sigurisë dhe Mbrojtjes.

Për këtë arsye serioziteti dhe profesionalizmi i trupës mësimdhënëse të Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes mer përparësi për auditorët e mësimdhënies. Trainimi në grup, aftësitë pedagogjike, gjetjen e rrugëve efikase të transmetimit të përvojës diturisë të studentët, krijimi i lidhjeve logjike mes teknikave dhe strategjive, si dhe mes praktikave dhe doktrinës do të garantojë suksesin e së ardhmes. Sistemi ushtarak nuk funksionon si një administratë civile, prandaj edhe doktrina ushtarake mendohet e "ndërtuar", në fakt në tre "vende" të ndryshme: fillimisht në fushë aty ku merr formë, testohet dhe finalizohet, pastaj në shtab ku formalizohet dhe zhvillohet më tej, në fund në një shkollë që quhet akademi/kolegj, ku ndodh mësimi dhe kritika. Kriteret, përvoja, integriteti moral, përzgjedhja dhe jo diktimi, motivimi si dhe vullneti për t'u vetëzhvilluar, janë disa nga prioritetet që AFA mban në konsideratë në procesin e përzgjedhjes dhe kualifikimit të stafit pedagogjik. Profesioni i pedagogut duhet vlerësuar maksimalisht sepse në ndonjë rast ka munguar edhe mbështetje motivuese si në promovimin në karrierë, cka është jetike për një ushtarak. Në këtë kuadër përzgjedhja, kriteret dhe parametrat e përcaktuara për mësimdhënësit është filtër i mirëfunksionimit të cilësisë për të gjitha nivelet e mësimdhënies në AFA. Standardizimi i procesit për përzgjedhje të personelit pedagogjik lidhet para së gjithash me dashurinë për librin, mësimdhënien, institucionet arsimore të Forcave të Armatosura, motivimin për vetëzhvillim si dhe ngritjen e pasurimin e traditës.

### **Në vend të mbylljes:**

Që prej vitit 1958 shqiptarët kanë pasur dhe kanë një Akademi të Forcave të Armatosura. Që prej viteve 60-të të shekullit të kaluar e deri më 2010 në kishim edhe Akademi (Departament) Aviacioni dhe Marine, dy armë me funksion special në ushtritë e gjithë botës. A duhet ta rivlerësojmë veten në këtë drejtim apo me një officer marine dhe një officer aviacioni pranë AFA-së do ta ngrysim dhjetëvjeçarët e rinj të fillimshkullit të XXI? Dikur Akademia e Mbrojtjes (për pak kohë edhe Akademia e Shtabit të Përgjithshëm) ishte përgjegjëse për Arsimimin dhe kualifikimin e oficerëve të shtabit dhe drejtuesve të lartë ushtarakë e civilë të FA, për zhvillimin e doktrinës ushtarake dhe studimet e avancuara në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Arsimimi dhe kualifikimi i personelit ushtarak dhe civil për të gjitha nivelet e larta e drejtimit të FA dhe institucioneve të tjera të shtetit e të shoqërisë realizohet nëpërmjet disa kurseve siç janë, Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH); Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP); Kursi i Lartë i Oficerit (KLO); Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes. Sot i është bashkuar edhe një departament, DPOR, që meriton vëmendjen e një institucioni.

Aktualisht në Akademinë e Mbrojtjes studiojnë gjithë ushtarakët e të gjitha niveleve me personel officer dhe civil. Ne kishim dhe kemi kursantë të të gjitha niveleve. Ku po shkon AFA-ja në të ardhmen. A jemi në "shinat" e duhura, a jemi institucion elitari simotrat e saj euroatlantike? Duhet të përfaqësohemi me shifra apo me cilësi. Gjykojmë se cilësia dhe profesionalizmi duhet të dallojë këtë IAL. Nuk mjaftojnë ligjet, Vendimet e Këshillit të Ministrave, direktivat, urdhërat e udhëzimet, procedurat standarte, dhe mbyllja hermetike, por mbi të gjitha dëshira dhe ambicja për zhvillim.

Gjashtë dekada nga krijimi i "Shkollës së Naltë Ushtarake, për Institucionin ushtarak arsimor janë sfidë dhe obligim për pedagogët, punonjësit shkencorë, dhe akademistët për t'a vazhduar me dinjitet e përkushtim historinë e suksesit të saj. Përsosmëria e kurrikullave në vite është tregues i cilësive dhe vlerave mësimore të Akademisë së Forcave të Armatosura. Përvjetori i gjashtëdhjetë është respekt e nderim për të djeshmen, është apel i brezave për të sotmen dhe të ardhmen, është thirrje të gjithë për t'ju përgjigjur me përgjegjësi, përkushtim dhe atdhetarizëm kërkesave, për të ngritur ushtarak, për ta bërë atë më atraktiv, sikurse shkollat e Akademisë simotra euroatlantike.

Akademia e Forcave të Armatosura po "rigjen veten" dhe po rigjeneron "plagët" me "melhemin" e stafit pedagogjik, me fokus edhe kërkimin shkencor si kërkesë e re e kohës. Nga ana tjetër zgjerimi i bashkëpunimit me institucione homologe të aleatëve si dhe me institucione të arsimit të lartë e të kërkimit në vend, mbetet një sfidë e vazhdueshme, që stafet mësimdhënëse dhe drejtuesit e tyre do të mund të përballen sukseshëm.

Është fakt "ish-Shkolla e Naltë Ushtarake" e 1958, është sot Akademia e Forcave të Armatosura 60 vjeçare". Por sa më e madhe të jetë ajo aq më shumë përvojë grumbullon rreth vetes, dhe nuk ka asgjë të përbashkët me atë që amerikanin i madhi Benjamin Franklin thotë për njerëzit: "Tragjedia e jetës është se ne rrisim shkallët e jetës tepër shpejt dhe mençurohemi tepër vonë", dhe që më tej e mbështet fuqishëm të shkolluarin, edhe kur ai është gjeni, kur thotë: "Gjeniu pa shkollim është si argjendi në minierë".

### Rekomandime:

**Së pari:** Cilësia akademike kërkon pikësëpari, pa hequr dorë nga burimet e studimit që ofron teknologjia, edhe rikthim të vëmëndjes nga libri për pajisjen e bibliotekës me prurjet më të reja bashkëkohore, që do të ishte një ndër ndërveprimet më të mira institucionale të planifikimit buxhetor të ardhshëm. Të mundësohet zbutja deri në heqje të barrierave që kufizojnë civilat me tituj e grada për vijimin e mësimdhënies në Akademinë e Forcave të Armatosura sepse "pa të shkuar nuk ka dhe nuk mund të ketë të ardhme". Ky është edhe një mësim që vjen natyrshëm nga partnerët tanë perëndimorë.

**Së dyti** t'i japim jetë Neni 18-të, "Akademia" të Ligj Nr. 80/2015, date 21.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSh", në të tre përcaktimet themelore të tij: për fushën e arsimit të lartë të profilizuar; të mundësimin të ofrimit të programeve të

studimeve në të gjitha ciklet e studimit veçanërisht karakterit profesional të sigurisë; si dhe mundësimin e kërkimit shkencor bazë të bazuar në këtë ligj dhe në statutin e saj. E gjithë kjo veprimtari të mundësohet me mbështetje nga strukturat mbështetëse superior si dhe me miratimin e një VKM-je "Për status të veçantë".

**Së treti:** Akdemisë së Forcave të Armatosura t'i shtohen mundësitë për t'u pajisur me mjetet më të nevojshme të mësimdhënies si dhe të mundësohet lidhja e bashkëpunimi me akademitë si motra të ushtrive euroatlantike.

**Së katërti:** Në funksion të rritjes së cilësisë akademike, gjykojmë se modeli më i mirë për të pasur përputhshmëri reale me LAL do të ishte më produktive që KKSHP si dhe KLO-ja të bashkoheshin në dy vite akademike për të mundësuar edhe çeljen e Programeve të Studimeve "Master" mbi bazën e kualiteteve që disponojnë Forcat tona të Armatosura.

### Bibliografi:

- Eqrem Çabej, "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", Tiranë 1994.
- Brian Tracy, Lidhshipi, Prishtinë: Shtëpia Botuese "Damo", 2014.
- Udhëheqja ushtarake, Nr1, Tiranë: Qendra e shtypit e Botimeve dhe e Perktimeve ushtarake, 2009.
- Programi i Kursit të titullimit të oficerëve të rinj, Tiranë, 2015.
- Programet mësimore të FSM-së për vitin akademik 2017-2018, AFA.
- Enciklopedia e përgjithëshme, britanike, përkthim në gjuhën shqipe, Tiranë, 2008.
- Ligj Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSh".
- Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, Forcat e Armatosura në Fokus Arkivor, Tiranë, 2009.
- Buletini arkivor ushtarak, Organ teoriko arkivor i AQFA-se, Tirane: Gentgrafik, 2011.
- P. Hasani, "Historia e Ushtrisë Shqiptare", pjesa e parë (vitet 1912-1944), Tiranë, 2000.
- Zaho Golemi. "Shtatmadhorja dhe shtatmadhorët shqiptarë", Publikim në Mbrojtja, nr.5/2013.
- Shënime, "Shënime mbi historikun e Akademisë Ushtarake Mehmet Shehu" për periudhën 1958-1975., të hartuar nga grup autorësh, si dokument burimor historik i paklasifikuar.
- Zaho Golemi, Taktika e ushtrisë shqiptare, Tiranë, 2005.
- Periodiku i gazetës "Ushtria", Revistës "Mbrojtja", Revistës Ushtarake, Buletini Arkivor Ushtarak. etj.
- Disertacione mbi arsimimin ushtarak. Biblioteka Kombëtare, Biblioteka e AFA, Sekretaria e AFA.
- Zaho Golemi, Gazeta "Ushtria", 4 maj 2013.
- "Shqipëria më 1937", Vëllimi i dytë (1912-1937), Tiranë 1938.
- Historia e Shqipërisë, vëll. III, Tiranë, 1984, faqe 324.
- Gazeta "Luftëtari, Organ i MM, publikim i datës 03.12.1993
- Ligji "Mbi rregullimin e Ushtrisë Kombëtare, Tiranë, 1931.
- Vendime të Këshillit të Mbrojtjes dhe Vendime të Këshillit të Ministrave në periudhën 1949-2018.

XHEMAL ÇANGU  
Qendra e Personel Rekrutimit

## QPR një strukturë e rëndësishme brenda FA

Qendra e Personel Rekrutimit (e koduar sot Reparti Ushtarak nr. 6670, Tiranë, QPR) është krijuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes Nr. 98, datë 22.06.2007 "Për miratimin e organikës analitike (TOP) të Qendrës së Personel Rekrutimit", mbështetur në dekretin e presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 1510, datë 13.11.2006 "Për miratimin e strukturës organizative të FA".

Qendra e Personel Rekrutimit është strukturë e rëndësishme e Forcave të Armatosura në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Sot me një përvojë 11 vjeçare, është bërë struktura më e njohur jo vetëm brenda Forcave të Armatosura, por, edhe jashtë saj, pasi ajo mban lidhje/bashkëpunon/ofron shërbime me të gjitha institucionet shtetërore në vend, me ato jo publike, me shtetasit shqiptar, duke qenë e pranishme në çdo zyrë postare në të gjithë territorin e vendit e në portalin qeveritar e-albania, me disa shërbime që ajo ofron.

Qendra e Personel Rekrutimit është një strukturë e rëndësishme për të dhënat dhe dokumentet që administron e menaxhon, për punën që kryen dhe shërbimet që ofron brenda dhe jashtë Forcave të Armatosura, prandaj Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura i kanë kushtuar dhe i kushtojnë një vëmendje të veçantë me theks përfshirjen e sa më shumë shërbimeve për shtetasit, ushtarakët, ish ushtarakët, institucionet, etj.

Qendra e Personel Rekrutimit realizon në praktikë ciklin e plotë të sistemit të burimeve njerëzore në Forcat e Armatosura (nga rekrutimi për ushtar/detar aktiv, rekrutimi për studime ushtarake për oficer brenda/jashtë vendit në FA, në menaxhimin e personelit ushtarak aktiv e civil, në administrimin e dosjeve dhe përkujdesjen ndaj ushtarakëve në rezervë/lirim/pension e familjet e tyre, shërbim adminis-



**↳ Eksperienca e fituar nga bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të New Jersey ka dhënë frytet e veta në përmirësimin e formave dhe procedurave të rekrutimit.**

trativ të shtetasve shqiptar për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv e në tërësi në fushën e mbrojtjes, vënien në efikasitet të burimeve njerëzore dhe materiale në raste të gjendjes së jashtëzakonshme që kalon vendi duke qenë pjese e rëndësishme e strukturave tjera shtetërore), etj.

Vend të veçantë në punën e Qendrës Personel Rekrutimit, shtyllat kryesore të saj janë: Rekrutimi për ushtar/detar aktiv në Forcat e Armatosura, rekrutimi për studime ushtarake brenda e jashtë vendit; administrimi, menaxhimi e përditësimi i të dhënave në dosjet personale dhe në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të gjithë personelin ushtarak e

civil në Forcat e Armatosura; përkujdesja ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe familjeve të tyre, krijimi i komponentit të rezervës; ofrimi i shërbimeve të ndryshme në fushën e mbrojtjes, shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv për të gjithë shtetasit meshkuj, etj.

Rekrutimi si një nga detyrat bazë të kësaj qendre, fokusohet në kryerjen e fushatave të promovimit dhe të informimit të të rinjve, grupeve të interesit dhe individëve mbi mundësitë që ofrojnë Forcat e Armatosura për një karrierë të sigurt dhe një jetë më të mirë për të rinjtë dhe të rejtat që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj.

Bazë për rekrutimin e oficerëve të

rinj, për ushtar/detar aktiv janë kriteret ligjore të përcaktuara si dhe politikat e rekrutimit e planet përkatëse të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Rekrutimi kryhet sipas planit dhe nevojave të Forcave të Armatosura, duke i dhënë përparësi rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë dhe me aftësi të mira për specialitete të veçanta, ku shpeshherë përfaqësuesit më të lartë civilë dhe ushtarakë kanë qenë pjesë e takimeve të zhvilluara në institucionet arsimore të vendit si dhe me organet vendore.

Kandidatët e regjistruar (tashmë edhe me lehtësi paraqitje dokumentacioni) i nënshtrohen testeve fizike, intelektuale dhe psikologjike. Qendra e Personel Rekrutimit është angazhuar gjithmonë të zbatojë me përpikmëri dhe transparencë të gjitha procedurat ligjore për përzgjedhjen e kandidatëve me cilësorë për realizimin e planit të rekrutimit.

Eksperiencia e fituar nga bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të New Jersey ka dhënë frytet e veta në përmirësimin e formave dhe procedurave të rekrutimit.

Në interes të rekrutimit kryhet një marketing i gjithanshëm duke bashkëpunuar me strukturat arsimore dhe ato vendore në të gjithë vendin. Këtë vit Qendra e Personel Rekrutimit ka rritur ambicidet. Ajo u përfshi dhe u bë pjesë e panairëve të punës në çdo qark, gjë që e ka bërë këtë strukturë të Forcave të Armatosura më të afërt e të pranishme jo vetëm të barabartë me strukturat e tjera shtetërore, por edhe më të afrueshme me qytetarët për mundësitë që ofron për punësim dhe arsimim ushtarak brenda dhe jashtë vendit.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i Qendrës së Personel Rekrutimit është administrimi, menaxhimi dhe përditësimi i të dhënave në dosjet personale dhe në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për personelin ushtarak aktiv dhe civil në Forcat e Armatosura. Përmes hja e misionit mbështetet në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore, rregulloreve e procedurave standarde dhe falë kontributit të dhënë nga kompania amerikane SAIC/CUBIC, është bërë e mundur vënia në efikasitet dhe programit të automatizimit së të dhënave (SMBNJ) të personelit aktiv. Të gjitha këto të dhëna të administruara në sistem, i shërbejnë më së miri menaxhimit të personelit nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura si dhe komisioneve të karrierës për mbarëvajtjen e procesit të shqyrtimit të personelit ushtarak për promovimin e tyre dhe ecurinë në karrierën ushtarake.

Përkujdesja ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe familjeve

të tyre, është një drejtim me shumë rëndësi i Qendrës së Personel Rekrutimit. Përqendrimi i të gjitha dosjeve të ushtarakëve të kësaj kategorie, mbi 50000 dosje si dhe i procedurave për pasqyrimin në dokumentet e kërkuara për të gjitha llojet e pensioneve dhe përfitimeve suplementare, e ka bërë shumë të vlefshme punën e personelit duke i dhënë më shumë cilësi, shpejtësi dhe transparencë trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesave të kësaj moshe apo familjeve të tyre.

Për këtë QPR bashkëpunon ngushtë me ISSH si dhe me 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në qarqe për zgjidhjen e disa problemeve për kategorinë e ushtarakëve në rezervë/lirim/pension për dokumentet e daljes në pension dhe për përfitimet suplementare, në veçanti për kategorinë e personelit nënoficer të cilëve u mungojnë të dhënat, dosja personale apo kur ajo është e pa plotë, evidentimin e listë pagesave të reparteve të suprimuara, apo edhe për zgjidhjen e disa problemeve ligjore me ISSH, për të cilën është ngritur me urdhër të SHSH-PFA dhe funksion grupi i eksperteve, etj, në fokus të cilave janë problemet e për njohjen e shkollës së lartë ushtarake brenda dhe jashtë vendit për efekt llogaritje të daljes në pension pleqërie, pension invaliditeti, apo pension familjar (për meshkujt), njohjen e vjetërsisë si ushtarak të personelit në funksionin organik "punonjës posti", në reparte e radiozbulimit, të fituar sipas Ligjit nr. 8087 datë 13.03.1996, i ndryshuar, edhe për përfitimet e reja, pension suplementar mbi pensionin e pleqërisë, etj.

Administrimi i të dhënave për kryerjen e "Shërbimit të Detyrueshëm Usharak Aktiv" i mbi 1500000 shtetasve shqiptarë meshkuj, në Qendrën e Personel Rekrutimit si dhe ofrimi i këtij shërbimi publik pa pagesë brenda 2-3 ditëve, ka bërë që të njihet e vlerësohet nga shtetasit dhe institucionet shtetërore në vend me të cilët mban korrespondencën e duhur.

Personeli i kësaj qendre është gjithmonë në dispozicion të të gjithë qytetarëve të cilët hasin vështirësi të ndryshme duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejtë problematikave të tyre.

Përvoja e re katër vjeçare e ofrimit të shërbimeve sa më afër publikut, pranë çdo zyre postare falë bashkëpunimit dhe marrëveshjes së Ministrisë së Mbrojtjes me Postën Shqiptare, ka bërë të mundur rritjen e cilësisë së shërbimit, aplikimin dhe marrjen e përgjigjeve dhe dokumentacionit të nevojshëm pranë vendbanimit të kërkuarit, në çdo pikë të Postës Shqiptare. Kjo ka eliminuar shpenzimet për shtetasit ushtarakë në rezervë, lirim, pension dhe familjet e tyre.

Me punën që po kryhet në Qendrën e Personel Rekrutimit, shumë shpejt ky shërbim synohet të bëhet pjesë e shërbimeve të ofruara në portalet elektronike zyrtare qeveritare për t'u njohur e përdorur nga shtetasit dhe institucionet shtetërore online, në çdo kohë.

Risi e misionit dhe e detyrave të strukturës aktuale të Qendrës së Personel Rekrutimit është dhe krijimi i komponentit të rezervës, i domosdoshëm jo vetëm si përvojë e vendeve të Aleancës ku aderojmë, por, dhe për t'u ardhur në ndihmë e për t'u përdorur në përballimin e situatave emergjente në zona të ndryshme në vend. Prezenca e ushtarakëve aktiv e në rezervë në raste emergjencash, në raste kërkim-shpëtimit, në rast nevojë për të pasur më shumë trupa në terren, është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme. Eksperiencia e ushtarakëve në rezervë me profesione të veçanta, me dije, me njohuritë që kanë në specialitetet e fituara në shkollë dhe jetën ushtarake është bërë e pazëvendësueshme për tu vënë në zbatim kur situata e kërkon.

Ngritja dhe funksionimi i strukturës së komponentit të rekrutimit për ushtarakët aktivë e ata të rezervës në 12 qarqet e vendit ka rritur lidhjen dhe bashkëpunimin me organet vendore dhe institucionet e tjera publike e jopublike në nivel qarku, punën promovuese për rekrutimin për ushtar/detar aktiv, për rekrutimin e kandidatëve për oficer studime brenda dhe jashtë vendit, duke komunikuar me organet vendore në bazë qarku e kontaktet me to, nga prefekti, nënprefekti, kryetari bashkisë, administratori i njësisë administrative, kryeplaku i fshatit, për evidentimin e kontingjentëve për mobilizim, institucionet/ndërmarrjet, pajisjet dhe mjetet sipas përcaktimeve në VKM Nr.103, datë 10.2.2016, etj, për sigurimin e burimeve njerëzore e materiale kur kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme, si dhe përditësimin e tyre. Struktura e re e krijuar një vit më parë me sektorin e rekrutimit për oficer, ushtar, rezervë në qark/rreth ka bërë të mundur rivendosjen lidhjeve/bashkëpunimit institucional midis Forcave të Armatosura me organet e qeverisjes vendore e strukturave tjera në qark.

Stafi i ri i emëruar për drejtim të Qendrës Personel Rekrutimit i kanë dhënë kohët e fundit një impuls të ri punës si dhe shërbimeve që ajo ofron, si në rritjen e efektivitetit e të cilësisë së punës në çdo hallke a individ, nevojë për një punë edhe më cilësore e gjithë përfshirëse të disa shërbimeve të aksesueshëm në portalin qeveritar e-albania, ku janë vendosur objektiva me afate konkrete për realizimin e tyre.



**N**ë kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ferizaj u zhvillua ceremonia e diplomimit të kadetëve „Gjenerata 2018“ të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së. Pas diplomimit, me gradë nëntogeri u graduan gjithsejtë 11 oficerë të rinj të cilët me sukses mbaruan shkollimin katër vjeçar për udhëheqje në Qendrën për Studime Universitare dhe atë akademik në Universitetin Amerikan në Prishtinë. Në aktin e veçantë të diplomimit të kadetëve, morën pjesë: ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, zëvendës ministri Burim Ramadani dhe Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjeneralletjenant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës së SHBA-ve, gjeneral major Timothy Orr, zëvendës komandanti i KFOR-it, gjeneral major Janos Csombok, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s për FSK, gjeneral brigade Ralf Hoffman, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Irfete Spahiu si dhe gjeneral e oficerë të FSK-së, KFOR-it, familjarë të kadetëve etj.

Pas pjesës ceremoniale, pritjes së ministrit të FSK-së, Rrustem Berisha, rreshtimit të kadetëve, intonimit të himnit shtetëror, fjalën e rastit e mbajti ministri Berisha i cili me këtë rast, para të pranishmëve tha se sot është ditë e veçantë për FSK-në, por

## QENDRA PËR STUDIME UNIVERSITARE E FSK-SË FSK: Diplomohen kadetët “Gjenerata 2018”

edhe për atë si ministër sepse, në këtë ceremoni po diplomojnë dhe po gradohen 11 kadetë të „Gjeneratës 2018“ të QSU-së të FSK-së. Në vazhdim ministri Berisha tha: „Gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare ju keni kaluar nëpër sfida të shumta të cilat falë punës, angazhimit dhe vendosmërisë ju keni përfunduar me sukses dhe nga sot po gradoheni me gradën e nëntogërit. Gradimi i juaj në oficer të FSK-së po bëhet në një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së, kur edhe pritët që kjo Forcë ti avancoj kapacitetet operacionale dhe ta ndryshoj misionin e saj. Ky standard i arritur është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bënë FSK-ja me profesionalizëm dhe në arritje të standardeve më të larta ushtarake të NATO-së.“

Në fund të fjalës së tij, ministri Rrustem Berisha iu drejtua kadetëve; „Të dashur kadet, nuk ka mision më të shenjtë sesa kontributi për vlerat e lirisë dhe sigurisë andaj ju dëshiroj suksese në këtë

rrugëtim, po ashtu një falënderim i veçantë edhe për familjet e juaja të cilat ju kanë qëndruar dhe mbështetur në vazhdimësi“. Ndërsa, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, foli mbi detyrat, rolin dhe rëndësinë e oficerëve në institucionin tonë, me ç'rast tha: „Të jesh oficer është detyrë jo e lehtë, që përkon me shumë sfida dhe përgjegjësi. Dhe sa më lartë që shkoni në karrierë, privilegjet tuaja rriten por njëherit edhe përgjegjësitë dhe detyrat tuaja shumëfishohen. Jo më kot thuhet që një lider duhet të jetë, të dijë dhe të bëjë. Të jetë me vlera ushtarake dhe attribute mentale, fizike e emocionale; të dijë aftësitë ndër-personale, konceptuale, teknike dhe taktike, si dhe të bëjë influencimin, drejtimin dhe përmirësimin e vartësve të vet. Prandaj, Juve kadetë të nderuar, ky betim jo vetëm që do të ju ngarkoj me përgjegjësi, por do të ju jep forcë dhe vullnet për ta realizuar ëndrrën tuaj“.

# Gjeneral Hazrolli vizitë zyrtare në Bundesver

**G**jeneral major Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me ftesë zyrtare nga 17-22.06.2018, ka qëndruar për vizitë në Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë. Gjeneral Hazrolli është pritur nga gjeneral brigade Oliver Kohl, Komandant i Akademisë së Udhëheqësve në Hamburg. Gjatë vizitës në Akademinë e Udhëheqësve u bisedua për përvojat, praktikat dhe programet arsimore dhe zhvillimore të këtij institucioni si dhe mundësitë për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit në të ardhmen që do të ishin në interes të shkollimit të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Vizita zyrtare e gjeneral Gëzim Hazrollit ka vazhduar në Qendrën për Udhëheqje të Brendshme të Bundesverit në Koblenz, ku u prit nga Drejtori i Qendrës, gjeneral major Reinhardt Zudrop me të cilin biseduan mbi mundësitë dhe kapacitetet trajnuese që ofron kjo qendër për shkollimin dhe trajnimin e ushtarakëve por edhe për



kapacitetet që ofron kjo Qendër për FSK-në dhe shkollimin e pjesëtarëve të saj.

Nga të dy qendrat gjeneral Hazrolli mori mbështetje për gatishmërinë e vazhdimin të bashkëpunimit dhe përkrahjes së FSK-së drejt avancimit dhe ngritjes profesionale. Ministria

për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë kanë marrëdhënie shumë të mira bilaterale si dhe aktivitetet vjetore në kuadër të këtij bashkëpunimi janë të shumta.

Në fund të fjalës së saj, gjeneral Spahiu theksoi: „I nderuar gjeneral Rama, unë ju garantoj se QSU dhe KDS do të vazhdojnë me përkushtim të reformojnë dhe avancojnë programet, të rrisin kualitetin dhe standardin e mësim-dhënies dhe mësim-nxënies, me qëllim që të nxjerrin oficer të përgatitur, të motivuar dhe profesional. QSU ishte dhe vazhdon të mbetet institucioni edukativo-arsimor kredibil ngase gjatë këtyre viteve, ajo ka dëshmuar gatishmërinë, përkushtimin dhe disiplinën për të përmbushur misionin e saj. Nga

kjo qendër kanë dalë shumë oficerë të rinj, të cilët tashmë janë pjesë e çdo angazhimi dhe njësie të suksesshme, shkollimi i të cilëve është bërë sipas standardeve të NATO-së.”

Gjatë ceremonisë, diplomat për të sapo diplomuarit i ndanë: ministri Rustem Berisha, gjeneral major Timothy Orr, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneral brigade Irfete Spahiu dhe komandanti i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së, kapiten Vegim Krelani. Prej 11 kadetëve të sapo diplomuar ishte edhe kadeti Premtim

Shaqiri, i cili u dekorua me „Medalje” për rezultate të larta në përvetësimin e programit akademik, si dhe u graduan me gradën nëntoger edhe: Klevis Elezaj, Bajram Geci, Defrim Kurti, Kreshnik Dreshaj, Valdrin Pollomi, Arlind Osmani, Meriton Haxholli, Erblin Çoçaj, Shkelqim Raci dhe Argjend Lokaj. Tashmë Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shtuan edhe 11 oficerë të rinj të cilët shërbimin do ta fillojnë me gradën nëntoger dhe se do të sistemohen në detyrat e punës, në të gjitha njësitë e FSK-së.

# Norvegjia mbështet antarësimin e Maqedonisë në NATO

**N**orvegjia mbështet fuqishëm anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Konfirmimi i mbështetjes së qartë është edhe vendimi me të cilin qeveria norvegjeze mbështeti ftesën për Maqedoninë për anëtarësim në NATO. Kjo u tha në takim të 27 qershor të ministrave të Mbrojtjes të Maqedonisë, Radmilla Shekerinska dhe Norvegjisë, Frank Bake-Jensen, në takim në Oslo. U bënë vendime të guximshme duke hapur rrugën që Maqedonia të merrte ftesën e shumëpritur dhe të merituar për anëtarësim në Aleancë, konkluduan ministrat.

„Kishte nevojë për vizion dhe lidhshmëri për të zgjidhur mosmarrëveshjen e gjatë me Greqinë. Kjo zgjidhje është gjithashtu një hap strategjik për të dy vendet. Ballkani ka treguar se jo vetëm që nuk shkakton probleme, por mund të jetë gjithashtu një model për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave evropiane. Kjo nuk mund të thuhet shumë shpesh. Tani Maqedonia pret një valorizim të fuqishëm të gjithçkaje që është bërë, përmes ftesës për anëtarësim në Aleancë dhe nisjes së negociatave me Bashkimin Evropian”, tha ministrja Shekerinska në takim. Ministrja theksoi se lëvizja e proceseve të integrimit euro-atlantik për Maqedoninë do të thotë forcimi i stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit të të gjithë Ballkanit, gjë që është parakusht për një Evropë të sigurt. Shekerinska shtoi se qeveria mbetet e palëkundur në realizimin e reformave të brendshme, sundimin e ligjit, demokracisë dhe lirinë e medias.



„Norvegjia përshëndet zhvillimet pozitive lidhur me kontestin e emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë”, tha ministri Frank Bake Jensen.

„Kjo është një shtysë për transformimin dhe stabilitetin për të gjithë rajonin. Mbështetja jonë për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO është e qartë,” tha Jensen dhe e informoi ministren se në Samitin e ardhshëm të NATO-s në Bruksel, Norvegjia do t’i përgjigjet pozitivisht ftesës për pranimin e Maqedonisë në Aleancë, e cila do të mbështetet nga vendimi për të mbështetur Maqedoninë që qeveria norvegjeze e miratoi javën e kaluar.

Dy vendet kanë bashkëpunim intensiv dypalësh në mbrojtje. Norvegjia është një nga mbështetësit

më të mëdhenj të Qendrës Rajonale për Marrëdhënie me Publikun, e cila është gjithashtu një qendër partnere e NATO-s dhe vazhdon të mbështesë Forcat e Mjekësisë Ballkanike, një organizatë rajonale me seli në Shkup. Gjatë vizitës, ministrja u takua me Sekretarin e Shtetit të Qeverisë Norvegjeze Ingwil Nes Stubb, Sekretarin e Shtetit pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme Audin Halvorsen dhe kryetarin e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Mbrojtje, Aniken Huitfeldt. Në takimet ministrja u ndal në zhvillimin jashtëzakonisht pozitiv të marrëdhënieve në Maqedoni, angazhimin për demokratizimin e shoqërisë dhe qasjen pragmatike për zgjidhjen e çështjeve të hapura midis fqinjëve.

Zëvendës Shefi i Shtabit (Zëvendës Shefit) të Ushtrisë, gjeneral major Azim Nouredine, mori pjesë në takimin vjetor të zëvendës shefave të Shtabit, të procesin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrive të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM) i cili u zhvillua më 13 qershor në Athinë, Greqi. Gjatë takimit u prezantuan aktivitetet më të rëndësishme të Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), për vitin e kaluar, si pjesë e forcimit reciprokisht të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit politiko-ushtarak në rajon, me qëllim përmirësimin e stabilitetit dhe sigurisë në Evropën Juglindore.

Ndër të tjera, ata morën në konsideratë rreziqet aktuale të sigurisë me të cilat përballen vendet në rajon dhe nevojën për qasje të përbashkët të koordinuar, si dhe aktivitetet stërvitore të ardhshme të forcave të armatosura të shteteve anëtare të shtatë që do mbahet në nëntor në Stamboll, Republika e Turqisë.

General Nouredine në bisedat me pjesëmarrësit e tjerë foli për masat dhe aktivitetet e përbashkëta, të koordinuara dhe rajonale të dizajnuara me objektiva të përcaktuara qartë. Në të njëjtën kohë, ai theksoi se Republika e Maqedonisë, duke respektuar dhe ndarë parimet strategjike dhe të mbrojtjes euroatlantike, është gati për anëtarësim të plotë në NATO.



TAKIMI I SEDM-IT NË ATHINË

## Nouredine: Maqedonia është gati për anëtarësim në NATO

Procesi i SEDM është iniciuar për herë të parë nga Shtetet e Bashkuara në vitin 1996 në Tiranë, me qëllim të forcimit të mirëkuptimit, bashkëpunimit politik dhe ushtarak dhe përmirësimin e stabilitetit dhe sigurisë në rajon me angazhim të plotë me parimet e sovranitetit dhe

integritetit territorial të të gjitha shteteve anëtare. Në SEDM marrin pjesë Shqipëria, Bullgaria, Bosnjë dhe Hercegovina, Greqia, Gjeorgjia, Italia, Maqedonia, Rumania, SHBA, Sllovenia, Serbia, Turqia, Ukraina, Kroacia dhe Mali i Zi, ndërsa Moldavia ka statusin e vëzhguesit.

### PREDRAG BOSKOVIC-FLORENCE PARLY

## Franca do mbështesë Malin e Zi në fushën e mbrojtjes

Gjatë qëndrimit të tij në Paris, i pranishëm në Pannairin e Armatimeve "Eurosatory 2018", Ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, Predrag Boskovic zhvilloi më 13 qershor, një takim zyrtar bilateral me ministrin e Forcave të Armatosura të Republikës së Francës, PARLI Firence (Florence Parly). Tema e takimit ishte modaliteti për përmirësimin e bashkëpunimit të të dy vendeve në fushën e mbrojtjes kua u shkëmbyen pikëpamje mbi sfidat bashkëkohore të sigurisë.

Ministri Boskovic tha se Mali i Zi do të mbetet e përkushtuar për forcimin e bashkëpunimit me aleatët, si pjesë e familjes së madhe, ku marrëdhëniet janë të bazuara në besimin dhe mbështetjen reciproke. Ai theksoi rolin e Malit të Zi si një promotor i vlerave pro-perëndimore dhe NATO-s në rajon, si dhe rëndësinë e mbështetjes që Republika Franceze kishte dhënë për Malin e Zi në reformimin e sistemit të mbrojtjes, bashkëpunimin ekzistues në fushën e aviacionit dhe marinës të dy ushtrive, në mësimin e gjuhës franceze, pjesëmarrjen në misionet paqeruajtëse, etj.

Ministri Boskovic tha se Mali i Zi vlerëson praninë e dukshme të Francës në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar se "ky rajon nuk mund të jetë e qëndrueshme pa një vizion të qartë euroatlantik, ashtu si Evropa nuk mund të jetë e sigurt, pa integrimin e plotë të Ballkanit Perëndimor". Ai tha se vetëm përpjekjet e përbashkëta mund të përballojnë sfidat e sigurisë, dhe konfirmoi gatishmërinë e Malit të Zi

për të marrë pjesë në misione dhe operacione ndërkombëtare, për të kontribuar në fushën e sigurisë globale, për të ruajtur paqen dhe stabilitetin.

Boskoviç tha se Mali i Zi është duke punuar intensivisht në modernizimin e pajisjeve ushtarake, që ushtria e Malit të Zi të jetë e barabartë me aleatët në përballimin e kërcënimeve moderne të sigurisë, dhe se Mali i Zi ka zgjedhur një sistem të mbrojtjes kolektive, si të ardhmen e saj, dhe ka angazhuar investime të vazhdueshme në sistemin e mbrojtjes, për të forcuar ndërveprimin e forcave të saj.

Ministrja franceze Parli ka shprehur kënaqësinë e salidhur me progresin e arritur dhe reformat në sistemin e mbrojtjes të Malit të Zi, me shpresën se vendet e tjera në rajon të ndjekin shembullin malazes. Ajo theksoi se Franca është aleat i besueshëm dhe se anëtarësimi i plotë i Malit të Zi do të kontribuojë në stabilitetin e bashkësisë ndërkombëtare. Ministrja franceze fokusua veçanërisht në rreziqet e sigurisë dhe kërcënimet e sotme, dhe theksoi se aleatët duhet të rrinë së bashku në mënyrë që të ruajnë trashëgiminë e vlerave të një shoqërie demokratike. Ajo tha se Franca do të vazhdojë të mbështesë Malin e Zi në mënyrë që të forcojë kapacitetet e saj në fushën e mbrojtjes dhe sistemeve të sigurisë. Ata ranë dakord se ka vend për intensifikimin e bashkëpunimit të mbrojtjes mes dy vendeve, si dhe shprehën gatishmërinë e tyre për të forcuar marrëdhëniet në periudhën e ardhshme në fushën e interesit të përbashkët.

MILO GJUKANOVIÇ NË SHTABIN E NATO-S NË BRUKSEL

## Stoltenberg: Mali i Zi, një aleat i vlefshëm në NATO

MSC. MIMOZA GOLIKJA

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, priti në 4 qershor 2018, në selinë e re të Aleancës së NATO-s në Bruksel, presidentin e Malit të Zi Milo Gjukanoviç. Vizita përkonte me një vjetorin e antarësimit të Malit të Zi në NATO, konkretisht më 5 qershor 2017. "Pranimi i Malit të Zi ka ndihmuar në nxitjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, sepse siguria nxit prosperitetin; dhe ka kontribuar në sigurinë euroatlantike", tha Stoltenberg. Duke i uruar mirëseardhjen presidentit Gjukanoviç në Shtabin e NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm tha se ky ishte takimi i parë me një kryetar shteti nga një vend i Aleancës që ai priste në ndërtesën e re të Shtabin e NATO-s. Ai gjithashtu e uroi Presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç për rizgjedhjen si president.

Duke nënvizuar faktin se tashmë është mbushur një vit që kur Mali i Zi u anëtarësua në NATO, Sekretari i Përgjithshëm tha se Mali i Zi është "një vend sovran në një Aleancë të fortë, me një vend në tryezën tonë dhe me një zë të barabartë në formësimin e vendimeve tona. Kjo është një ditë e rëndësishme për Malin e Zi dhe një ditë e rëndësishme për të gjithë Aleancën". Ai theksoi



se hyrja e Malit të Zi në NATO ka ndihmuar në nxitjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, "sepse siguria nxit prosperitetin", tha ai dhe "kjo ka kontribuar në sigurinë euroatlantike". Por Stoltenberg falenderoi gjithashtu Malin e Zi për "angazhimin për rritjen e numërit të trupave në Afganistan", si dhe për "rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes, me një plan të qartë për të investuar 2% të PBB në mbrojtje deri në vitin 2024. Kështu që Mali i Zi po dëshmon të jetë një anëtar shumë solid dhe shumë i besueshëm i Aleancës".

Kontributi i Malit të Zi në NATO pa rritet që nga koha e antarësimit dhe Stoltenberg tha se bashkë me këtë rritje edhe NATO po rrit

mbështetjen e saj për Malin e Zi, sepse "NATO është një Aleancë mbrojtëse. Ne i mbrojmë të gjithë aleatët kundër çdo kërcënimi". Duke filluar nga data 5 qershor 2018 NATO nisi patrullimet e policisë ajrore mbi Malin e Zi, me avionë nga Italia dhe Greqia. "Ky mision paqeje do të sigurojë mbrojtjen e qiellit tuaj. Qoftë nga avionët civilë apo ushtarakë në gjendje të vështirë, apo ndonjë kërcënim tjetër. NATO i siguron këtë mbështetje aleatëve pa forcat të tyre ajrore, një shenjë e fortë e solidaritetit të NATO-s".

Lidhur me takimin e sapo zhvilluar, Sekretari i Përgjithshëm informoi për mediat se ai ishte një takim i shkëlqyer ku kishin diskutuar

përgatitjet "për Samitin e NATO-s në korrik këtu në Bruksel". NATO do të vazhdojë "të përshtatet në një botë sfiduese, për të rritur sigurinë e të gjithë qytetarëve tanë dhe ne do të vazhdojmë të rritim gatishmërinë e forcave tona, për të siguruar që ne kemi forcat e duhura në vendin e duhur në kohën e duhur. Ne gjithashtu do të vazhdojmë të projektojmë stabilitetin në rajonin tonë dhe të rrisim luftën kundër terrorizmit", tha Stoltenberg. "Një nga mjetet tona më të mira në luftën kundër terrorizmit është të trajnojmë forcat lokale" dhe kjo është "pikërisht ajo që po bën NATO, nga Ballkani Perëndimor në Afganistan, edhe si një anëtar i Koalicionit Global për të Mposhtur ISIS". Duke informuar edhe njëherë lidhur me misionin e ri në Irak i cili do të nisë në samitin e korrikut Stoltenberg tha se "Në samitin në korrik do të nisim një mision të ri trajnimi në Irak. Për të siguruar që forcat irakiane mund të mbrojnë vendin e tyre dhe të parandalojnë ISIS që të kthehen". Ndërsa lidhur me diskutimin për Rusinë ai tha se "ramë dakord që politika jonë e dyfishtë e parandalimit dhe e dialogut është e drejta. Unë drejtova një takim të Këshillit NATO-Rusi vetëm javën e kaluar dhe dialogu ynë me Rusinë është edhe më i rëndësishëm kur tensionet janë të larta." Pas fjalës së Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg, atij dhe presidentit të Malit të Zi, Gjukanoviç iu drejtuan disa pyetje të cilat ne po sjellim më poshtë së bashku me përgjigjet.

### **Si vjen Mali i Zi si një shtet pas një viti anëtarësimi në NATO?**

**Jens Stoltenberg:** Ajo që kemi parë është se gjatë vitit që Mali i Zi ka qenë anëtar i NATO-s, Mali i Zi ka dëshmuar se është një kontribues neto i sigurisë për Aleancën tonë Transatlantike. Dhe Mali i Zi po kontribuon për sigurinë tonë të përbashkët në shumë mënyra të ndryshme. Mali i Zi kontribuon në stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, pranimi i Malit të Zi në NATO nxit stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, sepse siguria nxit prosperitetin dhe kjo ka kontribuar në sigurinë e të

gjithë rajonit Euro-Atlantik. Pastaj kemi edhe kontributet konkrete që Mali i Zi po bën si për misionin tonë në Kosovë, ashtu edhe për KFOR-in, por edhe për faktin se Mali i Zi tani po rrit kontributet e tij në misionin tonë në Afganistan, që ka të bëjë me luftimin e terrorizmit, një strehë e sigurt për terrorizmin ndërkom-bëtar. Pastaj Mali i Zi ka marrë pjesë në ushtrime të ndryshme të NATO-s, duke treguar se forcat e Malit të Zi mund të punojnë së bashku me forcat e aleatëve të tjerë të NATO-s, duke kontribuar në mbrojtjen tonë kolektive. Do të theksoja faktin se Mali i Zi ka filluar të investojë më shumë në mbrojtje, në aftësitë moderne, në forcimin e forcave të armatosura të Malit të Zi dhe ka një plan të qartë se si të arrihet qëllimi i shpenzimit të GDP-së prej 2% të GDP-së në vitin 2024. Pra, Mali i Zi kontribuon në shumë mënyra të ndryshme dhe Mali i Zi është një aleat me vlerë dhe gjithashtu e mirëpres përkushtimin e fortë të Presidentit Gjukanoviç në NATO dhe udhëheqjen që ai po tregon të Malit të Zi si anëtar i Aleancës.

### **A mendoni se një vit pas anëtarësimi të Malit të Zi në NATO, Evropa Juglindore është një rajon më i sigurt?**

**Jens Stoltenberg:** Mendoj se fakti që Mali i Zi është bërë anëtar e ka bërë Malin e Zi më të sigurt në një mjedis më të kërkuar sigurie. Realiteti është se ne shohim rreth Evropës më shumë sfida, më shumë paparashikueshmëri, shohim të gjitha trazirat dhe dhunën në jug, Afrikën e Veriut, Lindjen e Mesme, por jo më pak në Irak dhe Siri. Por ne gjithashtu shohim një Rusi më të sigurt që është e gatshme të përdorë forcën ushtarake kundër një fqinji, siç e kemi parë në Ukrainë. Por, në këtë mjedis më të kërkuar të sigurisë, NATO është bërë më e fortë, NATO është përgjigjur ndaj paparashikueshmërisë dhe pasigurisë që shohim përreth nesh dhe NATO është bërë më e madhe me një anëtar të ri, Malin e Zi. E gjithë kjo ka ndihmuar në forcimin e NATO-s, ndihmoi në forcimin e Malit të Zi, sepse jemi më të fortë së bashku se sa vetëm, duke u bazuar në idenë se ideja kryesore e

NATO-s është se nëse një Aleat sulmohet, kjo konsiderohet si një sulm kundër të gjithëve ne. Pra, pranimi i Malit të Zi në NATO e ka bërë Malin e Zi më të sigurt dhe gjithashtu NATO-n më të fortë.

**Milo Gjukanoviç:** Përgjigjja ime do të ishte e ngjashme me atë që tha Stoltenberg. Pra, nuk ka dyshim se anëtarësimi i Malit të Zi në NATO dhe përparimi i çdo vendi të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimi në NATO është një kontribut për stabilitetin dhe perspektivat më të mira të rajonit. Besoj se çmimi që ne po paguajmë sot në Ballkanin Perëndimor, dhe kjo lidhet me cilësinë e pamjaftueshme të jetës, është çmimi që po paguajmë për rrënjët dhe shkaqet që ne kemi qenë të vetëdijshëm për një kohë të gjatë dhe kjo është dëshira për të jetuar sipas rregullave evropiane. Atë që po bëjmë tani në Ballkan, e shoh si një përpjekje për ta kthyer Ballkanin në parajsën e tij natyrore Euro-Atlantike. Ne natyrisht e pranojmë rezistencën, por them se ato krijohen nga dy arsye: së pari është fakti se ende ka rezistencë të fortë ndaj kësaj kthese të Ballkanit drejt Perëndimit dhe Evropës, forcat që në fakt e mbrojnë, mënyra tradicionale e të menduarit që do të dëshironte të ruante situatën e kaosit dhe mungesës së perspektivës, ato tregojnë rezistencë që po forcohen sa më afër që jemi në qëllimet tona. Ato janë rezistenca e fundit, shenjat e rezistencës. Ato e kanë të vështirë të pranojnë se në të ardhmen do të jetojmë sipas standardeve evropiane. Nuk po flas për anëtarësimin në NATO apo Bashkimin Evropian këtu, por për Europeanizimin. Dhe problemi tjetër është ajo që po ndodh në skenën evropiane dhe globale. Sot mund të shohim se Evropa ka më shumë probleme se sa dhjetë vjet më parë dhe se marrëdhëniet në skenat globale janë më të tensionuara sot se sa ne mund të kujtojmë. Dua të them që nuk mund të kujtojmë se ato ishin më të tensionuar në të kaluarën. Pra, fakti është se ne kemi probleme, por ato nuk mund të na largojnë nga rruga jonë kryesore dhe kjo është që Ballkani duhet të ecë në rrugën e Evropës dhe integritit

euro-atlantik, sepse kur bëhet fjalë për rajonin tonë, është kusht i stabilitetit dhe zhvillimit demokratik.

**A folët për gjendjen e demokracisë në Mal të Zi, sidomos për lirinë e mediave? A mendoni se thirrja e**



**mediave drejtuese në Malin e Zi dhe barazimi me bandat mafioze ndihmon krijimin e një ambienti të sigurt apo armiqësor për lirinë e medias? Ju përmendët Rusinë. Z. Gjukanoviq dhe Putin shprehën publikisht se duan të përmirësojnë marrëdhëniet. Ju gjithashtu përmendi qasjen e dyfishtë. A përputhet kjo me qasjen e dyfishtë dhe mendoni se është mirë apo keq për NATO-n?**

**Jens Stoltenberg:** Së pari në marrëdhëniet me Rusinë, si Presidenti Gjukanoviq ashtu dhe unë e theksuam rëndësinë e asaj që ne e quajmë qasja e dyfishtë ndaj Ruisë, që për ne është që duhet të jemi të fortë, duhet të jemi të vendosur dhe ne duhet të reagojmë kur Rusia shkel rregullat ndërkombëtare, për shembull shkeljes së sovranitetit, integritetit territorial të një fqinji, si Ukraina, ose kur Rusia është përgjegjëse për sulmet kibernetike ose përpjekjet për të ndërhyrë në demokracinë tonë të brendshme, në proceset demokratike, siç kemi parë në disa vende aleate të NATO-s. Atëherë duhet të jemi të fortë, duhet të jemi të qartë dhe ne duhet të jemi të bashkuar në përgjigjen tonë, dhe kjo është edhe arsyeja pse të gjithë aleatët e NATO-s kanë mbështetur sanksionet ekonomike. Duke thënë këtë, Rusia është fqinji ynë, Rusia është atje për të qëndruar dhe ne nuk po synojmë të izolojmë Rusinë.

Ne do të vazhdojmë të përpiqemi për një marrëdhënie më të mirë me Rusinë dhe sidomos kur tensionet janë të larta, siç janë tani, është e rëndësishme që të kemi një dialog me Rusinë që të paktën të shmangen llogaritje të gabuara, incidente dhe

aksidente, që ato nuk dalin jashtë kontrollit. Pra edhe kur marrëdhëniet janë të vështira, është me rëndësi të veçantë të kemi një dialog me Rusinë. Dhe kjo është pikërisht ajo që kam dëgjuar nga Mali i Zi, se po përpiqen për një marrëdhënie më të mirë me Rusinë, se nuk po synojnë të izolojnë Rusinë dhe ky është po ashtu i njëjti mesazh si NATO-ja ashtu siç po e dërgon Aleanca; dialog, duke u përpjekur për një marrëdhënie më të mirë, por në të njëjtën kohë është e qartë se ne e mbrojmë njëri-tjetrin dhe se nuk pranojmë sjelljen e Ruisë kur shkelen rregullat ndërkombëtare ose përdorin forcën ushtarake kundër fqinjëve të tyre. Sa i përket lirisë së shtypit, para së gjithash, liria e mediave është një pjesë e rëndësishme e çdo demokracie dhe sundimi i ligjit, demokracia dhe liria individuale janë vlera themelore për NATO-n dhe një nga çështjet me të cilat jemi fokusuar shumë gjatë periudhës së pranimit ishte sigurisht rëndësia e këtyre vlerave edhe për Malin e Zi dhe unë mendoj se për të gjithë Aleatët e NATO-s këto janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Por, në të njëjtën kohë, mendoj se duhet ta pranojmë se, si pjesë e një demokracie të hapur dhe të gjallë, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme dhe nganjëherë edhe opinione të forta me të cilat nuk mund të pajtohemi, por kjo është pjesë e një debati demokratik, gjithashtu të ketë mosmarrëveshje dhe pikëpamje

të ndryshme.

**Z Gjukanoviq a mendoni se lehtësimi i sanksioneve apo heqja e sanksioneve kundër Ruisë është rruga për të përmirësuar marrëdhëniet me Rusinë?**

**Milo Gjukanoviq:** Pashë se një pjesë e njerëzve kanë mendime të ndryshme politike dhe disa analistë, komentues dhe media të pavarura dhe profesionale u përpoqën ta interpretojnë vlerësimin tim si kthimin e Malit të Zi nga NATO dhe duke u kthyer drejt Ruisë. Nuk ka asgjë për këtë në deklaratën time. Ky është një lloj spekulimi rreth politikës së vendit tim. Pra, pozicioni ynë ndaj Ruisë është absolutisht i qartë dhe Z. Stoltenberg më ndihmoi ta sqaroj këtë me saktësi për të gjithë, që të kuptohet nga të gjithë me saktësi. Mbështetja e NATO-s nuk shprehet vetëm me fjalë, por përkrah gjithë kohën vlerat e sistemit në të cilin ne jemi pjesë. Pra, nuk ka dilemë në vendin tonë nëse duhet të pajtohemi me politikën e jashtme dhe të sigurisë. Dua të them nëse kemi ardhur deri tani në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian, është e qartë se do të ndajmë politikën e jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Dhe nëse jemi anëtarë të NATO-s, ne natyrisht i ndajmë opinionet tona politike me NATO-n. Dhe veprimet në territorin e Ukrainës apo disa aktivitete të tjera të Ruisë që pamë, për shembull në Malin e Zi në vitin 2016 gjatë zgjedhjeve tona, ne do t'i dënojmë ato gjëra.

Për këtë arsye ne duhej për fat të keq të pranim sanksionet ndaj Ruisë, sepse duam t'i largojmë ata nga aktivitetet që ata bëjnë dhe ta çojmë Rusinë përsëri në zonën ku do të jemi në gjendje të bashkëpunojmë siç kemi bërë më herët. Ne mendojmë se është çështja e vendosmërisë dhe këmbënguljes për të mbajtur dhe ruajtur sistemin të cilit i përkasim. Ne i përkasim sistemit evropian të vlerave dhe mendojmë se aktivitete të tilla si aktivitetet e Ruisë që i përshkrova, janë përpjekje për të shkatërruar sistemin e vlerave dhe nuk ka dyshim se ne do të mbrojmë sistemin e vlerave që i përkasim. Dhe ftesa ime është që të largohet nga

zona ku ne po e ndëshkojmë njëri-tjetrin. Është vetëm zëri i përgjegjesisë për të pranuar realitetin. Rusia është fqinji ynë, nuk jemi identikë, ne jemi të ndryshëm. Nuk ka dy vende në botë që janë identike. Nuk ka dy fqinjë që janë identikë. Ne duhet të mësojmë të jetojmë me dallimet që nuk do të na rrezikojnë, por na ndihmojnë të bashkëpunojmë dhe të harmonizojmë sa më shumë që të jetë e mundur, dhe besoj në një proces të tillë. Është procesi i evolucionit dhe për këtë them se nuk është vendimi

ynë për të mbetur në situatën e ndëshkimit dhe sanksionimit të vazhdueshëm. Jo, dëshira jonë është që të kthehemi në kohën nga vetëm pak vite më parë ku kemi pasur bashkëpunim shumë konstruktiv brenda Këshillit NATO-Rusi. Ne besojmë në një qasje të tillë dhe kjo është arsyeja pse nuk ka ndonjë kuptim apo qëllim të fshehtë në deklaratën time lidhur me marrëdhëniet tona me Rusinë. Mali i Zi është i përkushtuar me vendosmëri dhe i vendosur për të punuar në afirmimin e mëtejshëm të

sistemit të vlerave të NATO-s dhe për të konfirmuar ato vlera në rajonin ku jetojmë. Por, me përgjegjësinë e një anëtarit të NATO-s, duhet të mendojmë për çështjet globale dhe ne duhet të propozojmë iniciativa të caktuara dhe zgjidhjet që mund të çojnë në zgjidhjen e situatës jashtë rajonit tonë si dhe në skenën botërore. Sepse, ju e dini, sapo përmenda kohët e fundit sa të rrezikshme mund të jenë reflektimet e situatës së keqe dhe paqëndrueshmërisë nga rajoni ynë.

## Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton Italinë

# Stoltenberg: Italia rol esencial në NATO

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zhvilloi një vizitë dy ditore në Romë më 10 -11 qershor 2018. Vizitën e tij ai e filloi me takimin me Ministrin italian për Punë të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Enzo Moavero Milanesi. Stoltenberg falënderoi ministrin e Jashtëm për kontributet me vlerë të Italisë, përfshirë Afganistanin dhe Kosovën, dhe për qëndresën ndaj sfidave nga jugu, të cilat janë të rëndësishme për të gjithë Aleancën. Ata diskutuan përgatitjet për Samitin e NATO-s në 11-12 korrik në Bruksel, përfshirë rritjen e përpjekjeve të NATO-s për të projektuar stabilitetin dhe luftën kundër terrorizmit, përmes nisjes së misionit të ri të trajnimit në Irak dhe më shumë mbështetje për Jordaninë dhe Tunizinë.

Gjithashtu ata diskutuan edhe mbi rëndësinë e qasjes së dyfishtë ndaj Rusisë, siç është ajo e mbrojtjes dhe e dialogut. Një tjetër temë që u diskutua ishte bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe Bashkimit Evropian, e cila "ka arritur nivele të paprecedentë". Sekretari i Përgjithshëm dhe ministri i Jashtëm italian diskutuan gjithashtu përparimin në lidhje me ndarjen e barrës brenda Aleancës, e cila përfshin paratë, aftësitë dhe kontributet për operacionet. Stoltenberg u takua gjithashtu me Kryeministrin Giuseppe Conte dhe ministrin e Mbrojtjes Elisabetta Trenta.

### Falenderim për Italinë në përpjekjet e vazhdueshme

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s



Jens Stoltenberg në takimin me kryeministrin Giuseppe Conte më 11 qershor 2018 në Romë, lavdëroi shumë kontribute që Italia jep për sigurinë në Evropë dhe më gjerë. Stoltenberg përshëndeti Italinë që luan një rol udhëheqës në Afganistan dhe Kosovë, siguron policinë ajrore për Malin e Zi, ka dërguar trupa në Letoni dhe udhëheq Forcën e Gatishmërisë të Lartë të NATO-s. "Kontributet tuaja janë në interes të sigurisë së Italisë dhe ato janë të rëndësishme për sigurinë e të gjithë Aleancës," tha ai. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu përshëndeti rolin e Italisë në afrimin e përshtatjes së NATO-s me kërcënimet nga jugu, duke përfshirë edhe Komandën e Forcave të Përbashkëta në Napoli dhe Qendrën e saj për Jugun. Qendra, tha Stoltenberg "pritet të jetë plotësisht operacionale nga Samiti i NATO-s në korrik dhe do të ndihmojë në monitorimin e kërcënimeve rajonale dhe koordinimin e përgjigjeve".

Italia gjithashtu së shpejti do të presë dronët e mbikqyrjes së NATO-s në Sicili, për të monitoruar dhe për

t'u përgjigjur sfidave të reja. "Duke i trajtuar këto probleme në burim, ne mund të ndihmojmë në parandalimin e krizave dhe konflikteve të reja, dhe fluksin e më shumë njerëzve në brigjet e Italisë", tha Stoltenberg. "Pra, ajo që bëjmë është në interes të qytetarëve të Italisë".

Stoltenberg vuri në dukje se Aleanca do të nisë një mision të ri trajnimit në Irak në samit, "për të ndihmuar iranianët të stabilizojnë vendin e tyre dhe për të parandaluar kthimin e ISIS." Ai shtoi se NATO gjithashtu do të shtojë mbështetjen për partnerët e tjerë në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, siç është Jordania dhe Tunizia. "Sepse në luftën kundër terrorizmit, trajnimi i forcave lokale është një nga mjetet tona më të mira", tha ai.

Sekretari i Përgjithshëm më tej vuri në dukje punën e NATO-s për të lehtësuar krizën e refugjatëve dhe emigrantëve në Evropë, duke përfshirë bashkëpunimin e ngushtë midis Operacionit të Rojes Detare të NATO-s dhe Operacionit Sophia të Bashkimit Evropian në Mesdheun Qendror. Ai shtoi se vendosja e NATO-s në Detin Egje gjithashtu ndihmon zbatimin e marrëveshjes së Turqisë me BE-në për të frenuar migrimin ilegal. Ndarja e barrës do të jetë gjithashtu në axhendë në Samit dhe Stoltenberg përshëndeti që të gjithë aleatët tani kanë filluar të rrisin shpenzimet e mbrojtjes, po investojnë më shumë në aftësitë e mëdha dhe po rritin kontributet në misionet e NATO-s. "Dua ta falënderoj Italinë për përpjekjet tuaja të vazhdueshme," tha ai.

**Përgatiti: Mimoza Golikja**



4 deri 13 qershor 2018  
**Perfundon stërvitjarajonale:  
“ADRION CAX-LIVEX 2018”**